


Isha në Paris, kur, në maj 1992, mora një thirrje telefonike nga një shqiptar nga Uashingtoni që dëshironte të më takonte. Ishte një profesor në pension i gjuhës dhe letërsisë shqipe dhe italiane që quhej Arshi Pipa. Kishte lexuar disa nga punimet e mia mbi Shqipërinë dhe kishim nisur të bashkëpunonim me korrespondencë, veçanërisht me krijimin e një reviste të titulluar *Albanica* që ai e kishte botuar në SHBA. I lashë takim në një kafene pranë kishës Saint-Sulpice, sepse po qëndronte në një hotel të Quartier Latin.

ARSHI PIPA:

NJË MUNGESË KAOQ E GJATË, SI NJË NATË E PËRJETSHME

Bisedoi Odile Daniel



SUKSESE PANAIRIT XX TË LIBRIT NË ULQIN

SHËNIME PËR LIBRAT

*Mbi romanin "Djali memec"
të Virion Graçit*

METAMORFOZA DHE DRAMAT NJERËZORE SHQIPTARE PAS VITEVE '90

Nga Dr. Jolanda Lila

(fq. 5)

Romani "Djali memec" spikat jo vetëm për trajtimin original të temës, por edhe për nga pesha e dramës dhe sinteza e ideve, nga dendësia e jetës dhe nga forca përgjithësuese në tërësi.

PETRIT RUKA, POETI MODERN I BALADËS SHQIPTARE

Nga Emrije Krosi

(fq. 6)

Poezia e Petrit Rukës është një poezi me metaforë të formësuar polifonike, ku të gjitha zërat e zhanreve poetike funksionojnë në mënyrë harmonike, brenda shtratit të tij sa lirik aq edhe klasik dhe modern, duke rrokur gjithë poliseminë e pashfrytëzuar të gurrës popullore shqiptare të Jugut dhe më gjerë...

*Rreth përmbledhjes me poezi
të Nurie Emrullait*

"VARGMALE NËN DHË". NJË POETIKË ME THEMEL

Nga Ballsor Hoxha

(fq. 9)

Poezia e Nurie Emrullait është një kompleks i poezisë në maturim e sipër. Ajo kalon dhe ndërtohet me kujdes dhe guximshëm mbi stratat e poezisë së kultivuar përmes simbolikave të njohura dhe të trasuara, në njërën anë, dhe në anën tjetër ka shpërthime tejet origjinale të Unit të saj poetik...



*Mbi monografinë "SANTORI- POET DHE
DRAMATURG" të prof. Klara Kodra*

VLERA ESTETIKE E KRIJIMTARISË SË SANTORIT PËRMES NJË MONOGRAFIE

Nga Hasan Gremi

(fq. 12)

ISAIAH BERLIN TAKIMI I PARË ME ANA AHMATOVËN NË LENINGRAD

(fq. 22)



"Andrra e jetës", NJË LEXIM I POEMËS SË NDRE MJEDËS

Nga Sokol Zekaj

Andrra e jetës është kryevepra e Mjedjes. Nuk kemi të dhëna për procesin krijues, por mund të besojmë se të shkruarit e saj ka qenë kënaqësi për autorin. Vetë ideja e poemës e ka gëzuar pasi tashmë, që i mbushur nga jeta për të dhënë plot gjëra, të cilat ende nuk i dinte, por që i ndjente brenda vetes: shumëllojshmëri vargësh e rimash, figurash e imazhesh, ndjenjash e përvojash. Vërtetë, poema do të kishte përsosmërinë e një veprë të madhe muzikore. Më duhet të them se, te *Juvenilia* më ka lindur ëndrra e jetës sime: ajo është vendlindja ime e poetit.

BIBLIOTEKË

Mira Meksi

(fq. 15)

Befasi

Rudolf Marku

(fq. 14)

Brathë të brendashkruar

Ismail Kadare

(fq. 17)

E krehura

Mehmet Kraja

(fq. 18)

Ubla e princeshës

Pavle Goranoviq

(fq. 16)

Stinët e humbura

Zuvdija Hoxhiq

(fq. 19)

Kur nuk do të jem

Hiromi Kawakami

(fq. 20)

Jashtë mase

THARJA E KËNETËS SË MALIOIT DHE NDËRTIMI I REGJIMIT KOMUNIST NË PERIFERI TË SHOIPËRISË

Nga Artan R. Hoxha, Ph.D

(fq. 8)

ARSHI PIPA: NJË MUNGESË KAO E GJATË, SI NJË NATË E PËRJETSHME

Nga Odile Daniel

Isha në Paris, kur, në maj 1992, mora një thirrje telefonike nga një shqiptar nga Uashingtoni që dëshironte të më takonte. Ishte një profesor në pension i gjuhës dhe letërsisë shqipe dhe italiane që quhej Arshi Pipa. Kishte lexuar disa nga punimet e mia mbi Shqipërinë dhe kishim nisur të bashkëpunonim me korrespondencë, veçanërisht me krijimin e një reviste të titulluar *Albanica* që ai e kishte botuar në SHBA. I lashë takim në një kafene pranë kishës Saint-Sulpice, sepse po qëndronte në një hotel të Quartier Latin.

E njihja vlerën e këtij profesori nga emri i tij i madh, sepse ai kishte botuar më 1978 në anglisht në koleksionin *Albanisce Forschungen* (Kërkime shqiptare) të Universitetit të Mynihut tri vëllime mbi letërsinë shqiptare. Kishte botuar po ashtu, gjithmonë në anglisht, katër vëllime të tjera në SHBA në koleksionin *East European monographs* në botimet e Universitetit Columbia të Nju Jorkut; vëllimi i parë, i botuar më 1984, i hartuar nga një grup autorësh nën drejtimin e tij, kishte të bënte me Kosovën. I dyti, i botuar më 1989, titullohej *The Politics of Language in Socialist Albania*. I treti, *Albanian stalinism, ideo-political aspects*, botuar më 1990, ishte pasuar më 1991 nga *Contemporary Albanian Literature*. Nuk e njihja rrugëtimin intelektual të këtij shqiptari, por më kishin mahnitur njohuritë dhe finesa e analizave të tij. Ai kishte marrë drejtimin e revistës *Dielli* të bashkësisë së shqiptarëve të SHBA.

Që të më njihje, duhet të vendosja mbi tryezë njërin prej librave të tij me kopertinë blu. Pasi prita ca, pashë të vinte një burrë trupvogël që duhet të ishte pak më shumë se 70 vjeç. Flokët e tij të bardhë, të ndarë me një vijë në mes, ishin prerë karë me një gjatësi që i fshihte veshët. Më kujtoi menjëherë Franz Liszt-in ose statujat e famullitarit të Ars-it që kisha parë në kisha. Tiparet i kishte fine, goja me buzë të holla rrethohej nga dy rrudha hidhërimi që i zbrisnin deri poshtë mjekrës. Mbante syze me skelet të zi dhe me xhama të trashë që vinin në pah vështrimin e një miopi. Megjithëse me flokë të bardhë, Arshi Pipa kishte vetulla të zeza mjaft të trasha që ia theksonin vështrimin e gjallë dhe të sinqertë. Shprehja e fytyrës dhe buzëqeshja e tij tregonin një mirësi të madhe. Folëm të dy duke u parë drejt në sy.

Profesor Arshi Pipa më përshëndeti duke përdorur fjalë shqipe, por biseda u bë në frëngjisht, sepse ai e zotëronte mjaft mirë këtë gjuhë. Madje ai ishte poliglot, fliste, përveç shqipes dhe anglishtes, frëngjishten, italishten dhe gjermanishten. Kishte gjithashtu njohuri të thella të latinishtes. Mora guximin ta pyes nëse kishte lindur në SHBA nga prindër shqiptarë të emigruar prej shumë kohësh, sepse e dija që në Detroit dhe në Boston kishte një diasporë të rëndësishme shqiptare, apo kishte lindur në Shqipëri.

- Kam lindur në Shqipëri, në Shkodër, më 1920. Mamaja ime ishte shkoderane. Stërgjyshërit e mi nga ana e babait ishin me origjinë nga Libohova, domethënë nga jugu i Shqipërisë ku kishin poste administrative, kryesisht në drejtësi. Babai im, një patriot dhe demokrat i madh, ishte avokat. Ai u burgos shumë herë në kohën e sundimit otoman. Më kujtohet që kishte miqësi me komandantin e trupave aleate të Shkodër, gjeneralin Joseph Marie Bardi de Fourtou.

- Prej sa kohësh jetoni në SHBA?

- Më 1957, u arratisa në Jugosllavi ku qëndrova gati një vit, pastaj, pas një qëndrimi të shkurtër në Itali, u vendosa në SHBA më 1958.

- Si mundët të largoheni nga Shqipëria, sepse vendi ishte i rrethuar me tela me gjemba dhe çdokush i afrohej kufirit pushkatohej në vend siç ndodhte me gjermanolindorët që donin të kalonin murin e Berlinit? Kaluat nga shtigjet e Malësisë së Madhe, i shoqëruar nga “malësorët”, që i njohin mirë shtigjet që i përdorin për verimin e bagëtive?

- Motra ime, Fehime, ka shkruar një kronikë familjare ku tregon epopenë e familjes sonë. Duhet t’ju them se kam qenë i burgosur për dhjetë vjet në burgjet dhe kampet e punës së detyruar komuniste. Jam dënuar për herë të parë më 1949 me dy vite burg për “agjitacion dhe propagandë” dhe, gjatë periudhës

së terrorit dhe spastrimeve të vitit 1947, dënimi m’u kthye në njëzet vjet; por, më 1949, gjatë një mase të jashtëzakonshme faljeje, dënimi u përgjysmua dhe, më 1956, u lirova. Kur dola nga burgu pas dhjetë vitesh izolimi, shkova të takoj Ramiz Alinë, që asokohe ishte ministër i arsimit dhe kishte qenë nxënësi im kur punoja në gjimnazin e Tiranës më 1943 dhe më 1944. Më priti shumë mirë dhe munda të kem një vend pune si mësues. Dhashë mësim në gjimnazet e Tiranës, Shkodrës dhe Durrësit, por, meqë të gjitha programet ishin të mbushura me ideologji dhe tekstet ishin veçse slogane dhe pjesë të fjalimeve të Enver Hoxhës, dhashë dorëheqjen. Sigurisht që s’kisha pranuar të hiqja nga programet tekstet e shkrimtarëve të ndaluar nga regjimi komunist, si ato të At Gjergj Fishtës, një nga figurat më të mëdha intelektuale. Gjithashtu, s’mund të botoja më asgjë.

- Po, e kuptoj. Gjithçka duhet të kalonte përmes gjykimit të censurës. Një plejadë e tërë autorësh, mendimi i të cilëve nuk ishte në përputhje me ideologjinë në fuqi, u ndaluan.

- Duke mos mundur të ushtroja profesionin më tim si arsimtar, m’u desh të vendosja të jetoja në mjerim. Kështu, një ditë, kur një njeri i besuar më propozoi të arratisesha duke përfutur nga ndihma e një shqiptari, shtëpia e të cilit ndodhej jo larg nga kufiri me Jugosllavinë, pranova. Pra, u largova me motrën time që ishte veshur si fshatare. Secili ndoqi nga një itinerar të ndryshëm dhe u bashkuam në një vend ku ky malësori, një trim mbi trimat, na shoqëroi të kalonim kufirin. Të dy ishim të armatosur. Na çuan në një kamp refugjatësh, pastaj na pranuan të rrinim në Sarajevë. Aty qëndrova disa muaj si emigrant politik. Pata fatin të mos më kthenin në Shqipëri, siç ndodhte shpesh me të arratisurit. Kalova disa kohë duke përkthyer në shqip poemat e autorëve më të mëdhenj latinë në dialektin tonë gegë të Shqipërisë së Veriut. Më pas u nisa për në Itali, në Romë, ku lidha miqësi me Martin Camajn, një shqiptar nga veriu që, edhe ai, ishte larguar nga Shqipëria komuniste duke marrë rrugën e mërgimit përmes maleve të Veriut. Ai jepte shqip në Universitetin e Mynihut.

- Ç’ju shtyu të shkonit për të jetuar në SHBA?

- Nuk doja të qëndroja në Itali. Megjithëse kisha ndjekur një program studimi në universitetin e Firences, ku kisha botuar punimin tim të diplomës me temë “Moral dhe feja te Bergson”.



Por kisha kujtimin e trishtuar të vëllait tim, Myzaferit, që kishte qenë student drejtësie në Padovë dhe që ishte burgosur nga fashistët në Ishullin Ventotene, në detin Tiren, ku dërgoheshin kundërshtarët e fashizmit. Gjithashtu ishte më e lehtë për mua të vendosesha në SHBA, sepse aty kisha nipa që mund të më prisnin.

Pashë që fytyra e Arshi Pipës u shtendos dhe përvijoi një buzëqeshje. Sytë e tij të zinj filluan të shndrinin. Kishte marrë një pamje rinore, kur më tha:

- Në fillim, m’u desh të punoja në Nju Jork si roje te një tregtar gomash, por isha kaq i zënë me studimin e librave, sa nuk e vura re që në dyqan kishte hajdutë, kështu më pushuan shpejt.

- Keni dhënë mësim shqipeje në SHBA?

- Dy vjet pas mbërritjes në SHBA, dhashë mësim filozofie dhe feje në Philander Smith College në Little Rock, Arkansas. Nga viti 1963 deri në 1966, kam dhënë mësim në Departamentin e italishtes në universitetin Berkeley dhe aty kam drejtuar edhe një seminar mbi gjuhën, letërsinë dhe folklorin shqiptar. Karrierën si profesor në departamentin e frëngjishtes dhe italishtes e mbylla në Mineapolis, në shtetin e Minesotas, duke vazhduar të drejtoj punime kërkimore mbi Shqipërinë. Më 1968 kam botuar një libër mbi Danten dhe Montalen. Kur dola në pension, më dhanë titullin “Profesor i merituar”.

I shpreha Arshi Pipës vlerësimin tim të madh për studimet e tij intelektuale dhe, veçanërisht, për erudicionin e tij të madh.

- Ajo që kam vënë re në librat tuaj, është logjika juaj shumë e fortë, shpirti deduktiv shembullor. Duke lexuar librat tuaj, mund të bëhet një paralelizëm me shkrimtarin shqiptar Faik Konica që ka studiuar në Francë. Ai ka shkruar një tekst të bukur më 1897 të titulluar “Disa këshilla mbi artin e të shkruarit”. Ai u duhet dhënë si model studentëve. Faik Konica ka shkruar se shkrimtari në radhë të parë duhet ta qartësojë mendimin e tij dhe të shpjegojë që në fillim se “ku fle lepurit”, sipas një shprehjeje shqiptare, dhe se rrëfimi duhet të zhvillohet ngadalë nga peri te gjilpëra, nga deduktimi në deduktim, me fjali të lidhura në mënyrë logjike mes tyre për të mbërritur në një përfundim që rimerr në mënyrë të përmbledhur mendimin e autorit. Është për të ardhur keq që ky shkrimtar është ndaluar për gati pesëdhjetë vjet në Shqipërinë komuniste, sepse ka qenë konsull i përgjithshëm i Shqipërisë në Uashington, ministër fuqplotë nga viti 1926 në 1939.

- Po, u përgjigj Arshi Pipa, mendoj se Faik Konica ka bërë shumë për përparimin e kulturës shqiptare duke përhapur kulturën franceze në revistën e tij *Albania* në një kohë kur shqiptarët ishin ende në Perandorinë otomane.

- Librat tuaj shprehin shqetësimin për vazhdimësinë e zhvillimit të kulturës shqiptare, por, për fat të keq, nuk kanë mundur të përhapen në Shqipëri për shkak të censurës; me rënien e regjimit marksist-leninist, ju mund t’i përktheni në shqip. Kam parasysh vendosmërinë që keni treguar për të thelluar studimet mbi kulturën shqiptare si përmeshje e rekomandimeve që u bënte shqiptarëve Mit’hat Frashëri, babai i të cilit, Abdyl Frashëri, ka drejtuar më 1878 Lidhjen e Prizrenit për t’i hedhur shqiptarët në një aksion të përbashkët me qëllim çlirimin nga tutela otomane. Ky shkrimtar, edhe ai i mohuar gjatë diktaturës, ka shkruar më 1924 në librin e tij *Plagët tona* një tekst ku u këshillonte shkrimtarëve shqiptarë të merrnin penën e tyre për të punuar për ngritjen e nivelit kulturor në Shqipëri. Pikërisht këtë keni bërë ju në vendin ku ishit mërguar, me një durim të pamasë. Mit’hat Frashëri ishte pranuar plotësisht në rrethet letrare evropiane. Aline Menard Dorian, nga familja e mamasë sime që kishte lindur Menard, mbante një sallon ku vinin shpesh Alphonse Daudet, Emile Zola dhe vëllezërit Goncourt. Ajo ka mbajtur korrespondencë me Mit’hat Frashërin në vitet 1920-1922. Ajo ishte nën-kryetare e Lidhjes së të Drejtave të Njeriut dhe priste artistë, muzikantë, politikanë dhe të mërguar në sallonin e saj. E quanin “Mikpritësjë e mirë”. Kur vdiq, Victor Basch, kryetar i Lidhjes së të Drejtave të Njeriut, i thuri elozhe kësaj gruaje që mbështeste popujt e shtypur dhe të mërguarit. Ajo denonconte diktaturat, bënte thirrje për mirëkuptim të përzemërt dhe mbronte lirinë e popujve.

Përgjigja e Arshi Pipës më habiti:

- Po shoh te ju, që keni punuar në terren me këmbëngulje në kushte të vështira, të njëjtën vendosmëri që provoj unë për të ngjallur interes për një vend të izoluar dhe të përcmuar për shkak të një ideologjie që e ka shkatërruar. Duhet punuar për ringjalljen e kulturës shqiptare.

- Ju propozoj të dëshmoni për rrugëtimin tuaj intelektual dhe për njohuritë tuaja duke mbajtur disa kumtesa para profesorëve të universitetit dhe studiuesve. Do të ishte një shembull i mirë për të treguar se ekzistojnë intelektualë shqiptarë që nuk kanë pranuar të nënshtrohen dhe që kanë njohur persekutimet staliniste. Gjithashtu mund të tregoni për lëvizjen që solli rënien e komunizmit dhe për zhvillimet politike të kohëve të fundit në vendin tuaj.

Profesor Pipa pranoi dhe vendosëm të takoheshim pas disa ditësh. Si dhuratë më dha disa kopje të librave të tij të parë të shkruar në shqip, tri vëllime me poezi: *Lundërtarët* botuar më 1944 në Tiranë si dhe *Rusha* botuar më 1968 në Gjermani. Poemat e tij flisnin për marrëdhëniet shqiptaro-serbe, për dashuri dhe gjakmarrjen në gjysmën e dytë të shekullit XIV. Më dha gjithashtu librin e tij të titulluar *Libri i burgut* që e kishte botuar në shqip në Romë më 1959 dhe që u kushtohej viktimave të komunizmit, duke më thënë:

- Kam mundur t'i botoj këto libra, falë një miku, Zef Shllakut, që më ka mbështetur financiarisht. Ai ka qenë një verior, i arratisur në SHBA. Kishte në San Francisko një restorant me gatime italiane që ishte bërë i famshëm sepse e kishte frekuentuar Luciano Pavarotti. Për botimin e librit tim, më ka ndihmuar gjithashtu dhe diaspora shqiptare e Detroitit, Nju-Jorkut, Uashingtonit dhe e Londrës. Në *Librin e burgut* do të gjeni tekste që i kam shkruar gjatë viteve të burgut, në fillim në Tiranë më 1945 - 1946, pastaj me radhë deri më 1956 në burgjet e Durrësit, Burrelit, Tiranës, në kampin e Vloçishtit pranë Korçës dhe në kalanë e Gjirokastrës. Duke menduar se nuk do t'u mbijetoja burgut dhe punëve të detyruara, kam dashur të lë një dëshmi. Pra, kam shkruar fshehurazi në burg, me një shkrim të vogël të imët dhe të rregullt, në letrat e cigareve që i palosja si fizarmonikë dhe i fshihja në palat e rrobave që ia jepja për të larë motrës sime kur vinte të më vizitonte.

I kërkova profesor Pipës të shkruante një dedikim në librin e tij që dëshmonte për vitet e burgut. Ai shkroi: “À Odile-Idole. A.P.” (“Për Odilën-Idhull. A.P.”), duke bërë një lojë fjalësh për të treguar vlerësimin intelektual për mua. Ai më bëri gjithashtu si dhuratë një varëse me dru arre të punuar nga një i burgosur. Ajo paraqiste një trëndafil. Ishte kujtim prekës.

U ndamë dhe, me t'u kthyer në shtëpi, u zhyta në leximin e librit të tij. Ai u kushtohej dëshmorëve të kombit që kishin rënë me nder, viktimat të komunizmit. Në parathënie, Arshi Pipa shpjegonte se nuk kishte shkruar në prozë, sepse, në kushtet ku ndodhej, ose i mbyllur në burg, ose i mbajtur në një kamp pune të detyruar, i mungonte letra për të shkruar fjali të gjata dhe, përveç kësaj, e kishte të ndaluar të mbante ditar. Pra, kishte zgjedhur poezinë, për të cilën kishte një prirje të lindur. Përmes poezisë që i drejtohet zemrës dhe ngjall emocione, sprovat më të dhimbshme të jetuara shpreheshin në mënyrën më të mirë dhe e preknin thellë lexuesin. Përmes vargjeve të tij shprehej dhimbja e çastit. Vendosa të përkthej një pjesë të tekstit të profesorit Pipa. Ajo u botua në revistën *Alternativa e re*.

Arshi Pipa nuk kishte kurrë shumë qejf të fliste për të shkuarën e tij të dhimbshme. Ishte hera e parë që takoja dikë që kishte qenë viktimë dhe që kishte vuajtur dhjetë vjet në gulag. Shkrimi për të kishte qenë si një ilaç; në një farë mënyre, ai e kishte lehtësuar dhe rrëfimet e vuajtjeve të tij kalonin ndoshta përmes pendës më mirë se përmes fjalës.


Në poemën e titulluar “Nata e parë”, Arshi Pipa ndodhet, gjatë arrestimit të tij, në shërbimet e *Sigurimit* të Durrësit (që mbante atëherë në mënyrë të çuditshme emrin “Seksioni për mbrojtjen e popullit”). Ai përmend hije, hapa, zhurmat e goditjeve, britmat, fyerjet, një ferr i vërtetë ku janë zhytur njerëz të pafajshëm. Ai vetë kishte njohur torturat. Në një poemë tjetër, ai dëshmon për vuajtjet e të burgosurve që duhet të shtynin vagonë të rëndë me dhé për të punuar për ndërtimin e rrugës bregdetare në Durrës.

Në pjesën e parë të librit të tij, ai i kushton një elegji të bukur vëllait të tij Myzafer Pipa, që kishte qenë avokat. Pasi u burgos një herë në Itali nga fashistët më 1940, ai njohu një burgosje tjetër në kampin nazist të Prishtinës. Kur u kthye në Shqipëri, filloi të botonte një revistë kulturore të titulluar *Fryma*. E arrestuan në shtator 1946 dhe e torturuan me hekur të nxehtë në shërbimet e *Sigurimit* të Shkodrës, gjoja se kishte dashur të arratisë, por arsyeja e vërtetë ishte se kishte mbrojtur priftërinjtë katolikë më 1945. Ai ishte angazhuar në mbrojtje të tyre, megjithëse ishte mysliman. Vdiq më 1946 nën tortura në oborrin e shkollës së motrave stigmatine të Shkodrës. Familja nuk e dinte ku e kishte varrin.

Poemat janë të shoqëruara me shënime të bollshme të shtuara nga autori pas lirimit të tij. Ato japin saktësime mbi qëndrimin e Arshi Pipës më 1948 në kampin e punës të Vloçishtit, pranë kënetës së Maliqit. Kjo ishte një fushë e madhe e rrethuar me tela me gjemba ku 1300 - 1600 vetë, të burgosur ordinëre dhe politikë, jetonin në baraka. Lufta e klasave zbatohej aty me tërbim. Për rojet, të burgosurit politikë ishin përfaqësues të klasës kapitaliste-borgjeze dhe të burgosurit ordinëre kishin të drejtë t'i vidhnin. Për t'u mbrojtur, të burgosurit politikë flinin duke e fshehur bukën poshtë kokës.

Arshi Pipa i kushton njëzet e katër sonete përshkrimit të punimeve të bonifikimit që duhet të kryenin të burgosurit. Ata duhet të hapnin kanalën e Dunavecit, disa kilometra i gjatë në një thellësi prej 3 metrash dhe një gjerësi prej 10 metrash. Kantieri ndodhej 6 - 7 km larg nga kampi dhe rruga duhej bërë në këmbë. E gjithë puna kryhej me kazma, lopata dhe tokmakë. Nëse të burgosurit nuk e realizonin normën, rriheshin dhe privoheshin nga ushqimi ose torturoheshin. Shumë prej tyre vdisnin në vend. Arshi Pipa tregon disa ngjarje të llahtarshme: një shok i tij u ekzekutua, sepse u ishte afruar kufijve të kampit dhe një djalë i ri ishte varrosur i gjallë, i akuzuar se donte të arratisë. Shumë burra, të rraskapitur dhe të dëshpëruar, kishin vrarë veten duke u varur në hekurat e një dritareje të barakës së tyre. Kampi i Vloçishtit ishte një kamp i vërtetë shfarosjeje. Arshi Pipa tregon një anekdotë: kur kërkoi një ditë leje te një roje për të mos shkuar në punë, sepse i ishin buhavitur këmbët, ky i ishte përgjigjur: “Mendova se të kishin lënë në infermierinë e burgut, pra, e ke marrë veten, madje dhe qenke shëndoshur aty”. Meqë ai po heshte, roja vazhdoi: “Gomar, nuk e kupton! Po që të vdesësh të kanë mbyllur këtu dhe tani ti më kërkon leje që të mos punosh...” Roja u largua duke e sharë.

Poemat nderojnë viktimat e Buchenwald-it, Majdanek-ut



dhe të Dachau-t, viktimat e revolucionit hungarez, disa luftëtarë trima të historisë së Shqipërisë, vëllezërit e tij nga Kosova. Midis poezive kushtuar burgut të tij, ajo e titulluar *Neli*, me emrin e shokut të burgut, është prekëse. Arshi Pipa i kishte bërë ballë tmerrit duke parë qëndrimin e përkushtuar të Nelit, “farë e mirë e një fati të keq. Falë tij, unë pranova jetën dhe munda ta duroj fatin tim”. Ai nderon njëkohësisht të burgosurit që nuk i braktisën kurrë bindjet e tyre edhe në vuajtjet më të këqija dhe përfundon duke thënë se ka mësuar shumë në burg, shumë më tepër se në libra.

Një këngë u kushtohet dëshmorëve të kombit:

*Prej qelave ndër pranga
ku presim pushkatimin
o bij t'atdheut ku t'jeni
ju lamë na trashigimin
Prej nesh ju merrni zemër:
s'na trembet syni ne,
s'na dhimset t'rit as jeta
kur vdesim për atdhe
Luftuem për idealet
e thjeshta kombëtare.
Na ramë, por mbasi mbollëm
virtytin e një fare
që jep ndër ju filiza
me gjak e bamë plle.
Shqiponja e përtërime
Me vdekjen tonë ka le.*

Profesori më dha edhe një libër poezish të shkruara në gjuhë të ndryshme. Një poemë, e shkruar në fund të jetës së tij, dëshmon për ndjeshmërinë e tij të madhe, trishtimin dhe miqësinë e tij të thellë:

Femër e përjetshme
Madonë – Kordeli – Eloizë
Të ndoqa gjatë gjithë jetës sime
Të gjeta dy hapa larg
Hendekut të ditëve të mia.
Ti, që zëri i kadifenjtë
Ma grisi mbështjellën e qenies rastësore.
Ti, tek e cila veç i ligu ka dashur të besojë
Sibilë, druide,
Beatrice e purgatorit tim.
Më shpëto nga vetvetja,
Natë e errët e shpirtit
Ku vetëm shkëlqen
Fije flake, e zezë,
Prehja e dhënë dëshpërimit.

Guxova ta pyesja profesorin për biografinë e tij, por, për t'ia kursyer kujtimet e dhimbshme, nuk e pyeta për vitet e kaluara në burg dhe në kampet e punës. Vështroja fytyrën e profesorit që dëshmonte për vuajtjet që kishte kaluar. Kishte lëkurë të zbehtë, madje të bardhëlleme. Shikimin e kishte të fortë dhe të thellë.

Ishte mjaft i ndjeshëm dhe nga sytë i rridhnin shpejt lotët pas emocionit më të vogël. Vura re se ishte njeri shumë i butë dhe i respektueshëm. Kurrë nuk e ngrinte zërin. Për të, veprimtaritë e shpirtit ishin shpëtimi i tij. Kishte gjallëri të madhe intelektuale. Misioni i tij kushtuar zhvillimit të kulturës shqiptare e kishte shpëtuar nga dëshpërimi.

Admiroja forcën morale të profesor Pipës, fuqinë e qëndresës, zjarrin intelektual dhe finesën e shpirtit të tij. Më kishte rrëfyer se ndihej thellësisht evropian, edhe pse jetonte në SHBA. E donte shumë Korsikën, me peizazhet e mrekullueshme që ngjanin me ato të vendlindjes së tij dhe, sidomos, veçoritë dhe zakonet e afërta me ato të shqiptarëve. Fliste shpesh për Prosper Mérimée që kishte shprehur në shkrimet e tij interesin për shqiptarët.

Erudicioni i Arshi Pipës ishte i pamat. Pyesja veten si e kishte fituar. Kishte kryer studimet për latinisht dhe greqishtë të vjetër në kolegjin jezuit Shën Françesku të Shkodrës që priste të krishterë dhe myslimanë, pastaj kishte ndjekur gjimnazin shtetëror të Shkodrës. Më 1944, në moshën 24 vjeçare, kishte themeluar një revistë të titulluar *Kritika*. Kjo ishte para vendosjes së komunizmit që kishte gjymtuar gjithë sektorin e kulturës. Gjatë diskutimeve tona mësova shumë mbi historinë dhe kulturën shqiptare. Duke e dëgjuar të fliste profesor Pipën, po konfirmohej ideja ime se shkencat humane të japin një kulturë mjaft të gjerë, aftësi të mëdha intelektuale dhe një finesë të bukur analize; ndoshta edhe filozofia që kishte studiuar në Itali kishte dhënë edhe ajo ndihmesën e saj. Nëse Shqipëria nuk do të kishte rënë në kurthin e komunizmit, ai do të kishte qenë një figurë e madhe intelektuale e nivelit ndërkombëtar.

U takuam sërish me rastin e një konference që ai dha në një institut kërkimor dhe, gjatë një darke në fund të mbledhjes, ku ai u zbraz, disi kur e pyeta për familjen, sepse e kisha ndier që për këtë temë fliste me lehtësi. Ndihej shumë i hidhëruar për fatkeqësitë që ajo kishte pësuar për shkak të tij, më tepër se për vuajtjet e veta.

- Komunistët, më tha, ma përzunë familjen nga kryeqyteti. Ata e detyruan të shpërngulej tri herë brenda gjashtë muajve, atë familje ku jetonin së bashku prindërit dhe tri motrat e mia, Nedret, Fehime dhe Bukurush, si dhe dy jetimet e motrës Bedi që kish vdekur nga tuberkulozi. Kur munda të flas së fundmi me njërën nga motrat e mia, pas gati pesëdhjetë vitesh heshtje, ajo më tregoi se një fqinj, djalë i ri, që banonte në njërën nga banesat e vogla ku kishte jetuar familja ime në Durrës dhe që kishte qenë nxënësi im, ishte dërguar nga Partia të më vizitonte në burg për të parë nëse “isha zbutur”. Iu përgjigja se nuk kisha bërë asnjë gabim, pra, nuk kisha asnjë arsye për t'u penduar. Kur isha i burgosur në Durrës, familjarët nuk më treguan që vëllai im kishte vdekur nën tortura dhe, herët e pakta kur vinin të më vizitonin, nuk i vishnin rrobat e zisë. Megjithatë, e mora vesh lajmin nga një burim tjetër. Humba edhe njëerën nga motrat e tjera të mia, pastaj babai im u sëmur. Kishte thyer ijën. Mbeti invalid. Vdiq, i goditur nga një krizë zemre gjatë një shpërnguljeje me qerre. Ime më nuk arriti as të merrte

ambulancë për ta transportuar. Në pak kohë humba tre anëtarë të familjes sime.

- Ç'vuajtje të tmerrshme!

- Kam parë shumë njerëz të vuanin rreth meje; intelektualë, inxhinierë, klerikë, por dhe fshatarë e punëtorë. Gjyqet ishin vetëm farsa të poshtra, sepse vendimet ishin vendosur shumë kohë më parë nga ministri i brendshëm. Vinçenc Prendushi, françeskan, poet i madh, që ishte kreu i Kishës katolike, u arrestua në moshën 86 vjeç dhe u akuzua se ishte pjesë e “klerit reaksionar”, se ishte armik i popullit, “bashkëpunëtor”, “fashist”, “agjent i Vatikanit” dhe se kishte bërë përpjekje për të përmbysur qeverinë. U dënua me njëzet vjet burg dhe me punë të detyruar. Iu përgjigj gjykatës se nuk kishte vepruar kurrë keq në jetën e tij, se nuk kishte ushtruar asnjë diskriminim. E mbaj mend mirë, sepse me të ndaja të njëjtën qeli të vogël, së bashku me nja tridhjetë burra të tjerë. Rrinim të ngjeshur në më pak se 40 metra katror, por linim hapësirë rreth arkipeshkvit në shenjë respekti ndaj tij. Për më tepër, mes nesh, të burgosurve, s’kishte më dallime: pak rëndësi kishte pozita jonë shoqërore apo edukimi ynë intelektual. Qëllova pranë tij dhe u bëmë miq pa dallim përkatësie fetare, sepse unë jam mysliman. Qëndruam bashkë deri ditën e vdekjes së tij më 1948. Biseda jonë kishte të bënte sidomos me letërsinë dhe, veçanërisht, poezinë.

Shtova:

- Imzot Prendushi ka marrë pjesë në mbledhjen e thesareve të poezisë gojore shqiptare. Ai ka shkruar edhe poezi shumë të bukura si *Gjethë dhe Lule* dhe ka përkthyer në shqip kryevepra të letërsisë evropiane. Arkipeshkvi i Shkodrës ka vepruar gjithashtu dhe si ndërmjetës në kohët shumë të vështira që jetonte Shqipëria në fillimet e periudhës së fitores së pavarësisë më 1912. Si ka mundësi që u trajtua si armik të popullit?

- Vuaja shumë për të, më tha Arshi Pipa, kur tregonte se e kishin torturuar. Policët e kishin goditur plakun me shkopinj. I kishin lidhur duart dhe këmbët dhe e kishin varur në tavanin e një dhome ku kishte vuajtur deri sa kishte humbur ndjenjat. Imzot Prendushi iu nënshtrua punës së detyruar. I duhej të shkarkonte kërcunjt druri nga një karrocë që ndodhej në rrëzë të kodrës mbi të cilën ndodhej burgu dhe t’i sillte deri te ndërtesat. Ishte punë e rëndë për të që vuante nga një hernie. Rojet nuk pushonin së talluri me të duke e fyer me tonin e zërit të tyre kur shqiptonin vetëm fjalën “Prift!” Talleshin me të duke i thënë: “S’ke punuar kurrë në jetën tënde?” dhe përfitonin nga kjo për ta rrahur dhe për t’i ngarkuar drurë të mëdhenj të shpinë.

- Vdiq nga torturat? thashë.

- Vdiq në spitalin e Durrësit ku ndodhesha i shtruar dhe unë, në të njëjtën kohë me të. Vuante nga një sëmundje zemre dhe kriza astme. Mjekët ishin shumë të përkushtuar për t’ia lehtësuar dhimbjet. Mendova se në çastin e prishjes me Jugosllavinë mund të përfitonte nga ndonjë amnisti, por nuk ndodhi kështu. I qëndroja shpesh te koka natën dhe dëgjoja me dhimbje të madhe rënkimet e tij për shkak të astmës. U përpoqa t’i bëja masazh te këmbët, siç bënim shpesh me të burgosurit e sëmurë. Problemi ishte se bënte shumë ftohtë. S’kishim dru mjaftueshëm për ta mbajtur zjarrin të ndezur gjithë natën. Dhe ishim gjithë kohës në errësirë. Peshkopi më kujtonte fjalët e Gëtes: “Dritë, më shumë dritë!” Ai përsëriste fjalët e proverbit shqiptar “T’u bëfshin sytë dritë për botën!” Ishte një thirrje për një mendim të ndriçuar, por edhe për spiritualitet dhe misticizëm. Vinçenc Prendushi pati fatin e zi që njohën shumë shqiptarë të tjerë, duke pranuar të vdesin pa i tradhtuar bindjet e tyre. Vdiq në shkurt 1949. Ia mbylla unë sytë. Gjeti paqen. Vdiq për idealin e tij.


- Kur mendoni të ktheheni në Shqipëri për t’u takuar me të afërmit, me të cilët jeni ndarë prej kaq shumë kohe dhe s’keni mundur as të mbani korrespondencë?

- Do të kthehem në Shqipëri pas disa muajsh, kur procesi demokratik të ketë nisur mirë; do të shkoj pas mbi tridhjetë vitesh mungesë. Ç’lumturi të shoh tokën time të lindjes dhe familjen time pas një mungese kaq të gjatë, si një natë e përjetshme heshtjeje!

Arshi Pipa s’reshti së luftuar me pendë që kultura e vendit të tij të mos zhdukej. Përmes diskutimeve që patëm, dukej se nuk kishte synim të angazhohej politikisht, por si demokrat i sinqertë, donte të mbështeste ecjen e shqiptarëve drejt demokracisë. Kishte shpirt mjaft liberal.

Profesor Arshi Pipa e vlerësonte shumë që zëri i tij të mund të dëgjohej në konferenca në Evropë në një periudhë kur mediat interesoheshin për përmbysjet në ish-vendet e Lindjes. Në ndërhyrjet e tij publike, ai nuk e paraqiste veten si viktimë, duke qëndruar i rezervuar lidhur me rrugëtim e tij personal. Fliste më shumë si njeri i letrave dhe filozof dhe i analizonte zhvillimet politike në një kontekst të zgjeruar. Në bisedat private, kishte humor si gjithë banorët e Shkodrës. Më fliste shumë për letërsinë, sidomos për letërsinë italiane, me të cilën ishte shumë i lidhur. I pëlqente të tregonte anekdota të nxjerra nga tregimet e *Dekameronit* të Bokaçios që ia kishin ushqyer imagjinatën në burg. Një ditë, më foli duke qeshur për periudhën që kishte jetuar në Shqipëri pas daljes nga burgu:

- Pas dorëheqjes sime, familja ime u ndodh në mjerim. Unë dhe motra, jetuam duke shitur kopsa që i prodhonim vetë me argjilë që e nxehnim dhe e thanim. Pastaj prisnim rrotullame ku bënim vrima për të kaluar fillin dhe i lyenim këto kopsa me ngjyra të ndryshme. Ime motër, që ishte e detyruar të punonte në një fabrikë tullash, ishte shumë e zonja për këtë. Çfarë s’na



është dashur të bëjmë për një garuzhde me supë!

- Çfarë pune e bukur për një intelektual! thashë, ndër-kohë që mund t’i kishit përdorur dijet tuaja për të arsimuar rininë. Shqipëria u privua nga intelektualët më të mirë duke i shfarosur, duke i burgosur ose duke i degdisur nëpër fshatra për të punuar tokën. Çfarë shpërdorimi! Përveç disa njerëzve me integritet, pseudo-shkencëtarët dhe pseudo-studiuësit që përbënin elitën e re intelektuale nuk reshtën së kënduari refrenin e këngëve të Partisë dhe së mburruri mendimtarët Marks, Engels, Lenin dhe Hoxha. Më kujtohet një profesor letërsie, ithtar i realizmit socialist, shkrimet e të cilit kritikonin letërsinë klasike, që më shihte me sy të egërsuar kur kryqëzohesha me të në korridoret e Bibliotekës kombëtare.

- Duhet të ketë qenë Koço Bihiku. E kam vuajtur edhe unë armiqësinë e tij. Ka qenë nxënësi im në Durrës. Mori pjesë në dënimin tim.

- Po, pikërisht për të e kam fjalën.

Arshi Pipa kishte qëndruar gjithmonë i rezervuar për sa i përket persekutuesve të tij.

Kur e takova profesorin një herë tjetër, isha kureshtare të mësoja opinionin e tij në lidhje me atë që shqiptarët e quanin “gjuha e unifikuar”, gjuha zyrtare e Shqipërisë e përpunuar me kujdes në fillimet e sistemit komunist; ndaj e pyeta për këtë çështje:

- Në kohën e qeverisjes së Enver Hoxhës, kam vënë re shpesh një varfërim të gjuhës shqipe, duke lexuar shtypin dhe dokumentet e propagandës si dhe botimet universitare. Në to shpalolet një gjuhë e ngurtë, uniforme, e varfëruar nga pasuria e fjalorit të saj. Ishte si e filtruar, e mbrujtur me vetëpërmbajtje, e zbutur, puritane, e mbajtur në kontrollin e *Sigurimit*. Përmes shprehjes gjuhësore, mund të dalloje lehtë studiuësit cilësorë që dëshmonin një penë novatore dhe që shpalosnin një gjuhë jashtë kornizave.


- Po, e kam vënë re, por dua të kujtoj një prej betejave të mia, atë kundër vendosjes së asaj që quhet gjuha e unifikuar, m’u përgjigj Arshi Pipa. Duhet folur për turpin e reformës që nisi që prej vitit 1972 për të krijuar një gjuhë të re letrare.

E ndërpreva profesorin:

- E di që shqipja është një gjuhë me dy dialekte, e përbërë nga toskërishtja në Jug, që flitet në fushën e Myzeqesë dhe midis Beratit dhe Korçës me disa variante krahinore, dhe gegërishtja, e folur në Veri deri në Elbasan edhe ajo me variantet e saj krahinore, si dhe në Kosovë e Maqedoni. Përveç dallimeve të tjera, toskërishtja përdor ë-në e pazëshme dhe pengesën në përdorimin e r-së, gegërishtja dallohet nga përdorimi i hundoreve. Ju keni shkruar mjaft vepra në anglisht, por librat e parë dhe kujtimet tuaja janë shkruar në dialektin gegë. Tani, shqipja që mësohet dhe të gjitha shkrimet që kam lexuar, që mbulojnë periudhën pas viteve pesëdhjetë, janë hartuar në dialektin toskë.

- Format gjuhësore që gjeni janë ato që i përkasin asaj që e quaj ULLA, shkurtim i termave anglisht *Unified Literary Language of Albania*. Politika gjuhësore e qeverisë komuniste ishte të sheshonte dallimet dhe të krijonte një mënyrë të shprehuri të përbashkët.

Pata dëshirë të qeshja duke dëgjuar termin ULLA, sepse, ato vite, shiheshin shpesh në mure reklama erotike mbi të cilat shkruhej me shkronja të mëdha emri ULLA përkrah një fytyre gruaje të tipit nordik, e shoqëruar me një numër telefoni të Minitelit rozë. Por ruajta seriozitetin dhe vazhdova të dëgjoj profesorin.



- Para luftës, në vitin 1917, në Shkodër u krijua një komision letrar. Ai mendoi për konvergjcencën e dy dialekteve duke zgjedhur dialektin gegë të Shqipërisë së Mesme, atë të krahinës së Elbasanit me qëllimin që të mbërrihej në një gjuhë letrare të përbashkët. Kjo zgjedhje ishte propozuar nga gjuhëtari i madh Gustav Weigand që kishte botuar në Lajpcig, më 1913, një gramatikë të shqipes në dialektin e jugut të Gegërisë. Ai mernte parasysh të folurat e krahinave të Durrësit, të Tiranës dhe të Elbasanit. Pas vitit 1950, mbizotëroi vija ideologjike e partisë komuniste shqiptare. Ajo u frymëzua nga një shkrim i Stalinit *Marksizmi dhe gjuhësia*, botuar më 1950, që thotë se, kur dy gjuhë janë në konflikt, njëra prej tyre fiton dhe tjetra vdes. Ai i referohej teorisë së N. Marr, një gjuhëtar gjeorgjian, që mbështeste idenë se fjalori i një gjuhe duhet ta dominojë tjetrin. Në fakt, midis dy dialekteve të shqipes nuk kishte konflikt. Ime më ishte një geqe dhe im atë ishte toskë. Kur nuk kemi pasur mosmarrëveshje në të shprehur, as në të shkruar. Me vendosjen e komunizmit, me të shpejtë u ndalua që të flitej gegërisht në shkollë, zyra dhe në radio. Një dhjetë vjet, iu dha fund një bashkëjetese shekullore të të dy dialekteve. Gegërishtja u zhduk nga librat shkollorë. Qeveria kërkonte një reformë të shpejtë. Megjithatë, një gjuhëtar i madh shqiptar, Eqrem Çabej, thoshte se studimet nuk kishin përparuar mjaftueshëm dhe se duhej një përafrim i vazhdueshëm në kohë. Edhe ky gjuhëtar ka vuajtur; ai u izolua për “pikëpamje të huaja”. Më 1954, fjalori i shqipes, drejtuar nga Androkli Kostallari, drejtori i Institutit të Gjuhësisë në Tiranë, vulosi hegjemoninë e toskërishtes. Nuk duhet harruar se shumica e drejtuesve komunistë ishin toskë. U krijuar një gegofobi e vërtetë, ndërkohë që gegërishtja dëshmonte për një pasuri shumë të madhe fonetike të ilustruar nga autorët tanë më të vjetër. Për qeverinë komuniste, kjo çështje e përqaimit të një gjuhe letrare të përbashkët duhej zgjidhur detyrimisht sa më shpejt. Meqë autorët e parë shqiptarë dhe shkrimtarët më të mëdhenj të shekujve XVI dhe XVII ishin produkt i gegërishtes dhe, njëkohësisht, i priftërinjve katolikë, Partia rekomandoi hedhjen poshtë të dialektit gegë.

- Ju përmendni Androkli Kostallarin. Më kujtohet ajo që nxori nga goja kur erdhi të mbante një kumtesë në Institutin e Gjuhëve orientale në kuadrin e shkëmbimeve kulturore me Francën. Ai e paraqiti shkencën gjuhësore shqiptare sikur të ishte krijuar e gjitha që prej vitit 1945, nga hiçi. Ai deklaroi se para Çlirimit s’ishte bërë asgjë: as fjalorë, as gramatika. Pohimet e tij ishin madje qesharake. Me gojën e tij u shpreh mendimi i partisë komuniste shqiptare që kishte shtënë në dorë të gjithë prodhimin shkencor shqiptar dhe që zbatonte një nacionalizëm të dhunshëm. Mund të shfaqësohej, duke menduar se në sallë duhet të ishin disa bashkëpunëtorë të vendit të tij, të ngarkuar të mbikëqyrnin fjalën e tij? Megjithatë, shkrimet e tij përforconin ato që thoshte. Si mundej ky gjuhëtar t’u vinte fsheën autorëve të gramatikave dhe fjalorëve si Frang Bardhi që kishte botuar një fjalor latinisht-epirot më 1635, Gaspër Jakova, autor i një gramatike, Pjetër Mazreku nga Prizreni, autor i një fjalorthi, pa harruar fjalorin shqip-greqisht të Kostandin Kristoforidhit në shekullin XIX dhe fjalorët e Nikollë Gazullit, të vrarë më 1946?

- Për mendimin tim, u përgjigj Arshi Pipa, autoritetet donin të hidhnin poshtë ndikimin e botës latine, atë të Perëndimit. Ata donin gjithashtu, dhe sidomos, të zhduknin elitën intelektuale të Veriut që nuk kishte qenë vazhdimisht aktive gjatë shekujve dhe që kërcënonte të krijonte një lëvizje opozite në mendjet e njerëzve. Për këtë qëllim, të gjitha dokumentet e Partisë, që në fillim, u hartuan në toskërisht. Shtyp, radio, teatër, kinema,

të gjithë sektorët e jetës kulturore u desh të binden. Në dhjetë vjet, iu dha fund bashkëjetesës shekullore të dialekteve. Gegërishtja u ndalua, por gjuhëtarët, të ngarkuar të sajnin ULLA-n, u detyruan të merrnin fjalë specifike të gegërishtes që nuk gjendeshin në toskërisht dhe t'i toskëzonin.

Thellë-thellë mendova: “është tamam ULLA, një lloj prostitucioni i gegërishtes”, por e lashë Arshi Pipën të flasë:

- Gjuha shqipe është damkosur nga ai shtet totalitar që ishte Shqipëria në periudhën e pushtetit stalinist. Qeveria donte të formëonte një shtet homogjen nën flamurin e komunizmit. Ajo zbatoi sloganin “një komb, një gjuhë”, duke imponuar në të gjithë territorin “gjuhën e unifikuar” që nuk ishte rezultat i një përafrimi gradual, konvergenca e natyrshme e dy dialekteve të shqipes; me vendime të shpejta dhe të befta, ajo sanksiononte zgjedhjen e toskërishtes, dialektit jugor në dëm të veçantive të gegërishtes, dialektit verior. Kështu mund të realizohej hegjemonia e Jugut mbi Veriun. Rasti shqiptar ilustron qartë se si një pushtet politik arbitrar mundet të manipulojë armën gjuhësore për t'u imponuar në të gjithë territorin. Tash e tutje, gjuha e unifikuar mund të propagandonte ideologjinë.

- Mendoj se këto ndryshime të befta duhet të jenë pritur keq në Veri.

- Po, por gegërishtja u ruajt në familje. Dijeni se gramatikat e botuara jashtë shtetit, ajo e Namik Resulit, botuar më 1985 në Padova, ajo e Oda Buchholz dhe ajo e Wilfried Fiedler në Lajpcig më 1987, si dhe ajo e Martin Camajt botuar në Wiesbaden më 1984, respektojnë elementet përbërës dhe zhvillimin e gjuhës shqipe. Ajo që do të ndodhë në lëvizjen aktuale, është një rilindje e gegërishtes, veçanërisht në bisedat midis njerëzve të Gegërisë; do të ketë debate, por gjuha letrare e unifikuar do të mbijetojë. Është tepër vonë për një ndryshim.

Duke menduar për ligjërimin që profesor Pipa kishte mbështetur në disa botime, i bëra pyetjen:

- Çfarë mendonin për ju në Shqipëri, sepse të gjitha demonstrimet tuaja, të gjitha të vërtetat që mbronit në shkrimet tuaja, edhe pse nuk mund të lexoheshin në vend, duhet të kenë shkruar në veshët e drejtuesve shqiptarë dhe të elitave komuniste?

M'u përgjigj:

- Isha në dijeni të gjithçkaje shkruhej për mua, të të gjitha fjalëve poshtëruese që thuheshin për mua. Kjo nuk më frikësoi dhe nuk më bëri të ndryshoj mendim.

- Por u prek nderi juaj.

- Po, por s'kam urrejtje. Ky ishte një qëndrim tipik komunist. Nuk e di nëse kritikët e mi e mendonin vërtet atë që thoshin apo shkruanin. Më kritikonin që të shiheshin me sy të mirë nga regjimi. Nxiteshin ta bënin këtë në klimën e frikës që mbretëronte, për të treguar se nuk ishin kundërshtarë dhe se nuk i miratonin idetë e intelektualëve shqiptarë të mërguar. I trembeshin burgut.

Përmenda opinionet që ishin lëshuar kundër profesorit:

- Kam gjetur shumë herë formulat e zakonshme të fjalimeve për të luftuar kundërshtarët jo vetëm në shkrimet e Enver Hoxhës, që kishte shkruar dhjetëra vepra, por edhe në ato të shkrimtarëve dhe studiuesve shqiptarë si në Shqipëri dhe në Francë. Opozitarët shqiptarë trajtoheshin si agjentë të CIA-s, agjentë si UDB-së (shërbimet sekrete jugosllave), si revizionistë dhe social-imperialistë etj.

Arshi Pipa, pa iu dridhur qerpiku dhe pa mëri, m'u përgjigj qetësisht:

- Po, më quanin agjent të CIA-s. Kritikën kundër meje shkonin deri në paranojë.

- Në fakt, në veprën e tij *Titistët*, Enver Hoxha e bëri këtë akuzë kundër jush, një akuzë krejt klasike.

- Madje shkroi se isha arratisur nga vendi im me shpresën se do të fitoja lavdi në Perëndim dhe se isha shkrimtar mediokër, pa lavdi dhe xheloz për shkrimtarët shqiptarë të realizmit socialist. U akuzova si denoncues. Madje më kritikonte se isha plak dhe i sëmurë.

- Ndërkohë që dhjetë vitet e burgut që keni kaluar duhet të ngjallin respekt. Në të njëjtën kohë me kritikën që synonin që ju të konsideroheshit si spiun, si një nga armiqtë më të frikshëm të regjimit, kundër jush qarkullonin lajme të rreme, si ato që thoshin se ishit arratisur në BRSS dhe kishit shkruar një biografi të Enver Hoxhës. Kjo s'kishte kuptim.

Mendova se kishte ardhur koha të mbrohej nderi i profesor Pipës, një nga viktimat e shumta të komunizmit shqiptar dhe e vërteta të dilte në shesh.

Profesor Arshi Pipa nuk ishte hakmarrës dhe nuk donte të hynte në polemikë. Shqetësimi i tij kishte qenë lufta kundër një ideologjie shkatërrimtare. Ai s'kishte urrejtje personale kundër kritikëve të tij.

Arshi Pipa vdiq më 20 korrik 1997 në SHBA. Guximi dhe vlerat intelektuale të këtij humanisti u shpërblyen. Ai u shpall qytetar nderi i Shkodrës. Aktualisht, kujtimi i tij përjetësohet dhe nderohet nga shtëpia botuese Camaj-Pipa që mban emrin e tij krahas atij të një shqiptari tjetër, shkrimtar i emigracionit: Martin Camaj. Ka gjithashtu dhe një çmim letrar Arshi Pipa.

Si patriot besnik, profesor Pipa ruajti dhe mbrojti kujtesën kulturore të vendit të tij. Shqipëria i dha më në fund vendin që meritonte këtij dijetari të madh, mbi të cilin ishte hedhur baltë dhe i ngriti një bust ashtu si vëllait të tij, edhe ai patriot i madh i martirizuar.

Përktheu: Tomi Nakuçi

Mbi romanin “Djali memec” të Virion Graçit

METAMORFOZA DHE DRAMAT NJERËZORE SHQIPTARE PAS VITEVE '90

Nga Dr. Jolanda Lila

Stinët e jetës shqiptare janë shndërruar shpeshtazi, në s'varësi të erërave politiko-shoqërore që kanë lëvritë përgjatë vendit në kohë të ndryshme. Rënia e komunizmit u konsiderua si ardhja e pranverës në jetën shqiptare, por edhe sot, pas më shumë se tri dekadash, pranvera duket ende larg, sepse siç thuhet në një nga pasazhet e romanit “Djali memec”, *“kohët e reja kishin shenjat e veta të veçanta. E mira dhe e keqja, fati dhe kobi kishin ndryshuar mënyrën e të trokiturit në dyer, kurse për paralajmërues as që ishte nevoja...”*.

Shpopullimi masiv i zonave rurale drejt atyre urbane, zhvendosjet nga veriu në jug dhe së fundmi, largimet masive të shqiptarëve drejt vendeve të ndryshme të botës janë vraga më e thellë e shoqërisë sonë drejt kaosit kuturu dhe dëshmia më e prekshme e tranzicionit të stërgjatë të shqiptarëve, ku drita e qashtërsisë dhe e ngrohtësisë duket ende larg. Këto lëvizje të pandërprera, shoqërohen me përplasje kulturash, mendësish dhe me drama e trauma psiko-shoqërore të popullsisë. Pikërisht në asht të kësaj problematike depërton romani “Djali memec” i autorit Virion Graçi, i cili bën një skanim të imtësishëm të gjendjes shpirtërore, psikologjike, ekonomike e shoqërore të shkularakëve, pra të njerëzve që braktisin shtëpinë dhe vendin e vet për t'u vendosur diku gjatë.

Ky është ndër romanet më sintetizues dhe gjithëpërfshirës të tërësisë së problemeve që ngritën krye pas vendosjes së sistemit demokratik në Shqipëri. “Nga sistemi totalitarist shtetëror *kontroll mbi gjithçka*, është kaluar në sistemin e ri qeverisës *gjithçka jashtë kontrollit*” - thotë narratori gjatë romanit. Është një nga krijimet prozaike më dinjitoze që fshikullon përmes një gjuhe dinamike rrëfimtarië përdhosjen që iu bë aspiratave për liri dhe demokraci të shqiptarëve, si dhe përshtatimit të rrëpirave të thella të zhgënjimit, me të cilat u ndesh shoqëria jonë.

Pamja është thuasë e njëjtë në çdo cep të Shqipërisë, *“Karvanë mushkash e kuajsh të ngarkuar me plaçka, foshnja që qajnë, gra që përlohen tek kthejnë kokën pas; burra të zhburrëruar nga pamundësia për t'i dalë zot familjes, vetes,*




gjyshërve: stomakë të zbrazur, këpucë të grisura, tesha trupi të stërpërdorura, të arnuara”.

Romani është botuar në vitin 2016 nga Ndërmarrja botuese “Gjon Buzuku”, Prishtinë dhe asokohe, është vlerësuar edhe me çmimin e dytë të konkursit letrar “Buzuku” për kategorinë e romanit. Përtej çmimeve e vlerësimeve kritike të kohës, jehona e këtij romani vijon të kumbojë, për shkak të mesazheve universale dhe mbi të gjitha, në sajë të vlerës aktuale që bart rrafshi tematiko-motivor i romanit.

Është në metodologjinë e punës krijuese të autorit ngërthimi i problemeve të kohës, të cilat letrarizohen prej tij dhe marrin një trajtë shumështrësore, ku ravijëzohen kohë, hapësira, personazhe, ngjarje dhe dukuri të ndryshme të jetës njerëzore. Rrëfimi i këtij romani mbështetet në një histori tërësisht të vërtetë, të cilën autori e sjell besnikërisht nga shtypi shqiptar: *“Babai vret në gjumë djalin 16-vjeçar. Policia: e gjetëm të vdekur në krevat, i mbuluar me çarçaf, viktimë ishte jetim nga ana e nënës. Autori deklaroi për policinë: “Unë e vrava tim bir. Ishin kushtet që më detyruan të ndërmarr një veprim të tillë. Më vjen keq për ngjarjen, më vjen keq për djalin tim pasi ai, djali im ishte urata ime”*. Duke marrë shkas prej kësaj historie, shkrimtari depërton në thelbin e ngjarjes dhe në origjinën etiko-sociale e filozofike të problemit. Ai nuk kërkon gjurmët dhe kronikën e ngjarjes, por si një dedektiv i detajeve, ai thellohet në shtresat e problemeve të rënda sociale e psikologjike që majisin plagët e jetës së kësaj familjeje, e cila u shpërngul nga një fshat i thellë i veriut drejt një fshati të jugut. Në vend të jetës më të mirë e larg klimës së gjakmarrjeve primitive të fshatit verior, ata gjetën “fillimin e një apokalipsi”. “Do të lindë një ndarje e re klasore, e madhe dhe përjashtuese midis banorëve: *vendas dhe të ardhur*, shkularakë. Kudo vendasit do të fillojnë një fushatë vetëmbrojtjeje dhe përjashtimi përçmues ndaj *shkularakëve*, në të njëjtin qytet, në të njëjtin lagje, në të njëjtin bllok apartamentesh, në të njëjtin shkollë...”. Këto emërtesa diferencuese janë vetëm maja e ajsgut, pasi stigma, përçmimi dhe përveçimi do të ndeshin në çdo aspekt. Pikërisht me këtë përplasje të madhe mendësish, shkrimtari krijon në analogji me të edhe përplasjen mes babait dhe djalit adoleshent, ku si pasojë e absurdit dhe moskomunikimit mes tyre, djali memecërohet përjetësisht sapo hyn brenda shtëpisë, ndërsa babait kthehet në natyrë tejet hermetike sapo del jashtë shtëpisë. Është pragu i shtëpisë, kufiri-simbol mes komunikimit të njërës palë dhe moskomunikimit të palës tjetër. Në një klimë të tillë, jeta bëhet e pamundur dhe tensionet shkojnë në tonalitetet më të larta. Lexuesit i mbetet të zbulojë detajet dhe të përfshihet në këtë histori të zakonshme të realitetit shqiptar, që përcillet me mjeshtëri të jashtëzakonshme nga shkrimtari, i cili të rëndomtën e estetizon në rrafsh shumëdimensional.

Romani “Djali memec” spikat jo vetëm për trajtimin origjinal të temës, por edhe për nga pesha e dramës dhe sinteza e ideve, nga dendësia e jetës dhe nga forca përgjithësuese në tërësi.

VIRION GRAÇI ROMAN DJALI MEMEC



“Një familje pelegrine veriore drejt jugut shqiptar. Pastaj nëntëdhjetështata. Nuk duhet ditur shumë. Nuk duhet folur tepër. Flet letërsia si ashkush tjetër.”

BUZUKU

Në udhëtimin tim bashkë me poezinë e Petrit Rukës, në drejtim të Tepelenës vendlindjes së tij, me një shkrim aq të çiltër dhe të paharruar, miku i *poetit të ndierë*, poeti dhe prof. Sadik Bejko, pati fatin ta njohë në kohën e ekzilit të tij politik, duke shkruar metaforigjikisht për “shkollën” tepelenase të poetëve të kohës si: **Petrit Ruka, Qazim Shema, Ilirjan Zhupa** etj., në shkrimi e tij të botuar tek ExLibris, u shpreh se Petriti: *shkroi poezinë me motiveve labe me lëndë në legjenda dhe në histori*, (Bejko: 20121). Më përtej poezisë, për të gjetur *thagmën poetike*, atë kryefjalën ose kryesemën që mbështjell si një peshtaf *lirikën polifonike* të Petrit Rukës, duhet të gjejmë më parë çelin magjik që hap “kodin” e poezisë së tij.

PETRIT RUKA, POETI MODERN I BALADËS SHQIPTARE

Nga Emrije Krosi

Libri poetik “Shami të zeza qiellore” i Petrit Rukës, (Toena, 2019) është konceptuar në gjashtë (6) pjesë dhe botuar me rastin e gjashtëdhjetepesë (65-së) vjetorit të lindjes. Poezia përfshin tematika të shumta, universalja dhe përmasa e *dashurisë njerëzore*, mirazhi i *atdheut*, *ekzili* dhe *braktisja e vendlindjes*. Aty është edhe përmasa e dashurisë erotike, shndërrimi urban i qytete dhe fshatrave shqiptarë, përditësia, ironia, inatet, xhelozitë, miqtë, pse jo edhe vdekja, se poetët gjithnjë janë “paralajmërues” të vdekjes së tyre, dhe “testamentet” e pasjetëve janë veprat e tyre. Për të kumtuar më tej, dhe përimsuar poetikën e *thellësisë* si dhe *simbolikat metaforiale* ku sundojnë *figurat e thella* (Murry: 1931), ndërtohen të gjitha *topikat* dhe *(nën)topikat* metaforiale.

a. TOPIKA DHE DEKODIMI I METAFORËS SË JUGUT në pjesën e parë; (*gjërat e mia të vogla*), ku futen disa poezi: “*Grua e jugut*”, “*Duhemi ne dhe bota ka fat*”, “*Dashuria ka shijen e fortë të vdekjes*”, “*Kristina*”, “*E bukur si drita mbi verë në dasma*” etj. Përmes vargjeve: *jemi dashur tërë jetën dhe s’e paskemi ditur, / derisa u ulëm në atë kafe/o Grua e Jugut/derisa pime gllënjë pas gllënjke/gjer në fund njëri-tjetrin./ etjen e deveve shtatzëna prej muzgut...*, f. 15, dukshëm dallohet dekodimi i metaforës në togfjalëshin me shkronja të

mëdha **Grua e Jugut**, tregon se poeti ka përfshirë aty të gjithë folkun e trevave të Labërisë, që shquhet edhe për lirikën dashurore, por edhe baladat të sendërtuara në këtë vëllim poetik, duke u mbështetur tek *magjia e lirikave labe*, (Borja: 2014). Mënyra e rimarrjes së folkut, të risjellë nëpërmjet vargjeve të poezisë moderne, mund të quhet edhe *si përpunuesi poetik i muzës gojore moderne të jugut*, në udhën e mbledhësve dhe përpunuesve paraardhës si **Thimi Mitko**, apo **Mitrush Kuteli** etj.

Por, dallojnë edhe (nën)topika tjera si:

a) (nën)topika e vendlindjes: (Tepelena dhe Vjosa përsëriten [secila (3) *tre herë*])

b) (nën)topika e Jugut: (topikë e fshehur pas vajzave dhe grave të gjithë Jugut, pas Çamërisë, Vjosës, pas maleve dhe kodrave por edhe pas breshkës së fëmijërisë),

c) (nën)topika e dashurisë,


d) (nën)topika e vdekjeve me elemente të mitologjisë romake dhe judeo-hebarike: (Vezuvi, Juresalemi, Maria Magdalena, Muri i Lotëve etj).

b. TOPIKA DHE DEKODIMI I METAFORËS PRINDËRORE, në pjesën e dytë: (*letra me nënën dhe babanë*) ku spikatin poezitë: “*Babai se mbajti premtimin*”, “*Baba, ne ikëm*”, “*Letra me babin*”, “*Shkova te nëna*”, “*E shkreta nëna ime*” etj. Në këto



poezi, që kanë jo vetëm peshën e marrëdhënieve prindër-fëmijë, por edhe ndikohen nga lidhja: baba+bir+nënë= Pema e Gjakut (babai+biri)+Pema e Tamlit, (nëna+biri)= Pema e Jetës. Kjo marrëdhënie, është shumë e hapur nuk është as *palimpset* as *ndërtektori* as një *dërfutje poetike*, (Todorov: 2000), që e lidh me gjithçkanë: historinë, filozofinë, sociologjinë, teologjinë apo edhe modele të tjera shkrimore të risjella nëpërmjet vargjeve: **ikëm, or ikëm! Vendlindjen e vramë/në metropole u mblodhëm si punë e iriqëve, /e ke parasysht kur e vjelin një pemë/e mblidhet dhe ngjishet si në vargjet e fiqve?**, f.67. Zbrasja e fshatit shqiptar tashmë është një realitet. Poeti kërkon të “mbajë gjallë” kujtimet, nëpërmjet *modernizimit të miteve, legjendave, baladave, erosit dhe folkut popullor*, ku fytyra e pormodernitetit shkakton probleme sociale dhe shoqërore: ikja apo *zbrasja e fshatit*, (e) *migrimi* etj. Gjuha e kuptueshme që përdor poeti në komunikim me lexuesin, nuk është një *lloj tjetërsimi* (Parker: 2011) por një reflektim që riprodhon (me fjalë) tërësinë e realitetit me një lloj kumtimësie vetëpërmbytësore të një gjuhë të thjeshtë, si shpalim nëpërmjet vargjeve: *shkova të çmallem te nëna në fshat/çudi, ...nuk qau, s’u bë shëlg, s’u shkund, /qenkam rritur, thashë me një gëzim të prapë/burrëria e frenoi, eh, më në fund!*, f.70. Në këto vargje kam hetur: [gjithej fjalën baba=15 herë/fjalën nënë =15]. Brenda dikotomisë së fjalëve baba-nënë, *etimologjia* e fjalës nënë na jep edhe disa njësi të tjera që jo absolutisht lidhet me të *folmen e poetit* me dialektin e jugut si: [nënë=nënoke=mama=mam etj.].

c. TOPIKA DHE DEKODIMI I METAFORËS DASHURORE DHE EROTIKE, në pjesën e tretë, me kryepoezinë hit: “*Këngë për gruan*” dhe vargun apokaliptik “ma ke nxirë jetën”, një poezi kaq e thjeshtë e ngulur thellë në kujtesën e lexuesve shqiptar por edhe *lexuesve virtuale*, si një poezi aq shumë e ndierë, e thjeshtë, e bukur e shkruar me një *shqipe të kulluar* por edhe qëndisur me *idile erotike* që kulmojnë në të gjitha poezinë e Rukës. Ishte (mënyra e tij e shmangies nga realizmi socialist) “zhytja” dhe “tjerrja” apo *tëhuazimi i dhimbjes* ndaj mllëfit të fatit, vdekja e babait, por edhe ikja nga vendlindja etj., gjuha dhe ndikimet e folklorit të labërishtes në krijimtarinë poetike, (Gaçe: 2005). Vargjet : **grua ma ke nxirë jetën dhe jetën ta kam nxirë/më ke prirë gjithë vrerin dhe helmën ta kam pirë/po ja që nuk bëjmë dot pa këtë helm të mallkuar./mos pushofsh kurrë, luftë, qofsh e bekuar**, f. 88, bashkë me poezitë e tjera: “*Gratë anohen anash*”, “*Të takohesh me Zotin*”, “*Të thashë mos e fik dritën*”, *Këngë labë për ty*”, “*Sytë e tu, sytë e tu. Sytë e tu e ata sy*”, “*Ëndërr me nuse*”, “*Vjosa meket si grua*”, “*Dhe prita ta zgjohesh*”, “*Letër mamit*” etj. Elementet erotike sendërtohen edhe si nëntitull në një poezi (etyd dashuror). Poeti ka mbledhur të gjithë mitologjinë, erotikën, folklorin e labërisë dhe të gjithë Shqipërisë, që spikat në formën e një *ligjërimi të moralshëm* apo edhe kur kemi të bëjmë me mundësinë e *realizimit të dashurisë* (Sula: 2016). *Errësira* na vjen si një oaz parajsor ku mund të prehet *shpirti* dhe *trupit* të munduar prej *ndjenjave të ndrydhura* por për njeriun e dashuruar dhe të përfshirë plotësisht në këtë përjetim, është prania e “shtëpisë së Zotit”, tek poezia “*Të takohesh me Zotin*” pikërisht është vendi ku ai ka njohur dashurinë, sepse pikërisht aty ai ka zhvilluar atë përmasën shpirtërore unike që e afron njeriun me Zotin. Uni lirik, që realizon këtë përsiatje të brendshme sentimentale, është zhytur në një përjetim emocional dashuror të thellë dhe dëshiron që të jetojë përjetësisht brenda të *njëjtës izotopi erotike*, (Lotman: 2001), me disa (nën)izotopi të tjera:



- **(nën)izotopia e parë:** *erosi i hapur ose i ligjshëm burrë/grua:* përcakton se burimi i

kënaqësisë që marrim nga letërsia, gjendet në procesin e transformimeve të dëshirave dhe frikrave tona subkoshiente. Se marrëdhënia brendapërbrenda kufijve të (id)-fantazive dhe (ego)-mbrojtjes, forma e tekstit, është përcaktuar si një mënyrë e fshehjes mes autorit dhe lexuesit, duke “çliruar kënaqësi” estetike, bashkë me kënaqësinë e *nënkuptuar seksuale*, (Neret: 2000)

- **(nën)izotopi e dytë:** *erosi i fshehtë apo dëshiror* (ëndërrat, sytë), sytë krahasohen

me ujin me Vjosën, por vetëm (syri) jo forma e syrit (irisi) me ngjyra si: i zi, jeshil, ulli etj., vetëm shikimi është si lumi i Vjosës, ashtu si edhe trupi i saj, në poezinë: “**Vjosa meket si grua**”, një *krahasim* me malin e Shenjtë Arafat. Simbolika me elementet bibliko-hebraike shpërfaq *poetikën krahasuese* nëpërmjet *gjuhës erotike të trupit*, (Elsie: 2001).

- **(nën)izototi e tretë:** *erosi i papërmbushur dhe gjithëdëshiruar burrë/grua:* është thelbi i

arsyes dhe i ndjenjave, sipas Frojdit: *ka vetëm një formë dashurie, dhe kjo është dashuri erotike*, sepse mitikja e rrëzon “mitin” e Super Egos. Në poezitë e lirikës erotike dominojnë *shënjeshtet tekstuale* që enden mes kulturës dhe komunikimit, por edhe si sythe të semiotikës së kulturës erotiko-dashurore.

d.TOPIKA DHE DEKODIMI I METAFORËS SË ATDHEUT/VENDLINDJES/MALLIT, në pjesën e katërt:

(*ribotime të viteve*) na paraqet *pamje ilidike* nga fshati, nga mali dhe fusha, përsëri duke udhëtuar në lëminë e gurrës popullore, madje *simbolika e vajzave* që punojnë në *fusha* dhe *ara*, me *kaun kazil* (emër kau), ku vetë ironia nënshtresëzohet përmes rrjeshtave të nënkuptuara për atdheun e bukur, por të varfër.

a. Topika dhe dekodimi i metaforës së baladave; në pjesën e pestë; (*balada*),

riaktivizimi i baladave zë pjesën më të madhe të poezisë së poetit. Në këtë trajtesë do ndalojmë, pak më gjatë tek baladat. Vetë fjala **balada** (nga

wikipedia) është një formë e veçantë e letërsisë gojore, në të cilën janë të përziera *elementet epike e dramatike*, por me zotërim të elementeve lirike. Emri i saj del nga folja neolatine **ballare** (vallëzoj). Në fjalorin e Gjuhës Shqipe fjala: **balád/ë,-a** emër i gjinisë femërore; numri shumë: [-**a(t)**] term në letërsi; vjershë **lirike popullore** ose me frymë popullore për ngjarje legjendare a heroike. Baladat shqiptare, mbizotërojnë këto elemente: elementin *dramatik*, *lirik* apo *epik* me qendërzim *tragjikja individuale*. Baladat me tema: “**Vashëza, puthjen e lau**”, “**Nënë ç’ma bëre dilinë**”, “**Baladë pensionistësh**”, “**Balada e Tanës**”, “**U stis vashëza nga varri**”, “**Kanan tu prish bukuria**”, “**Urë moj e zeza urë**”, “**Hanko mos qaj nëpër varre**”, mund të ndahen sipas motiveve:

1. *balada me motive realiste historike:* “**Kanan ti prish bukuria**”,
2. *balada me motive realiste:* marrëdhënie familjare: “**Nënë ç’ma bëre dilinë**”, “**Vashëza, puthjen e lau**”.
3. *balada me motive realiste dashurie:* “**Balada e Tanës**”, “**Hanko mos qaj nëpër varre**”

nëpërmjet vargjeve: **dil se urën e Qabesë. Vetëm unë e hodha/ “sa të ketë Dili nuk vdes”/ vdekje sytë ia vodha...**f.172, se baladat shqiptare më së shumti kanë kanë fund tragjik. Ata sjellin pastrim (katarsis) shpirtëror, *edukojnë me idenë e pastrimit moral*, duke realizuar *fisnikërimin e njeriut*, në kuptimin e ndryshimit pozitiv të situatës *që është krijuar pa dashje*, (Haxhihasani: 1982). Rikonceptimi në formë moderne, të baladave nga *njësia parësore*, (burimi autokton popullor), me një mjeshtëri poetiko-stilistikore dhe me konstruktion në bazë të gjuhës së popullit, (e folura e Labërisë) e bën Petrit Rukën *mjeshtër të baladës moderne shqiptare*, jo vetëm për mesazhin por *sidomos për edukimin moral të tyre* , (Jubani: 1871). Stuktura themelore e baladës, ndërtohen në bazë të shprehjes artistike të popullit tonë për çlirim *nga forcat e errëta*, prej pushtuesve të huaj apo vendorë, me *nota elegjiake*, duke ndihmuar për forcimin e dashurisë për atdheun, familjen dhe vendlindjen. Ato kanë mbajtur optimizmin popullor, qëndresën e paepur ndaj *forcave*

regresive që bëhen shkak për fatkeqësi e vuajtje të njerëzve nëpërmjet *përvojës artistike tradicionale* (Gaçe: 2016). Baladat e Jugut janë më të shkurtra sepse *këndohen me polifoni* dhe ato të veriut shoqërohen *ose me sharki ose me çifteli*. Vargjet: *në ato male Labërie/kur bie nata sterrë, kongji/që nga fyejtë e barinjve/ del një Tanë , një llahatari*, f.184, ky motiv i ripërnuar kaq mjeshtërisht nga pena e Rukës, është drejtpërdrejt me origjinë burimore nga *balada e Tanës*, (Gaçe: 2009), që varianti origjinal jeton në Lapardha, fshat në Lumin e Vlorës. *Etnopsikologjia* shqiptare dhe elementet e kulturës tonë kombëtare, spikatin elemente që lidhen edhe me baladat e tjera ballkanike, por që elementet shqiptare dallohen për:


- a) *mbajtja e besës*, (balada e Dhoqinës apo kthimi i Ago Ymerit)
- b) *rinjohja motër dhe vëlla*,
- c) *murimi në ura apo kala*,
- d) *ndarja motër e vëlla*,
- e) *dashuria burrë/grua motër/vëlla*,
- f) *humbja e familjes*, (balada e Hankos, që katërcipërisht është vërtetuar si baladë e humbje së familjes jo dashurore),
- g) *shëndërrimi* (metamorfoza) që ndahet në:
 - *pamundësia e realizmit të dashurisë* (si metamorfozë në një zog, mollë etj.)
 - *dhimbja e motrës për humbjen e vëllait e kthen atë në qyqe*, (motivi i motrës së Hasan Agës).

b. Topika dhe dekodimi i metaforës individuale, në pjesën e gjashtë: (*kam ftohtë*) me poezitë: “**Mërzia**”, “**Kam ftohtë**”, “**Vallja labe**”, “**Dita e humbur**”, “**Dëshpërimi**”, “**Shitës ere**” etj. Janë pjesë ku për të kuptuar vendin e njeriut në këtë botë, hapsira jonë njerzore po ngushtohet, duke vozitur mes *individuales* dhe *absolutes*, në kërkim të parimeve thelbësore jetike , me një perceptim *sa personal* aq edhe *social* të botës tonë shqiptare, si *interaksion gjenerik kompleks* (Hutcheon; 2013). Poeti *ironizon realitetin e hidhur shqiptar* në formë *sarkazme*, jo vetëm si *ironi e fjalës* por edhe *ironi e situatës*, (Dado: 2020), është një teknikë rrëfimi (më shumë romanor) meqë e vë lexuesin para *qëndrimit emocional*, që trajton dukuri sociale dhe shoqërore, në mënyre ironike dhe satirike. Ironia shkon deri në *paradoksin posmodernist*, në formë edhe distancë kritike me realitetin, se poezia është thjesht gjuhë e ngarkuar me kuptim deri në shkallën e *natyrës shenjore*, (Wilde: 1981), pa pretenduar se përgjigja specifike për lexuesit, mund të ketë “emocione” të lumtura apo trishtuese, pa pretenduar se kemi arritur të kuptojmë *kuptimin parësor* të poezisë.

Së fundmi: poezia e Petrit Rukës është një poezi me *metaforë të formësuar polifonike*, ku të gjitha zërat e zhanreve poetike funksionojnë në mënyrë harmonike, brenda shtratit të tij *sa lirik* aq edhe *klasik* dhe *modern*, duke rrokur gjithë *poliseminë e pashfrytëzuar të gurrës popullore* shqiptare të Jugut dhe më gjerë, sidomos ajo e anës së Lumit të Vlorës, Vjosës etj. Kritika të zgjohet nga “gjumi” dhe të heqë *pluhurin e harresës* ndaj mitit baladesk të Rukës, për vlerat e papërsëritshme të poezisë së tij aq të *ndierë* dhe popullore.

BIBLIOGRAFIA:

1. Bejko, Sadik: (20121), *Petrit Ruka: poeti i fjalës së bukur*, “ExLibris”, Tiranë.
<https://exlibris.al/sadik-bejko-petrit-ruka-poeti-i-fjales-i-poezise-se-bukur/>
2. Dado, Floresha: (2020), *Postmodernizmi, poetikë e “antirregullit”*, “Kristalina -KH”, Tiranë
3. Elsie, Robert: (2001), *A Dictionary of Albanian Religion, Mythology and Folk Culture*, Canada.
4. Gaçe, Bardhosh: (2005), Konferenca Shkencore : *Ali Asllani Princi i Lirikës Shqiptare*, “Malika”, Vlorë.
5. Gaçe, Bardhosh: (2009), *Kënga popullore e Lumit të Vlorës*, Toena, Tiranë
6. Gaçe, Bardhosh: (2016), *Etnologjia dhe Folkori shqiptar*, “Ymeraj” Fier.
7. Haxhihasani, Qemal: (1982), *Balada popullore shqiptare*, “Naim Frashëri”, Tiranë.
8. Jubani, Zef: (1871), *Përmbledhje këngësh popullore dhe rapsodi poemash shqiptare*, Trieste.
9. Lotman, Yuri, (2001) *Universe of the mind: A semiotic theory of culture*, I.B. TaurisPublishers, London.
10. Mborja, Ilir, (2014), *Magjia e lirikave labe* “Albplanet”, Tiranë.
11. <http://albplanet.blogspot.com/2014/10/magjia-e-lirikave-labe.html>
12. Murry, J.Middleton: (1931), “Metaphor”, *Contries of dhe Mind*, second series, London.
13. Néret, Gilles: (2000), *Erotica Universalis*, Volume 1, Taschen.
14. Parker, Fred: (2011), *The devil as muse : Blake, Byron, and the adversary*, Baylor, University Press
15. Ruka, Petrit, (2019), *Shami të zeza qiellore*, “Toena”, Tiranë
16. Sula, Lili: (2016), *Erotika në letërsinë shqipe*, “Albspirit”, Tiranë.
<https://alb-spirit.com/2016/07/21/erotika-ne-letersine-shqipe/>
17. Todorov, Tsvetan: (2008), *Teori dhe kritikë moderne*, “Rozafa”, Prishtinë
18. Wilde, Alan, (1981), *Horizons of Assent: Modernism, Postmodernism, and the Ironic Imagination*. Baltimore: John Hopkins University Press.



THARJA E KËNETËS SË MALIQIT DHE NDËRTIMI I REGJIMIT KOMUNIST NË PERIFERI TË SHQIPËRISË

Nga Artan R. Hoxha, Ph.D



Për bizantinët njeriu ishte një mikrozmës dhe kisha një simbol i universit. Ky parim përshkonte tejmbanë agjiografinë dhe historiografinë e Romës së Lindjes. Mjafton të futesh në një kishë ortodokse dhe të shikosh afresket ose ikonat e saj dhe të mbërthen një ndjesi nënshtruese. Fytyrat e zbehta e të zgjatura, sytë e mëdhenj e të errët përçojnë te çdo kundruar idenë e përjetësisë hyjnore, e të vërtetës që kapërcen dimensionin njerëzor. Parimet që udhëhiqnin punën e historishkruesve në Bizant nuk ka qenë të ndryshme nga ato të kolegëve të tyre piktorë. Qëllimi i historianëve bizantinë ka qenë rrokja e thelbit të universales, të asaj që koha me peshën e saj shkërmoqëse nuk arrinte ta shpërbente, e esencës që qëndronte e patundur ndaj përkohshmërisë së formës. Për bizantinët, detajet, pjesëzat e një tabloje historike apo jeta e personazheve të ndryshme merrnin rëndësi vetëm në rast se ato shërbenin si simbole përfaqësuese të së përgjithshmes, apo se shprehnin frymën e kozmosit.

Nga bizantinët e dikurshëm, ne njerëzit e shekullit XXI kemi se çfarë të mësojmë. Të paktën, kështu e shoh unë. Dhe nuk jam i vetmi që mendon se analiza e të veçantës, dhe e një detaji, nuk na mundëson t'i përgjigjemi pyetjeve të rëndësishme mbi dinamika gjithëpërfshirëse historike. Historianë të shquar si Carlo Ginzburg, Giovanni Levi, Natalie Zemon Davis, apo Peter Sahllins kanë dëshmuar se mikrohistoria, ose perspektiva molekulare ofron një mjet mjaft efektiv për të testuar nivelin makroskopik dhe kuptuar se si funksionojnë makrosistemet. Historiani amerikan i Bashkimit Sovjetik, Stephen Kotkin ka shkruar në një artikull të famshëm të tijin se Moska komuniste ringriti atë që ai quan "komunelth mongol". Pra, udhëheqja sovjetike nisi një formë të re globalizmi të mbështetur mbi modelin shoqëror, ekonomik, institucional dhe kulturor të ndërtuar prej saj dhe që shprehej nga ideologjia dhe hartat mendore e deri tek arkitektura e botës socialiste. Dhe Elidor Mëhilli së fundmi ka treguar se si ndërtimi i socializmit në Shqipëri ishte pjesë e një procesi historik global që e futi Shqipërinë në një botë shumë më të madhe, që shtrihej nga Adriatiku deri Paqësor.

Për të vërtetuar këtë, mjafton të shohësh teatrin e Maliqit – i cili mjerisht u dogj para pak vitesh. Godina të ngjashme me qendrën kulturore të ish-qytezës së sheqerit në Shqipërinë juglindore shikon në të gjithë hapësirën që shtrihet nga brigjet e Balltikut, në ato të oqeanit Arktik, e deri në Kamçatka në Siberinë Lindore. Ky libër që po i bie në dorë lexuesit e vendos lupën e tij pikërisht në Maliq, për të kuptuar përmes asaj që ndodhi aty, dinamika më të gjera historike, ku procese të rëndësishme merrnin dhe njëkohësisht i jepnin formë këtij lokaliteti të rrethit të Korçës.

Nuk mëtoj aspak se Maliqi është një monadë e universit sovjetik. Në një rast të tillë do të rrëshqisja në klishtë e tipizimit bizantin që ka qenë një tipar dominues i letërsisë dhe agjiografisë së tyre. Duke rendur pas thelbit, intelektualët bizantinë binin shpesh në përgjithësime, pra në modele të menduari që synonin të nxirrnin një esencë specifike duke flijuar kështu shumëformësinë dhe shumëngjyrshmërinë e realitetit. Të udhëhequr nga dualizmi i luftës së të mirës kundër të keqes, të tokësorës kundër qiellores, të shpirtërores kundër mishtores, kontradikta këto të cilat Krishtërimi me parimin e tij të Trinisë kërkonte t'i kapërcente, njerëzit e letrave në trashëgimtarë lindore të Romës u mbërthyen për një kohë të gjatë në një sistem konceptual që i rrëgjonte personalitetet apo zhvillimet historike vetëm në bardhë e zi. Ky model të menduari, kjo skemë konceptuale dominon ende, pas më shumë se një mijë vjetësh në Shqipërinë e sotme.

Për shumë shekuj, historianët bizantinë ishin të zhveshur nga çdo lloj subjektiviteti dhe e shihnin veten si

vegla që ekzekutonin vullnetin e Shpirtit të Shenjtë: pikërisht kjo i bënte ata objektiv. Njëloj si edhe homologët e tyre të dikurshëm që shkruanin e jetonin në Perandorinë Romake të Lindjes, shumë historianë shqiptarë shkruajnë duke e zhveshur punën e tyre nga subjektiviteti. Kjo duket pikërisht tek shprehje klishe si "Ne mendojmë", "sipas mendimit tonë", apo të tjera formula ku veta e parë njëjës asgjësohet nga veta e parë shumës. Uni i autorit shkrihet me diçka të largët, impersonale, me një "Ne" të paidentifikueshme, një "Ne" që qëndron diku lart, që jep investurën e të vërtetës; është Shkenca që zëvendëson Shpirtin e Shenjtë dhe legjitimon përfundimet e autorit me aureolën e objektivitetit.

Kjo shkrimje e esencializimit dhe objektivitetit shihet në të gjithë narrativën e ngritur rreth transformimit të Maliqit nga një zonë moçalore, në qendrën e prodhimit të sheqerit në vend. Tharja e kënetës së Maliqit ka përfaqësuar një moment të rëndësishëm në programin e modernizimit të Shqipërisë dhe ka shërbyer si simbol i përpjekjeve për zhvillimin e saj. Në periudhën midis dy luftërave botërore, projekti shërbeu si metaforë e bonifikimit të së shkuarës, e zhbërjes së trashëgimisë osmane dhe e orientimit të vendit kah modelevë perëndimore. Tharja e kënetës së Maliqit ishte pjesë përbërëse e gjithë diskursit që ndërtoi imagjinarin e Europës si horizont drejt së cilës vendi duhej të lëvizte; e bashkë me Europën, u shpik edhe e shkuara osmane, si një e kaluar që refuzohej, e cila qëndronte në antitezë me të ardhmen. Kështu, kundërvënja midis progresit dhe prapambetjes u shkri me dikotominë gjeografike midis Orientit dhe Oksidentit.


Udhëheqja komuniste shqiptare e përvetësoi të gjithë këtë përfytyrim maniekanist të botës dhe e përdori transformimin e Maliqit si simbol përfaqësues të fillimit të ndërtimit të socializmit. Tashmë, Bashkimi Sovjetik zëvendësoi Europën si pikë referimi që mundësonte mbërritjen në utopinë e shumëpritur të zhvillimit. Si

partizanë të flaktë të modernitetit, komunistët ricikluan konceptualizimet antagonistë kohore dhe hapësinore të periudhës që i parapriu, me dallimin se tani ata ndryshuan kahe. PPSH e rreshtoi Shqipërinë në krahun e Lindjes, ndërsa e shikonin Perëndimin si "Tjetrin" e saj. Me Lindje kuptohej socializmi dhe jo Orienti. Perandoria Osmane vijoi të ishte sinonim i batakut, ku tharja dhe zhdukja e së cilës do të ishte lajtmotivi kryesor i misionit civilizues të komunistëve. Udhëheqja komuniste e bëri bonifikimin e fushës së Maliqit pjesë të historisë së Luftës së Ftohtë dhe e integroi atë brenda përplasjes midis dy blloqeve, atij socialist nga njëri krah dhe atij kapitalist nga krahut tjetër. Nivelet drejtuese të strukturës së pushtetit komunist e bënë transformimin e fushës së Maliqit pjesë të narrativës që justifikonte orientimin e Shqipërisë kah modelit sovjetik.

Sot, tharja e kënetës së Maliqit shërben si pjesë e asaj narrative që refuzon dhe dënon të shkuarën komuniste. Dhe bashkë me riqarkullimin e kundërvënieve kohore, riciklohen edhe antagonizmat hapësinorë. Dënimi i periudhës komuniste është refuzim i Lindjes, pra socializmit. Kështu, polariteti Lindje-Perëndim rivitalizohet sërish teksa njëkohësisht rikonfirmon përkushtimin ndaj modelit europiano-perëndimor, domethënë BE-së. Europa, rizuri sërish vendin qendror në hartën mendore të shqiptarëve, si vendmbërritja drejt së cilës pjesa më e madhe e tyre aspironjë. Në Maliq, ndërtimi i të ardhmes nënkuptonte edhe eliminimin e të shkuarës. Projekti i Maliqit dhe mënyra se si ai kujtohet vijon të qëndrojë brenda kësaj skeme kundërvënëse dhe pikërisht këtu merr edhe gjithë fuqinë e tij simbolike.

Ky studim shkaputet nga gjithë simbolizmi që e turr projektin e Maliqit në një thelb të caktuar që i përgjigjet nevojave të politikës dhe ligjërimeve hegjemone. Qytetërimi nis nga përpjekja e njeriut me natyrën. Në luftën për ta nënshtruar atë, njerëzit kanë organizuar forma të sofistikuar pushteti dhe hierarkish dhe kanë aplikuar teknologji qeverisjeje që i ka lejuar strukturave të shtetit të drejtojnë më efikasitet projektet infrastrukturore, dhe bashkë me to edhe shoqërinë. Ky proces vihet re edhe në Maliq. Këtu, komunistët zbatuan procesin paralel të shkatërrimit dhe ndërtimit. Teksa kërkonin të triumfonin mbi Natyrën, strukturat e PKSh-së luftuan edhe armiqtë e tyre. Komunistët shqiptarë, jo shumë ndryshe nga homologët e tyre në pjesën tjetër të Europës Lindore jetonin në një univers të mbushur me forca të errëta, të kudondodhura, gati për të rrënuar utopinë e ardhshme të profetizuar nga Marksi. Në këtë proces të mbushur me ekzekutime, ndëshkime, djersë dhe uri, pushtetarët e rinj shqiptarë krijuan hapësira për segmente të gjera shoqërore që deri atëherë kishin qenë të marginalizuara. Ndërtimi i kapitalit njerëzor për modernizimin nënkuptonte perfeksionimin e teknologjive të qeverisjes dhe zgjerimin e bazës shoqërore të regjimit.

Megjithë specifikat lokale, në Maliq shohim të ndodhim dinamika historike të ngjashme me atë të vendeve të tjera socialiste: proceset sociologjike të ndërtimit të pushtetit janë po ashtu elemente të rëndësishme që e lidhin Maliqin me pjesën tjetër të botës komuniste. Maliqi del si një copëz historie, një detaj, një tempull në miniaturë e një universi më të madh të mbushur me mikrokozmosë të cilat, ndryshe nga sa predikonin bizantinët, nuk janë replika të universales, por tregojnë pikërisht të kundërtën: se ndërtimi i komunizmit ka qenë polimorf dhe kompleks, aq sa kapërcen të gjitha esencializimet pozitive dhe negative që e rrëgojnë historinë në këmbishën e forcës së një thelbi të vetëm. Ndërkaq, në Maliq shohim se komunizmi nuk u ngrit vetëm në qendër, por edhe në periferi – ishte pikërisht ky themeli i tij.



Rreth përmbledhjes me poezi të Nurie Emrullait

“VARGMALE NËN DHË”, NJË POETIKË ME THEMEL

Nga Ballsor Hoxha

Poezia e Nurie Emrullait është një kompleks i poezisë në maturim e sipër. Ajo kalon dhe ndërtohet me kujdes dhe guximshëm mbi stratat e poezisë së kultivuar përmes simbolikave të njohura dhe të trasuara, në njërën anë, dhe në anën tjetër ka shpërthime tejet origjinale të Unit të saj poetik, që janë poezi krejtësisht unike që japin shprehjen më të thellë poetike. (sa i përket kësaj të fundit vlen të cekën si shembull këtu poezitë “Misteri i njeriut” dhe poezia “Kanibalizëm”)

Në të vërtetë duket, sikur Nurie Emrullait i ka shkruar këto poezi në dy periudha, apo në dy përpjekje, njëra duke përmblajtur rinoren dhe adoleshencën e saj poetike, dhe tjetra duke pasuar si epilog i vetë poezive të saj, meditimit mbi to.

Në këtë po theksojmë disa veçori të poezisë së Nurie Emrullait në përmbledhjen “Vargmale mbi dhe”.

Fëmija i brendshëm i Unit poetik të Nuries

Fëmija i brendshëm, sipas koncepteve Jungiane (Carl Gustav Jung), zbulohet më së miri në poezinë hyrëse të përmbledhjes së saj *Vargmale nën dhe*, e që është poezia “*Nëpër fazat e hënës*”, dhe në poezinë “*Unë fëmija*”

“Një hënë drapër
Ishte mbështjellur nëpër flokët e mia
E më kishte lidhur për qiellit.”

Dhe poezia “Unë fëmija”

“E humbur në vete
Dal nëpër pyje
për të tërhequr mbrapsht hijen time,
e cila u ngatërrua nëpër degë
kur e vogël mblidhja dredhëza të egra.”

E para karakteristikë që shfaqet është infantilja, dhe në këtë naivja me vetëdijen poetike për të hapur tutje, për t’u ‘kapur’ tutje në poetiken e “qiellit”, “hijen” etj. Kjo në të vërtetë shpreh, sipas koncepteve të Carl Jung për fëmijën e brendshëm, vetë pakufishmërinë dhe ‘magjinë’ e mundshme të kalimit/rrënimit të mureve dhe të situatave dhe të objekteve deri në pakufishmërinë e imagjinatës.

‘Fëmija i brendshëm’ të cilin e kultivon në poezinë e saj Nurie Emrullait në poezinë e saj, është në të vërtetë koncept i cili lind dhe mbetet në ne, që prej Stadi Magjik të zhvillimit tonë, dhe ai merr fizionominë psikike dhe shpirtërore në ne duke mos u harruar asnjëherë brenda nesh. Aq më shumë ‘Fëmija i brendshëm’ është një Un në vete, i cili qënieson brenda nesh i ‘Pavarur’ dhe i pa-harrueshëm. Për te nuk ka kufij dhe as ndalesa, e tëra është një magji (lexo: pakufishmëri) e imagjinatës e cila mishërohet në poetiken.

Prej këtu, duke kaluar në karakteristikën e dytë që shfaqet në këtë theks të poezisë së Nuries, që është kalimi i kufijve të koncepteve tona të perceptimit, dhe të reales, në një dyzim të njeriut me qielloren dhe me hijen.

Në të vërtetë, Hija, pon ashtu koncept Jungian, është vetë prejardhja e njeriut, vetë strukturë e brendshme e njeriut, naivja dhe loja e njeriut në fëmijën e brendshëm dhe në këtë roja dhe gjenetike psikike e njeriut në hijen. Të dyja këto si strukturë e krijojnë lojën e njeriut me botën, dhe aq më shumë ndërthurjen e njeriut, të pa-kufi, të shpirtërores së njeriut, me universin.

Në shfaqjen e tretë të kësaj poezie të Nuries, duke iu kthyer poetikes së saj, krijohet po e njëjta strukturë e reales me imagjinaren e poetes, nga ku çdo gjë është afër, e prekshme, dhe në këtë

për të tërhequr mbrapsht hijen time,
e cila u ngatërrua nëpër degë

edhe në një mënyrë e pandashme nga njeriu.

Në të vërtetë kjo asocion në pandashmërinë e perceptimit të poetes të ‘shtëpisë’/reales nga imagjinaria, gjë që është asocim, më tutje, i universit, si perceptim i shtëpisë dhe shtratit në njërën apo në anën tjetër të perceptimit.

Gjë që krijon edhe zonën e krijimit dhe të lindjes së poezisë së Nuries dhe e motivon atë të jetë e pakufishme, po sikur bërthama e poezisë.

Theksi i rinores në kontrast me plakjen në poezinë e Emrullait

Një tjetër poezi e cila kalon tutje në projektimin infantil, të fëmijës së brendshëm është poezia “çast” e përmbledhjes “Vargmale nën dhe”.

“përditë po vjetërohet qielli
mendimet nisen e harrohen
shpirti im këmbëkryq rri mbi hënë.”

Është projektimi klasik infantil i vetes në qiellin, projektimi i ndryshimit, shndërrimit dhe kalimit të njeriut, në qiellin si pasqyrë e tij. Sigurisht vargu u fundit “shpirti im këmbëkryq rri mbi hënë” e japin të vetëdijshëm këtë vargëzim dhe me një ide mbi kalueshmërinë e njeriut.

Në të vërtetë bukuria e kësaj poezie qëndron në përmbledhjen e të tërës në fenomenin e “çastit” si kalueshmëri, si vetëdijesim dhe temporale e njeriut mbi tokë. Pasqyrimi i të brendshmes, infantiles, fëmijës së brendshëm përmes kësaj poezie në qiellin është pikërisht ikja e jetës, e përhershme nën qiellin e përhershëm dhe përpjekja për të shënjuar dhe për të kapur jetën në ndodhjen e saj.

dhe po ashtu po e njëjta poezi në kontrast me poezinë “poezi për plakjen time”

“...rrënjët e mia janë ngulur nëpër kuzhinë
janë thelluar nëpër krevate dhe ulen në karriget e tryezës së bukës...”

Pikërisht fantazmagoria e kësaj poezie, e cila sjellë pyllin, universin dhe tokën brenda shtëpisë, përmes metaforës, është në të vërtetë zhvendosje e asaj që u tha më herët për poezitë e para në këtë punim, hapjen e universit deri në hënë e qiell, derisa këtu kemi vendosjen e universit brenda shtëpisë.

Megjithatë, ka një kontrast paradoksal në këto poezi mbi “çastin” dhe “poezi për plakjen” derisa autorja relativisht e re në moshë është e preokupuar me plakjen dhe me kalueshmërinë e njeriut në temporalen e qëniesimit.



Identiteti në “Vargmale nën dhe”

Një preokupim tjetër në poezinë e Nurie Emrullait është edhe identiteti. Në këtë preokupim të saj identiteti është vazhdimisht i ndërtuar me prejardhjen e saj, me qytetit e saj, me njerëzit e saj.

Poezia “Pa identitet”

“... Qyteti im që nuk më njeh.
Qyteti që s’mi di dhimbjet.
Qyteti që s’mi pa ndarjet.
Qyteti im ku kanë mbetur dhëmbët e mi të fëmijërisë...”

Kjo është një shprehje tejet rinore, në kuptimin e lojës së saj poetike, duke qenë se niset nga të qenit e “panjohur” nga qyteti i saj, dhe kontrasti paradoksal i vargut me “dhëmbët e vetë poetes mbetur në mishin e tij”.

Në të vërtetë identiteti, qoftë sipas teorive të fundit dhe qoftë sipas përvojës njerëzore, është fluid, dhe i ‘ndërtueshëm’ sa edhe i paparashikueshëm, apo thënë më saktë i pavetëdijshëm.

Mirëpo në poezinë e Emrullait ai është i atashuar në objekt, fenomen dhe shfaqje të qytetit. Gjë që është, i vërtetuar edhe në poezinë e mëposhtme, si atashim me prejardhjen dhe me “të shkelurit” e saj mbi të. Matjes së hapit të saj nga vetë qyteti, e më tutje matjes së qytetit nga vetë ajo. Dhe poezia tjetër “Kush jam unë”

“... S’kam për t’ju pyetur në urreni diçka a dikë,
Dhe në urreni s’ka pse të ketë përse pas asaj.
Duken marrëzi të gjitha këto,
... fjalët e një vajze,
Të një fëmije që si thotë zemra rritu,
Fjalët e një bije, që mallkojnë sa herë
Data e lindjes tetorit vërtitet...”

Në të vërtetë perspektiva e poetes mbi objektin i cili i jep asaj identitetin e saj është e veçantë ndaj të përgjithshmes së qytetit/shoqërisë së tij. Gjë që po ashtu shfaq një Un krejtësisht rinor dhe të brengosur me temporalen dhe me vënien shenjë të saj mbi të.

Perspektiva e saj mbi objektin identitar të saj, prejardhjen e saj, në të vërtetë është një marrëdhënie identike me dashurinë, me objektin e dashuruar, qoftë me të afërmit qoftë me partnerin e saj, në të vërtetë është në njërën anë lamtumirë dhe në anën tjetër është komunikim infantil, i vetëdijshëm, me qytetin e saj, si qortim, si mirëkuptim dhe si njohje të dhunës dhe vuajtjes së vetë qytetit të saj.

Përfundim

Për fund poezia “Vargmale nën dhe”, është një nga poezitë kyçe të Unit letrar të Nuries. Ajo në të, si në shumë poezi të tjera, niset nga prindërit e saj të cilët kanë jetuar një jetë krejtësisht ndryshe nga ajo, një jetë krejtësisht të nemitur dhe një jetë krejtësisht të pa “dëshira”. Mirëpo ajo nuk e qorton këtë, në të vërtetë ajo, Nurie Emrullait, krijon një prej metaforave më të bukura të poezisë së saj, duke i shënjuar si “vargmale nën dhe”. “Male dhe zotëra që nuk munden të jetojnë në vetmi”.


“Të mos dish të bësh shaka
Duhet të jesh tmerrësisht i vetmuar,
E shoh tek nëna ime
Mbetur jetime prej kur s’mban mend,
E shoh tek babai im
Jetim kur i patën thënë ke mbet.

... “As malet as zoti nuk rrinë dot në vetmi...”

Për aq sa u tha, poezia e Nurie Emrullait është një poezi e cila mbahet fuqishëm në traditën poetike botërore dhe shqiptare, dhe aq më shumë është e inspiruar nga vetë prejardhja e saj. Prej këtu kishim mundur të bëjmë ndarjen ndërmjet referencave poetike universale, si: hëna dhe njeriu ndër të tjera, dhe në anën tjetër, mali i “saj i Kërçovës”, qyteti dhe prindërit e saj. Kjo poezi me shumë të drejtë e zgjedhur për t’u përkrahur është poezi e cila premton, jo vetëm vazhdimësinë e një poezie rrënjësisht të themeluar në traditën poetike, por po ashtu edhe në një poezi të veçantë e origjinale.

"Andrra e jetës", NJË LEXIM I POEMËS SË NDRE MJEDJËS

Nga Sokol Zekaj



1 Mbi njëqind vjet më parë Ndre Mjedja shkruante poemën *Andrra e jetës*. Mendohet ta ketë filluar pasi është vendosur me punë në Kukël në vitin 1906. Atëherë qe dyzet vjeç, në lulëzim të aftësive të veta krijuese. Qe arsimuar e pajisur me dije të larta. Kishte jetuar në perëndim, dinte plot gjuhë të huaja, përfshirë edhe latinishten. Ishte autor i shumë lirikave e poemave të njohura me frymë romantike dhe atdhedashëse. Poema që përmendëm u botua për herë të parë në *Juvenilia*, në vitin 1917 në Vjenë.

Andrra e jetës është kryevepra e Mjedjes. Nuk kemi të dhëna për procesin krijues, por mund të besojmë se të shkruarit e saj ka qenë kënaqësi për autorin. Vetë ideja e poemës e ka gëzuar pasi tashmë, qe i mbushur nga jeta për të dhënë plot gjëra, të cilat ende nuk i dinte, por që i ndjente brenda vetes: shumëllojshmëri vargjesh e rimash, figurash e imazhesh, ndjenjash e përvojash. Vërtetë, poema do të kishte përsosmërinë e një veprë të madhe muzikore. Më duhet të them se, te *Juvenilia* më ka lindur ëndrra e jetës sime: ajo është vendlindja ime e poetit.

2 Mjedja është si ari: ai nuk u zhvlerësua në asnjë kohë, ndonëse kaloi nëpër hijedritë. Duhet ta besojmë se, sa ishte gjallë, siç na thonë bashëkohësit, qe i mënjauar e i pavlerësuar sa e meritonte. Kjo ndodhte për shumë arsye të cilat janë thënë e shkruar, por edhe për faktin se poezia e tij ishte e rafinuar artistikisht, dhe donte një edukim estetik për ta shijuar, në një kohë kur në Shkodër shkruante Fishta, i aftë për të hyrë në rezonancë me dëshirat dhe shijet e lexuesve, madje duke bërë edhe edukimin estetik të tyre, siç bëjnë të gjithë poetët e suksesshëm.

Edhe Lasgushi bëri një poezi të ngritur nga ana cilësore. Veçoria është se, siç thotë me të drejtë Frida Idrizi, toni dhe ritmika e poezisë së tij ishin më pranë poezisë popullore, asaj të jugut, madje në më shumë se një rast, ai bëri inkursione poetike të vërteta drejt kësaj fushe. Këtë gjë, në mënyrën e vet, e pati bërë edhe Fishta në Veri. Mjedjes asnjëherë nuk i shkoi mendja për "lëshime" të tilla. Formimi dhe vetëdija e tij estetike ishin solide dhe gati hermetike ndaj tyre.

Nga ana tjetër, Lasgushi nuk krijoi dashakëqinj në jetë, ndërsa pati mbështetjen e vyer të Çabejt, të Kutelit e të Asdrenit. Kurse Mjedja, ndoshta edhe për sqimën artistike dhe intelektuale, më shumë ndjeu heshtje rreth vetes, dhe njerëz që e shihnin shtrembër. Por ai nuk ndryshon, don me qenë i vërtetë, thotë atë që ndjen, dhe sidomos nuk thotë të kundërtën e asaj. Ndoshta në vitet e fundit, qe edhe i lodhur nga jeta. Koliqi, një shkrimtar dhe poet bashëkohës shkodran, na e paraqet "si një prift katundi ndër ma të lanunit...verë e dimën mbërthe në një pallo të randë të zezë".

Por mund të thuhet edhe kjo: veshja e klerikut, nuk rri mirë në staturen e tij të poetit. Kjo gjë s'ka pse thuhet për Fishtën. Lasgushi nga ana tjetër, merrej si ishte, civil dhe modern, dhe kjo e ndihmonte. E njëjta gjë ndikoi më vonë në popullaritetin e Migjenit, me histori dashurie, me albume të fotografive, me plot kujtime shokësh e miqsh, e me përjetime e përkujdesje fisnike familjarësh. Ndërsa autori i *Juvenilias* nuk e pati këtë fat. Ai mund të jetë parë me dyshim, edhe nga besimtarët edhe nga jobesimtarët. Të parët e gjykojnë, të dytët e paragjykojnë.

Veç kësaj, te Mjedja jetojnë dy personalitete poetike: njëri i qetë dhe soditës, tjetri nevrrik dhe stigmatizues. Unë për vete pëlqej të parin, padyshim. Por, disa gjëra nuk zhbëhen: realiteti dhe karakteri i tij, siç ndodh me të gjithë poetët e vërtetë në çdo kohë e në çdo vend, ishin dy ingranazhe që nuk përkonin. Sidoqoftë, qysh në fillim të viteve tridhjetë, ai u njoh si mjeshtër i madh, mes tjerëve edhe nga një poet i iluminuar si Lazër Shantoja, ndonëse me pak, me shumë pak zë!

Më tej, pas luftës së dytë botërore, ideologjia komuniste nuk gjeti dot arsye për të mos e çmuar e nderuar poetin Mjedja gjatë gjithë gjysëmshkullit. Koha e sotme është sot, në shekullin e ri. Në të vërtetë Mjedja është poeti që na ofron një vepër të begatuar me kuptimsinë e jetës, por duke trupzuar në vetvete elementët e artit elitar.

3

Mjedja bën pjesë te ata poetë, emri i të cilëve lidhet me vepra konkrete: ashtu si emri i De Radës lidhet me Milosaon, i Naimit me Lulet e verës, i Fishtës me Lahutën e Malcis, emri i Mjedjes lidhet me poemën *Andrra e jetës*. Fundja, emri i poetit jeton veçse përmes veprës së vet. Është vepra monumenti, nëse është. Tashmë kjo thuhet qysh prej Horacit.

Duhet patur në vëmendje se kjo poemë shënon realizimin kulmor, ku poeti do të investojë vetveten. Ndonëse poemë e gjatë, ajo e gjitha është brenda sensit të poezisë, dhe është gjithashtu

shprehja më e qashtë, më e llagartë, e poezisë së pastër në letrat shqipe. Aty janë derdhur në mënyrë harmonike lënda, frymëzimi dhe mjeshtria e poetit. Është e vërtetë se pas kësaj poeme, Mjedja do të vazhdojë të gdhendë të tjerë vargje të bukur e me masë, por gjithsesi atyre do tu mungojë diçka nga ngjyrimi, nga esenca dhe nga thellësia e zërit të tij poetik.

Nga ana tjetër, a nuk gjendet mjeshtria e tingllimave Lissus e Scodra, te pjesa e dytë e *Zogës*, ku vargjet kaq shumë të përimtuar artistikisht, rrjedhin lirshëm, e ku metaforat flatruese e vezulluese, vallëzojnë përmes një gjuhe që na tingllon në shpirt? Ku tjetër në poezinë shqipe, mund të gjejmë kaq imazhe të paharrueshme, kaq shkathtësi të vargut e të ligjërit, kaq befasi të bukura, dhe kaq elegancë të këndimit poetikë? Ndërsa e lexojmë, përfytyrimi ynë rrëshqet poemës si ngjala në rrymën e ujit të kthjellët. Ja, si këto vargje:


*Tue siellun krahnin këndote me vedi
E i rridhte krahve një si val' deti
Kur dielli shndritshëm lshote si zhjeta
Rrezet e veta*

Rreze flak' arit.../

Titulli i poemës, *Andrra e jetës*, është gjithashtu një metaforë që e kompletton veprën. Në fakt, kjo është si një kristal me shumë faqe, por më e para nga metaforat do mund të qe ajo që lidhet me Zogën, me ëndrën e saj. Gjithsesi, nuk është vënë titulli kaq i bukur, si një trill, a si një artific. Për herë të parë në poezinë shqipe, një poemë, reflekton qysh në titull thellësi dhe kompleksitet. Ëndrra-jetë dhe jeta-ëndërr, janë metafora të lindura bashkë me njeriun mbi tokë. Përndritja e kuptimit të tyre e përshkon poemën nga kreu në fund: Trina dhe ëndrra e jetës, Zoga dhe ëndrra e jetës, Lokja dhe ëndrra e jetës. Ja, çfarë kemi në duar për të zbuluar! Dhe janë jo pak: poema ka 296 vargje.

Shumë prej këtyre vargjeve i di përmendësh. I kam lexuar qysh fëmijë, atëherë kur mësuesi im, Gjon Dionizi na thoshte se "*Mjedja ka ndenjë me limë në dorë mbi vargje*". Herë pas here i kthehem poemës për ta lexuar. Dua t'i shoh vargjet mbi letër, jo t'i kujtoj me mend.

Dua t'i shoh në letër edhe vargjet e pjesës së katërt të *Zogës*, për të cilat prej shumë vitesh bëj pyetjen: si e shkroi poeti këtë pjesë? Problemi është se kjo përbën një përjashtim krejt të papritur në arkitekturën e poemës, pasi befasitë poetike i ndeshim në hapësirat e brendshme, jo në fasada. Por vetëm kjo, pjesa e katërt, del nga logjika e ftohtë autoriale e kompozicionit.



4

Mjedja nuk shquhet për fuqi përshkrimi, Fishta po, gjithashtu edhe Lasgushi. Për këta të dy, kjo është një nga pikat e forta të artit të tyre. Prandaj Lasgushi është më pranë Fishtës sesa Mjedjes, si poet. Kjo është çështje e temperamentit të poetit. Në bisedë të lirë, thotë Koliqi, Mjedjes nuk i rridhte fjala. Mjedja bën dekor, vendos planet ku do të zhvillohet drama e jetës, dhe më pas punon me pak detaje, të imta dhe të zgjedhura. Atij nuk i intereson tërësia e një shfaqjeje, por pjesë të saj, të cilat i bashkon sipas synimit të efektit poetik, ja si këto vargje:

*E nalt n'qieell ma e bukur hana
Rreze t'paqta shkon tue shkri
Maje bjeshkve fillon zana
N'valle shoqeve me u pri.*

Ai synon të na krijojë një gjendje po aq sublime përmes mjeteve artistike, sa ç'është edhe ideja e dashurisë të cilën e mbart kjo pjesë e poemës. Këtu, te ky projektion i intelektit, mund ta kenë origjinën rezervat që janë shprehur ndaj artit të Mjedjes, sipas të cilave, poezia e tij "*buron më shumë nga mendja se nga zemra*". Por kjo mund të mos jetë e mirëmenduar, pasi vetë përsosmëria e gjërave ka një natyrë saktësimi dhe përpikmëri, gjendje që mund të arrihet veçse në një ndërkallje të vetëdijes dhe pavetëdijes, frymëzimit dhe intelektit.

5

Poema është e ndarë qartë në tri kohë. Mes kohës *Trina* dhe asaj *Zoga* rri pa u ndriçuar afërsisht një dhjetëvjeçar, dhe po kaq edhe mes *Zogës* dhe *Lokes*. Por koha brenda secilës kohë është e shkurtër, dhe kjo e ka bërë intensive poemën. Mjeshtri Mjedja nuk e mbush veprën as me vargje përshkruese, as me ide të thata. Poema kumbon nga gjërat e qashtra e të përjetshme. Kemi pra një familje fshatare, nënën me dy vajza. Nuk ka dyshim se shmangëja e burrit në poemë nga autori, është në funksion të synimit estetik të saj. Por, të mos largohemi nga mendimi, njëra vajzë vdes, Trina. Tjetra, Zoga, vjen dita dhe martohet. Mbetet Lokja e vetme, e cila në një natë të egër dimri, vdes.

Trina vjen si një poemë dramatike. Ritmet kapriciozë të shtatërrokshave të këngës së dytë, që japin kthimin e Trinës në shtëpi, na kujtojnë ritmet e lojrave të fëmijëve në oborr. Trina dhe Zoga janë fëmijë. Lokja është grua e zoja, e fortë, aq e fortë është, sa merr vëcin dhe e çon *rrshanë te murgjina*. Murgjina, është emër përkëdhelës dhe muçitës i lopës, dhe do thoshim se vjen nga fjala murgë. Kjo pjesë na tregon se sa e vërtetë është ndjesia e realitetit te Mjedja, i cili nuk e ngre ngrehinën e vet të artit, poemën, me themele në erë, as me fjalë herbariumesh. Përkundrazi, ndjesia e tij e realitetit është vitale, dhe ka dimensione të gjëra e të thella.

Poeti ka zgjedhur të mos na e japë direkt Trinën. Vetë ai na lajmëron në këngën e parë, se do të vijë në mbramje me një qingj të sapolindur. Është e trishtueshme vetëdija e detyrës për të jetuar, tek fëmija, e që prap nuk jeton. Pse poeti i caktoi Trinës këtë fatë? Se kësiaj ishte jeta, e mbase është edhe sot, me ngjyra të forta të cilat rrinë ngjitur njëra me tjetrën. Në veprën e Mjedjes nuk ka asgjë artificiale, gjithçka buron nga e vërteta dhe mbërrin te e vërteta, larg lojrave pa kuptim. Po, ç'gjuhë e bukur, ç'muzikalitet i vargut:

*Moli tue këndue lopën
Tue pritun vëcin prorë
E tamblu bardh si borë
Përmbranda mjelces ngufoj.*

Ja edhe dy vargje që na e vënë në lëvizje imagjinatën: *E Shega e lehtë si kashtë/ Tue kcyemun u bërluk*. Kashta e lehtë dhe vëci (ka emrin *Shega* prejse është me ngjyrë të kuqe dhe që duhet të jetë femër, prejse ka emrin femror), bëjnë një metaforë vizuale origjinale dhe moderne. Të përfytyrojmë një kashtë që e merr era nëpër oborr: ajo është e hollë, e lehtë dhe ndërron trajtë, mblidhet, hapet, krijon figura të papritura, ndërsa lëviz andej-këndeje, duke u ulur e duke u ngritur mbi tokë. Ja, kështu lëviz edhe *Shega* që sapo ka dalë nga *burgu* ku ka qenë i ndrymë.

Ndërsa parandjenja e vdekjes dhe ajo çka Lokes i fanitet buzë votrës, janë imazhe të paharrueshme. Është natë. Në mes të errësirës, flaka e një pishe. Kur ke njeri të sëmurë, nata bëhet e pafund. Nëna tjerë penj për të ardhmen ndërsa fytyra i është *vrá* (në kuptimin *i vranët*, kohë e *vranët*) e sytë i mbushen me lotë. Për ta shprehur poetikisht gjithë këtë tension psikologjik e shpirtor, poeti ka zgjedhur një frazë poetike që zhvillohet në tetë vargje të dendësuar e të ngarkuar me imazhe e me emocion. Ja çka i fanitet nënës së lodhur nga pagjumsia dhe frika e së keqes:

*E tirtre prep te votra
Penj tirtre per xhubleta
E i dukej se tu kënet
Se n'hpella me drangonj.*

*Tirrshin dhe shtojzovallet
Tue luejtë pa mejun gishtat.
Siellshin me pleq ferishtat
Ndoshta dhe fëmin' e vet.*

Këto nuk janë sajesa mistike por mjete artistike për të dhënë botën shpirtrore të personazhit, të cilin e ndiejmë poetikisht të

afërt, si njëri prej nesh. Ajo që marrim nga këto imazhe, është ndjenja se vdekja është një e keqe e vështirë, dhe se ajo duhet refuzuar. Në poemë Mjedja ka vënë ato që beson si poet, ndërsa ato që beson si klerik a si dijetar a si patriot, i ka lënë tash për tash, në bllokun e shënimeve. Duhet shënuar se kjo është koha kur në Shkodër kishte marrë goxha vulll arti: në letërsi me Fishtën, në pikturë me Idromenon, në fotografi me Marubin, në muzikë me Palokë Kurtin.

Pra, Trina, vajza e njomë shuhet. Në këto kushte, Lokja, *“me zemër t’plasun”*, ndjen më shumë dhimbje, ndoshta edhe faj, madje edhe ndjesi dënimi nga fati, por ka edhe detyrën e vështirë me qenë e fortë, sepse mban shtëpinë të ngritur, dhe për sa kohë je në pemën e jetës, duhet mbajtur aty me thonj. Por ka edhe një gjë: duhet dhënë shëmbull force, jo dobësie, për të bijën. Kjo është një filozofi e konsoliduar fort, e popullit.

Kënga e dytë e Trinës, është modeli se si gjërat reale të drejtpërdrejta, të cilat nganjëherë vijnë më të çmuara se të imagjinuarat, rrinë brenda nesh përbri me përjetimet fantazmagorike. Këto në fakt na zgjohen rrallë, atëher kur jeta jonë vihet në zgrip. Dhe, të kujtojmë vargjet:

E shkoi me i pa tuj pritun

Dritën e pishës me dorë.

Ky udhëtim shpirtror i Lokes nëpër errësirë, me dritën e pishës në dorë, me imazhin e shtojzovalleve te kënetat në mendje, që *luejnë pa mejun gishtat*, ky udhëtim pra, nga votra ku po tjerрте me sytë e mbushun me lotë, deri te të *shtruemet* e fëmijve, është i gjatë i pafund. Imazhe mbas imazhesh na përshkohen nëpër mend, si një film. Por, kjo këngë ka edhe një befasi të cilën do ta shohim më pas.

Gjithashtu te Trina kemi figura të tjera letrare si kjo: *Paq i kthelltë prej Perëndije*,/ Ky epitet origjinal me shkëlqim dantesk i një *paqeje të kthjelltë*, sa vizual aq edhe konceptual, për nga bukuria dhe funksioni estetik, rri si një nga gurët më të çmuar në poemë, të cilët në të vërtetë nuk janë të rrallë. Dihet se konceptet janë produkt i intelektit, i *mendjes*. Kjo nuk don të thotë se kemi një poet të pandjeshëm ndaj natyrës, përkundrazi lidhja e Mjedjes me natyrën, më parë se të jetë poetike është shpirtrore dhe intime. Të tillë e shohim te poezitë për stinët, apo te poezia *Vjollcës*, por edhe te kjo, poema *Andrra e jetës*, sidoqoftë, duke mos dashur asgjë false, as optimizmin.

6

Pjesa e dytë, *Zoga*, është një hymn për moshën e rinisë e për vijimsinë e jetës. Vargjet dridhen e vezullojnë nga pasioni i bukur i dashurisë. Por e gjithë poema zhvillohet përmes antitezave dhe analogjive. Antitezat janë: pranvera- dimri, jeta- vdekja. Ndërsa analogjitë janë të shumta. Por analogjia, krahasimi dhe metafora vijnë nga e njëjta natyrë e gjërave, dhe këto janë të shumta. Zoga fillon pikërisht me këtë buisje pranverore. Madje përveç bylbylave që këndojnë në ograja:

Drandofilleve zymbylat

T’kandshmen erë dhunti iu çojnë.

Paralajmërohet një martesë. Poeti ka hyrë me dëshirë të madhe në botën shpirtrore të heroinës së vet, Zogës së rritur tashmë. Shkëndia e zjarrit shndrit fytyrën e saj dhe ajo duket si engjëll ndërsa fle, që do të thotë, duket e qetë e pastër, e pafaj. Por shpirti njerëzor zbulohet duke hyrë aty. Metafora e këtij penetrimi jepet në dy vargjet e para të këngës së dytë, si një rreze dielli që ka hyrë brenda shtëpisë nga një tjegull e thyer:

Prej nën nji tjegillet kish dalë si j’tra

ku njimij’ tësha vloshin pa da,

Këto “njëmijë tësha” janë pikërisht mjëmijë gjërat që vëlojnë në shpirtin e Zogës. Deri, edhe ruga e vjetër, ndërsa Zoga sheh nga dritarja, *nën shpi, mbas gardhit diçka si dritë / Shkote tue qitë*. Bota shpirtrore e Zogës është në lëvizje e në zbukurim, gjëra edhe këto që kanë peshën e tyre pasi, frekuenca e lartë shpirtrore është e vështirë, prandaj:

U nis te puna mërzitshëm. Nisi

Ndër penj sovajkën e shpata krisi

Cirlikne rrotllat posht’ e përpjetë

Nën kambë të shpejtë.

Por: *Duel ndritare prap. Ndoshta begu / Ka mbërri...*/ Analogjia e krijimit të familjes vijon me dallëndyshe e me bylbyla. Natyra nga ana e saj është e plotë. *Vijn’ dallndyshtet porsi era*. Edhe ujët që vjen

fushave për të rritur bimë e lule, nuk është dosido por i kulluet, ujë bore: *lehtas prroni malit ulet / da prej borës që i nep ushqim*./ Ky ujë do të përtërijë jetën:

E i dishruem bje për fushore

Me rrit’ bimën për gjith vend

Ku j’ erë akullit mizore

Kishte hupë lulzim e shend.

Ja një antitezë ku ritmi dhe rimat, bashkë me epitetin *mizore* që cilëson në përmbajtje *erën e akullit*, vijnë po aq të përkryera sa gjuha poetike dhe sa kthjelltësia e ideve. Dhe këtu, te kjo këngë, poeti gjen rastin të bëjë një ndërhyrje të drejtpërdrejtë, e t’i thotë Zogës se, si ky përrua që ndahet nga bora, edhe ajo duhet të ndahet nga shtëpia ku ka lindur, dhe ashtu e pastër të rrisë jetën diku tjetër.

Por, pse të mos e themi se djali i ëndrrës së një vajze sot ka ndryshuar, ndonëse më shumë si fjalor dhe rekuizitë se si imazh. Kështu nuk quhet *beg*, një fjalë me konotacion disi arkaik, madje nuk po quhet as *princ*, nuk vjen mbi kalë me kobure e gjëra të tilla që na kujtojnë letërsinë *kalorsiake*. Por, cila poemë e madhe nuk mori pak ndryshk nga kohaë

Mirëpo më duhet të flas edhe për një metaforë të cilën për besë, them se nuk duhet të kalojë nxënës shkolle pa e ditur. Janë vargjet:

Fjet bri votrës: e kur shkndija

Shndritte at’ fëtyr’ të patravaj

Ejll prej qielllet ulë te shpija

Dukej faret fëtyra e saj.

Në fakt, ngjashmëria e vajzës me një engjëll në një poemë, gjithsesi nuk përbën ndonjë befasi të madhe, por të tillë e bëjnë rrethanat. Është fillim pranvere, por ende bën ftohtë. Vajza është shtrirë, dhe pasi ka shkëmbyer ndonjë (jo shumë) fjalë me nënën e vet, *fjet bri votrës*. Është kjo *votër* ku ka lindur e është rritur, e për të cilën do të ketë mall gjithë jetën. Kjo i kujton edhe motrën, Trinën të cilën tash s’e ka. Errësira e natës ka mbushur shtëpinë, por zjarri digjet në votër me dru *dullinjet* (jo lisi të fortë) të cilat i ka bërë Zoga *në mal pa motër*. Ndonjëherë, kur zjarri bën shkëndija, kur shkëndijat krijojnë kunorë drite në mes të errësirës, në atë çast të shkurtër, sa zgjat blici i një fotoaparati, por pa dyshim shumë herë më të bukur, në atë çast, si kujtesë e papritur në mes të harresës, vajza e fjetur duket si *ejll ul’ prej qielllet*. Po, a është Zoga *e patravaj* siç na e thotë epiteti në vargun e dytëë Po, është, sepse ajo si personazh, nuk është e ngarkuar me shumë simbolika, ajo nuk është ndonjë Antigonë as motër e Gjergj Elez Aisë, nuk ka ndër mend *me përtëri* themelet e shtëpisë së vjetër! Vetë fjala zbërthehet: *me t’ra vaj*. Ndërsa gjithë shqetësimi, gjithë ëndrra e Zogës është *me ba jetën e saj*, pra me dalë nga shtëpia si një engjëll, prejse ajo nuk është veçse një vajzë e zakonshme, por e përjetshme. Po, kujt i hyn në punë poezia, nëse nuk pasqyron në esencë jetën njerëzore dhe shpirtin njerëzorlë

7

Ndërsa *Lokja*, shpreh epilogun e një jete. Është një epilog i vështirë por ne jemi gati ta lexojmë e të marrim emocione, pasi këto janë gjëra të përjetshme, dhe janë dhënë nga autori, me një fuqi artistike do të thoshim, ekuivalente me idenë.

Kënga e parë karakterizohet nga toni i ulët dhe i qetë në dukje, por në fakt e gjitha është si një figurë e vetme, jeta në gjendjen e caktut të mbramë, por kjo e stolisur me diamante artistikë. Nëpër të gjashtë strofat e saj shkëlqejnë idiomat si shprehje metaforike me vlerë të përjetshme ku sintetizohen vlera morale dhe estetike. Të tilla janë: *Vetun zbardh e vetun erret / Me krye n’hi e shuemja plakë / Apo: Sot e reja i kishte dalë / Bashkë me dritë për dru në shpat*. / Apo: *Edhe lokja me gjith’ tjera / Kishte dal’ me petka n’shtat*./

Ndërsa në këngën e dytë, toni ngrihet: të gjithë instrumentet e orkestrës tingëllojnë fort:

U shty vjeshta e krisantemi

Vetun vorreve lulzon

Land’e pyje gjith’ ku kemi

Tuj fry veri po i cungon.

Ja edhe ironia e fatit të dikujt:

Ndrron prej dimnit landa veshën

E lshon gjetht që para pat

E për mshirë duhit’ që ndeshen

Ia çojn’ t’vorfnit me i ba shtrat

Pra, rasti i Lokes nuk është as i vetmi as më i padëshiruari.

Ndoshta askund në poemë nuk është kaq e qartë nota kritike. Papritur, këndi i shikimit bie mbi plagën shoqrore të vorfnisë e mjerimit me një dritë të fortë, dhe ne ndjejmë një si rribë ere që na bën të dridhemi. Janë duhitë që ndeshen mes tyre për interesat e dikujt, ndërsa njerëzit e thjeshtë bëjnë theror jetën e vet.

Po, dimri është i egër, me borë e orteqe që ushtojnë. Lokja *rri me duer kah ndezet flaka / porsi nieri kur uron*./ Imazhi i Lokes *me duer kah flaka* nuk ka qenë i vështirë për tu imagjinuar nga poeti. Detaje të tilla ka plot në poemë. Këta janë marrë direkt nga jeta reale por kanë një forcë të madhe emocionale, pasi e tillë është ngarkesa e tyre edhe në jetën reale, plot trazime ekzistenciale. Duart e Lokes janë të drejtuaa kah flaka për të marrë sa më shumë ngrohtësi prej saj, pasi asaj i beson më shumë këtë natë, flakës. Megjithatë, e sheh faktin para të cilit ka mbërritur. Ajo që vë re tash, këtë ças, është pasqyra e jetës së vet, *“një dritë e venitun”*, jo më një dritë e fortë ku shquhej forca dhe përpjekja. Në fakt ëndrra e jetës së saj nuk është realizuar si ka dashur. Le të themi se ajo, ëndrra, bashkë me forcën dhe vullnetin për jetën, kanë kaluar tek e bija, Zoga, pasi ëndrrat njerëzore janë të ngjashme, nuk janë të pafundme, gjithsesi.

8

Duhet të themi, se nuk kemi të bëjmë me vetsakrifikim të Lokes, si është thënë në ndonjë rast, apo me shprehje misticizmi, si është thënë në ndonjë rast tjetër. Keqkuptimi mund të ketë nisur me vargjet:

E larg morden tuj kositun

E kujton e pran’ e thrrët.

Por, kjo morde që kosit, është metafora konceptuale e vdekjes, nuk është ndonjë qenie që ka marrë kosën në dorë dhe i bie botës, ndonëse kjo mund të ketë një zanafillë biblike të lidhur me epidemi mortaje. Këtë metaforë autori e përdorë edhe te Zoga, në këngën e tretë në strofën që bën fjalë për mbretin David: *Kur sheh morden se kositi / Anpëranë krajlnin e vet*./ Mbreti David u ndëshkua nga Perëndia me epidemi mortaje për mëkatin që pat bërë. Sot ne kuptojmë, se sa pa integritet konsiderohej qenia njerëzore sipas vizionit biblik. Sidoqoftë shtrati realist dhe human i poemës, nuk na krijon asnjë shteg për ta transpozuar imagjinatën tonë në koncepte as imazhe të tilla.

Por, kur të mbarojnë fuqitë, kur e ndjen se po të shuhet flaka brenda vetes, njeriu ndoshta e kupton fundin. Lokja këtë bën, *“e kujton morden”*, nuk tmërrohet nga ndonjë imazh i zi, por e pranon faktin, gjë që do të thotë se është me mendje të kthjellët deri në fund. Në këtë moment, nëse do të kishte njerëz pranë, ajo do të kërkonte *hallall*, falje. Mungesa e tyre, është dhimbja e fundit, por edhe shprehja ekstreme e qëndresës. Për njerëz me fuqi të tillë jetësore, flitet me respekt dhe thuhet” *vdiq me mend e me gojë”*. Kjo është Lokja.


Te vargjet: *“Undie j’ frymë përmbrenda shpijet / porsi erë që vjen pa shkas”* kemi një metaforë të pashoqe të vdekjes. Po, si vjen era kur nuk ka një shkas për t’ardhunë Ajo qe një “frymë”, një erë që asgjë nuk e nis, nuk ka burim askund, por vjen, ndonëse nuk fryn. Në të vërtetë, veçse u ndje kështu prej Lokes, si frymë a si erë, por ajo ndjehet, jo nga lëvizja pasi nuk ka një shkas për këtë, por nga prania, sikur ajo qenkesh kudo, edhe brenda jetës së pafundme. *“Dekën e kem’ ma pranë se këmishën e shtati”* thotë populli, ndërsa thotë edhe shprehjen tjetër më të çuditëshme: *ne të gjithë jem’ të bijtë e dekës*. Vargu i fundit është: *U ndal drita e ajo mbaroi*./ Dhe, perdja bie. Në të vërtetë krejt poema përshkohet nga drita. Më bëhet se është esenciale të perfrazojmë vetë Mjedjen nga një poezi tjetër e tij, dhe të themi se krejt poema është stolisur me dashtni dhe shije, me dashurinë për jetën e njeriun, dhe me shijen e hollë për të mirën e të bukurën. Kjo është *Andrra e jetës*, një vepër kuptimesh të kthjellta, kurrë të vjetruara.

9

Por duhet thënë edhe një gjë jo pa rëndësi. Në epilogun e jetës së vet Lokja nuk e kujton asnjëherë të bijën, Zogën, ndërsa kujton Trinën me dhimbje, dhe kujton gjithashtu me dhimbje se *nuk bani kurrnji djalë*. Ajo ka dashur të ketë një djalë, më pas djalin ta martonte, dhe kjo të ndjente dashurinë e fëmijve të tij. Ja, kjo ka qenë *andrra* e Lokes, e cila nuk u realizua, ndonëse qe një ëndërr realiste, nuk qe për t’mos u ëndërruar, dhe as nuk qe pa kuptim. Ndërsa për Zogën, pra, kemi heshtje. Asnjë varg, asnjë fjalë për fëmijën e vet të vetëm në jetë. Harresëë Përsëë E vërteta duhet të jetë se Lokja e ka kujtuar, domosdo, por poeti nuk na e thotë. Ka një arsye, sigurisht. Arsyeja është se nëse ai, poeti, do të fliste për të, fjalët e tij do të ishin qortim për bijën që e ka lënë nënën në këto kushte. Prandaj ai ka hedhur mbi të heshtjen. Kjo heshtje e nënës në ditët e fundit, në çastet e fundit, është qortimi, kritika. Por, ka një problem: te *Zoga* vetë autori e ka miratuar ndarjen e bijës nga nëna, *si prroni që ndahet nga bora*. Me sa duket qëndrojnë të dyja: edhe miratimi edhe qortimi. Ja pra se jeta ka nyje që nuk zgjidhen dot. Nyjet e pazgjidhura e shoqërojnë njeriun në jetë, dhe kjo përbën dramën e tij. Kështu, poezia e Mjedjes nuk është mashtruese si vera e ëmbël. A mos vetë poeti ka ndjerë një brejtje ndërgjegjeje ndaj nënës së vetë Lidhur me të, te poema *I tretuni*, ka shkruar: *E kurrnja n’ankime t’tjika / Përpos’ nanës s’i kam ndi*./ si edhe: *N’kohë ma t’mir’ për ty un treta / Kur pleqnija kërkon paq*./ Njësoj si personazhi i vet i poemës, Zoga!

10

Detajet shpesh marrin vlerë simbolike si *“shllunga e rrasun”* e leshit që Lokja tjerр është vetë jeta e saj, *“era e akullit mizore”* është fati i keq që i mori vajzën, Trinën, *“nji prrue që prej malit ulet”* është rinia e Zogës që do të përtërijë jetën etj. Po, sa e hidhët është ndonjëherë ironia e jetës! Kur vajza është në vllimet e ëndrrës së vet të moshës, poeti vë në gojën e Lokes këto fjalë që burojnë thellësisht nga të qenët e vet, por që janë në disonancë me të vërtetën e jetës: *E nanbardha tue shikjue: / Flej me engjëj thot’, o bijë / pusho shtatin me i ndihmue / lokes sate nëpër shpi*. Por Mjedja është realist, nuk i hedh asnjë zbukurim këtij raporti nënë-bijë për të ëmbëlsuar gjoja, kuptimin e gjërave. Jo, ai nxjerr në dukje anën dramatike të Lokes si personazh. Kjo është jeta. Por nuk e di a e vutë re, në vargun e parë fjalën *nanbardha*: është e krijuar nga emri *nanë* dhe epiteti *e bardhë*, e mbështetur estetikisht nga tingulli *a*, një fjalë që ka



Mbi monografinë “**SANTORI- POET DHE DRAMATURG**”
të prof. Klara Kodra, botim i Qendrës së Studimeve dhe Publikimeve
për Arbëreshët (QSPA)

VLERA ESTETIKE E KRIJIMTARISË SË SANTORIT PËRMES NJË MONOGRAFIE

Nga Hasan Gremi

Shkenca jonë letrare i ka ende një borxh të madh letërsisë së arbëreshëve të Italisë e cila i dha dikur një shtytje formimit të letërsisë kombëtare artistike të Rilindjes shqiptare dhe e ngriti atë degë të letërsisë shqiptare, e cila ishte e lidhur me atdheun e origjinës nga gjuha e problematika në nivel europian.

Ndonëse janë shkruar ese, studime,, madje edhe monografi për autorët arbëreshë, shumë probleme të letërsisë arbëreshe me veçanësinë e saj dhe në raport me tërë letërsinë shqiptare, nuk janë zgjidhur.

Në mënyrë të veçantë nuk është pasqyruar në mënyrë të plotë vlera e saj artistike që përbën edhe thelbin e saj për disa arsye; për shkak të mohimit për arsye ideore të ndonjë autori të rendësishëm si Skiroi, çka e cungonte këtë letërsi, për deformimet dhe cungimet që iu bënë përmes përshtatjeve para viteve '90, për shkak të nënvleftësimit të formës në krahasim me brendinë që bënte e ashtuquajtura shkencë marksiste e kohës së diktaturës dhe zbulimit të vonë i shumë dorëshkrimeve të pabotuara të shkrimtarëve arbëreshë. Ky zbulim u realizua vitet e fundit me ndihmesën e rendësishme të vetë shkrimtarëve arbëreshë..

Dihet se vlera estetike e veprave letrare ose literaliteti është përcaktues për vendin e secilit autor në kuadrin të një letërsie, sepse mesazhi i lartë nuk arrin të ndikojë në një formë të dobët. Nga ana tjetër s' duhet rënë në teprimet e formalistëve që e anashkalojnë ose e injorojnë mesazhin, duke parë te letërsia thjeshtë një histori formash. Mesazhi dhe forma janë dy anë të një tërësie organike siç është vepra letrare.

Një autor tepër i veçantë si Santori, për një kohë të gjatë ka mbetur nën hijen e bashkëvëllezërve dhe është njohur kryesisht përmes një vepre, “Emira”. Në të vërtetë është fjala për një autor jashtëzakonisht pjellor që themeloi gjini e lloje të reja dhe veprat e të cilit kanë një origjinalitet relativ në kuadrin e letërsisë arbëreshe dhe shqiptare.

Ky autor është për herë të parë objekt i një monografie të gjerë, në aspektet e tij më të rendësishme si poet dhe dramaturg në monografinë e studiueses së njohur Klara Kodra “Santori, poet dhe dramaturg”, e botuar tani vonë nga QSPA (Qendra Studimore dhe Publike për Arbëreshët).

Këtë monografi e përshkon të tërën si një fill i kuq analiza e formës së veprës santoriane që shpreh realizimin e saj estetik që nga krijimet e para dhe deri në veprat e fundit. Do të thoshnim se kjo është merita kryesore e monografisë në fjalë. Vetë autorja është e vetëdijshme, se nxjerr në dritë pikërisht ato vlera që do të ndihmojnë për caktimin e drejtë të autorit të analizuar në hartën e letërsisë shqiptare. Në një vjershtë të vetën që shërben si epigraf për monografinë (studiuesja është edhe poete), ky synim shprehet qartë nga studiuesja Klara Kodra. Po e citojmë vjershën në fjalë: “Nga qielli i poetëve, i florinjë, i paanë / De Rada dhe Serembe thërrasin të vëllanë / Françeskun që studiuesit e menduan pedantë / S' guxuan atyre t' ia vendosin pranë.”

Pra bëhet përpjekje për ta nxjerrë në dritë, këtë autor gjer më sot të lënë në hije dhe të quajtur si poet minor. Jo më kot studiuesja mbështetet mbi dy autorë të shquar që në gjallje të vet patën vlerësuar poetin dhe dramaturgun Santori në mënyrë më objektive se studiuesit, De Rada dhe Serembe.

Studiuesja përdor në këtë monografi analizën tekstuale, duke plotësuar me disa elementë historizmi dhe me metodën krahasuese, si edhe duke u mbështetur në arritjet e bashkëstudiuesve filologë.

Disa nga vlerësimet estetike që gjejmë në këtë monografi formulohen për herë të parë. Në disa formulime të tjera, studiuesja merr parasysh ndihmesën e studiuesve të tjerë shqiptarë, arbëreshë dhe kosovarë. Ajo herë e mbështet gjykimin e tyre, herë debaton me ta në bazë argumentesh shkencore. Në thelb, synimi i studiueses është të jetë, si origjinale, ashtu edhe objektive, pra të mos bjerë në kurthin

e një origjinaliteti si synim në vetvete që do të përmbysë patjetër vlerësimet e njohura, duke ngritur lart një autor të keqvlërësuar apo të lënë në errësi apo duke e çmitizuar një autor tjetër, jo në funksion të se vërtetës, po të vetëafirmimit.

Ajo nuk është indiferente ndaj autorit që analizon, madje ndjen për të atë dashuri që ndjen një poet për një sivëlla (të mos harrojmë se studiuesja është edhe poete). Po nuk rrëmbehet nga pasioni dhe synon të vlerësojë Santorin, në përputhje me të vërtetën shkencore. Gjykimet e veta studiuesja i mbështet në analizën e tekstit.

Në sajë të zbulimit nga shkenca letrare (konkretisht nga studiuesi Altimari) në organin e shtypit arbëresh që deri më sot njihej në mënyrë të paplotë “Arbëreshit të Italisë”, më në fund njihet poemthi rinor i Santorit, “Valle e hareshë së madhe”. Më në fund studiuesit e kanë në dorë atë dhe mund të japin vlerësimin e tyre. Këtë gjë e ben në mënyrë të detajuar Klara Kodra, duke zbërthyer elementët e formës në këtë poemth, figuracionin dhe metrikën dhe duke u solidarizuar, së fundi me gjykimin entuziast që dikur kishte dhënë për këtë krijim poetik Dora d' Istria që e krahason atë me një krijim të poetit të shquar grek Sollomos, që i kushtohet lirisë.


Studiuesja jep mendimin e vet edhe për veprën rinore santoriane, e analizuar nga disa studiues “Kengëtorja arbëresha”. Ajo sheh te ky krijim disa risi që sjell Santori në letërsinë arbëreshe, analizën e hollësishme psikologjike të ndjenjës së dashurisë dhe pasurimin e muzikalitetit të poezisë arbëreshe me anë të rimës. Studiuesja jep mendimin e vet edhe për ndikimet e autorëve të tjerë mbi këtë poemth rinor, duke veçuar ato që Santori i ri mori prej tyre, po që nuk ia pakësuan veçanësinë. Klara Kodra ndalet edhe në çështjen delikate, a u frymëzua Santori nga një dashuri reale, duke debatuar me studiuesin Solano që e quan poemthin “fryt leximesh” dhe duke pohur se në këtë rast diçka e rendësishme do t'i mungonte vrullit të frymëzimit dhe freskisë së këtij cikli me vjersha. Studiuesja është e mendimit se poeti u frymëzua nga një dashuri reale për të cilin s' pati përgjigje, dhe pohimi i tij që, kur e pati shkruar s' e njihte dashurinë, mund të shpjegohet me ndrojtjen e klerikut.. Studiuesja analizon edhe krijime të tjera të rinisë së Santorit, poemthin lirik pothuajse të panjohur “Vashat” të zbuluar prej saj në Arkivin e Shtetit, vjershën “Fjuromë hënëzës” që u botua në gjallje të poetit, një novelë interesante për dashurinë dhe xhelozinë (“Di motrat e bashkëljera – Dy motrat binjake), e pabotuar dhe e pavlerësuar nga studiues të tjerë (autorja vetë e kishte analizuar në një studim që i paraprinte monografisë po ketu zgjerohet dhe plotësohet), një novelë në vargje, tepër e freskët dhe fine, “Novelëzë arbëreshe” ku zhvillohet një motiv popullor që kishte frymëzuar edhe De Radën. Studiuesja në fjalë analizon edhe një poemth social që pasqyron me dhimbje paditurinë e fshatarëve arbëreshë “Hekurudha ose malësori plek”. Përveç kësaj analizohet një vjershtë me karakter politik që shpreh zhgënjimin e thellë të Santorit pas bashkimit të Italisë, po që ekziston vetëm në dorëshkrim, “Kënkëzë politike” dhe e vendoset më lart nga ana estetike duke e krahasuar me vjershën që Santori ia kushton Dora d' Istrias.

Dy nga kapitujt më origjinalë dhe të rendësishëm të monografisë janë “Santori poet satirik dhe humorist”, dhe “Fabulat”. Në këta kapituj zbulohet përmasa e re që autori arbëresh i fali letërsisë shqiptare, përmasa e humorit që rrok “satira” dhe “ rrëfimet satirike dhe fabulat

Në plan artistik më të realizuarat janë të ashtuquajtura “satira” të cilat në të vërtetë janë më tepër disa tablo e portrete humoristike dhe fabulat, rimarrje krijuese të motiveve të marra nga Ezopi, La Fonteni dhe ndonjë fabulist tjetër, ku Santori arrin të krijojë një minigaleri personazhesh ku bëjnë pjesë kafshë, bimë, madje edhe trupa qiellorë të antropomorfizuar, krijesa të tokës të ajrit, të ujit si edhe njerëz me dobësitë dhe veset e tyre. Santori është një fabulist tepër i veçantë në krahasim me dhe çajupin. Studiuesja e analizon me hollësi formën e të gjitha krijimeve të lartpërmendur të autorit arbëresh dhe veçon “rrëfimet satirike”, si më të dobëta, meqenëse aty pasioni njerëzor i urrejtjes personale e ka penguar Santorin të arrijë katarsisin, ndonëse nuk u mungojnë disa vlera. Në këtë përfundim Klara Kodra bashkohet me studiuesin Gradilone. Studiuesi Rexhep Qosja që sheh në krijimet satirike me të drejtë vokacionin e vërtetë të Santorit, nuk e bën këtë dallim.

Një kapitull i veçantë u kushtohet “romancetave” që autorja i përkufizon, jo si novela në vargje, siç bëjnë studiuesit Gradilone dhe Fortino, as si një lloj i ndërmjemë midis novelës dhe romanit, sipas tezës tërheqëse, po të diskutueshme, të studiuesit Bullo që sheh në këto krijime si thelbësor etnografizmin, po siç i ka quajtur edhe vetë Santori, “romane në vargje”. Këtu mund të lindë një pikëpyetje. Gjersa Klara Kodra synon t'i përfshijë romanet në një tjetër monografi, pse i përfshin këto romane në vargje në monografinë e botuar? Mendojmë se studiuesja e bën këtë, duke i parë këto krijime si vepra të poetit rrëfimtari Santori që paraqesin fillesën epike tek ai dhe duke i veçuar nga romanet në prozë.

Në këto krijime gjejmë një tjetër minigaleri personazhesh që shihen tashmë në plan dramatik dhe tragjik që dëshmojnë



aftësinë prej psikologu të Santorit që është i aftë të krijojë karaktere të ndërlikuar, herë duke u bazuar në poetikën romantike, herë në poetikën realiste. Edhe ndër “romancetat”, studiuesja veçon disa si më të realizuarat nga ana estetike, ndonëse në një farë kuptimi ato plotësojnë njera-tjetrën.

Një shtyllë e rendësishme mbi të cilën mbështetet struktura e monografisë është kapitulli i dramaturgjisë. Studiuesja thekson rolin prej themeluesi, po edhe krijuesi të një larmie tipologjike të Santorit dramaturg. Ajo vëren se Santori i dha letërsisë arbëreshe dhe shqiptare, tragjedinë e saj të parë “Neomenien”.

Duke e analizuar atë, studiuesja synon të tregohet objektive, të mos humbasë në ekzaltime të skajshme siç ndodh me studiuesin Anton Berisha që me entuziazmin e vet patriotik i atribuon kësaj tragjedie edhe vlera që nuk i ka. Studiuesja vëren vlerat e padyshimita të kësaj tragjedie rinore, po edhe ato të meta që ia kanë kufizuar nivelin artistik. Edhe në kapitullin që i kushtohet dramës “Emira”, studiuesja njeh meritat e paraardhësve me të cilët, herë solidarizohet, herë debaton dhe përpiqet të zgjidhë disa çështje të mbetura pezull, lidhur me origjinalitetin tipologjik të kësaj vepre, saktësisë së botimeve të saj dhe ç’ është kryesorja, vlerës së saj estetike. Studiuesja vëren se te “Emira” mund të gjejmë një potencial që do ta shndërronte në kryevepër, po që autori arbëresh nuk e zhvillon deri në fund. Kodra evidencon një nga meritat më të shquara të dramës, skalitjen e dy personazheve që jepen në zhvillim, njeri me kah pozitiv, tjetri me kah negativ, Kallina dhe Kallonjeri, skalitje që dëshmon edhe një herë për aftësinë e Santorit si psikolog, dramatizmin e konflikteve, tablotë realiste të mjerimit dhe të dhunës së ushtruar në mënyrë cubat dhe nga ana tjetër prej kolonelit Fumel, përfaqësuesit të shtetit të ri italian që përzien fajtorë dhe të pafajshëm, duke synuar të zhdukë cubërinë. Studiuesja thekson evolucionin që ka pësuar te Santori tema e cubave që është vënë në bazë të disa veprave të tij rinore. Duke u ndalur te një lloj i ri dramatik edhe ky i trajtuar për herë të parë nga Santori studiuesja thekson se ky lloj i përshtatej më tepër individualitetit të tij krijues dhe veçon melodramat më të realizuara sipas saj “Aleks Dukagjini” dhe “Pjetër Shtërori”.

Studiuesja e sheh Santorin si komediografin tonë të parë me dy komeditë dhe zakoneve “Kallogrea Karroqare” (“Vejusha koprace”) dhe “Polikarpi” (rregullim) që, ndonëse të papërfunduara, dëshmojnë për talentin e autorit arbëresh. edhe në këtë lloj. Studiuesja thekson gjithashtu origjinalitetin e Santorit dramaturg në krahasim me letërsinë bashkëkohore italiane dhe në krahasim me pasardhësit që do ta ndjekin më vonë në letërsinë e atdheut mëmë dhe shpreh keqardhjen e vet që ky autor original nuk mund të komunikonte me publikun e kohës. Një kapitull autorja ia kushton ndikimeve të Santorit nga letërsia italiane, duke pohuar se këto ndikime nuk e zbehin veçanësinë e tij. Në dy kapituj të tjerë trajtohen problemi i realizmit të Santorit dhe meritat e tij si fjalëkrijues që kontribuon në krijimin e një forme me vlerë të padyshimtë estetike. Në një kapitull tjetër autorja nxjerr në dritë një aspekt të lënë në hije të Santorit, poezinë ndaj bashkëstudiuuesve paraardhës dhe kufizimet e veta.

Për mendimin tonë, monografia “Santori poet dhe dramaturg” ka vlerë jo vetëm si monografia e parë e plotë për këtë autor lidhur me aspektet kryesore të talentit të tij, po për origjinalitetin e gjykimeve të dhëna, synimin drejt objektivitetit, stilin e qartë dhe të rrjedhshëm, qendrimin e drejtë ndaj bashkëstudiuuesve paraardhës dhe bashkëkohës, argumentet e mbështetura në analizën e tekstit. Natyrisht, ka edhe ndonjë vlerësim që mund të diskutohet, po mendojmë se në thelb monografia ia ka arritur qëllimit të vet.

(vijon nga faqja 11)

vlerën e një metafore, si një nënë që e ndjen për detyrë të ndihet gjithsesi *fatbardhë*, pasi ka një vajzë, fati i së cilës është fort i rëndësishëm. Në fakt, në më shumë se një rast, e ndjejmë autorin të bëhet personazh aktiv në poemë, duke promovuar një qëndrim kuptimor apo emocional.

Poema pra është realiste, një ansambël notash shumë të ndritshme dhe shumë të errëta, shumë të ëmbëla dhe shumë të hidhta, shumë serioze dhe shumë ironike, të gjitha të dhëna jo përmes ilustrimesh fotografike të romantizmit, por përmes gjendjesh shpirtrore, analizash psikologjike dhe lëvizjesh intensive të vëzhgimit e të imagjinatës.

Si çdo vepër e vërtetë arti, poema reflekton më shumë se çka thotë. Ne e kuptojmë gjendjen e prapambetur e të varfër të fshatit, ndërsa ndjejmë vdekjen e Trinës, por detajet që na sjell autori, thonë se familja ka në tryezë: *Pshesha me kollomoqe / t’mir’ edhe për zotni*. Pra në pasqyrimin e jetës, poeti është i përkorë, dhe *këtu dhe tani* ai po synon harmoninë dhe arsyen, dhe jo ndonjëfarë “realizmi kritik”. Në shënimet estetike, Mjedja tregon klasin e tij të lartë kur shprehet: “*poeti ka për qëllim me shëmbëllye bukurinë*”. Madje edhe vendi ku zhvillohet poema, i tillë është zgjedhur, plot harmoni: *Paq i kthiellhtë prej Perendijet / Paq prej nierit e qeti*./ Duhet të vëmë në dukje këtu se gjeografikisht vendi nuk identifikohet por poeti thotë: *ku fillojnë kufijt e Geget*/. Duke marrë në konsideratë natyrën që na jepet në poemë, kuptojmë se, siç bën Fishta me “*Lahutën...*” edhe Mjedja zgjedh diku kufijt veriorë të “*Geget*”, atje ku ka bjeshkë, borë të mëdha, orteqe, gurra që ushtojnë, por edhe zana të hijshme e të bukura. Dhe, meqenëse Mjedja bën dekor funksional, ka edhe fusha të begata. Pra *fillimi i Geget*, nuk duhet kërkuar në jug as në qendër siç është supozuar ndonjëherë pa kuptim, por në veri, diku ndër ato vende ku “*ndër djepa rrisin/ nanat e Hotit djelmanin’ ushtore*”.

11

Dhe, më duhet të them edhe një gjë që është esenciale për poetin tonë: poema është një visar ku shkëlqen gjuha kumbuese dhe idiomat elegante të dialektit verior të shqipës. Vërtetë, te Fishta gjuha paraqitet më e pasur për arsye të lëndës që vepra e tij ngërthen, por te *Andrra e jetës* ajo vjen më e zgjedhur, më e kujdesur, më e gatshme për tu çmuar. Mjedja ka ardhur te ne si poeti i frymëzimit të përmbajtur dhe i punës këmbëngulëse, veçori këto të pasqyruara te kjo poemë. Ja, po vë në dukje një simetri të habitshme të rimave të cilën e pata paralajmruar! Te *Trina*, në këngën e dytë e të tretë të saj, kemi një skemë rimash komplekse që kryqzohen e alternohen në tetë vargje: ABBC-ADDC. Në fakt për vargjet e para, kemi asonanca ose konsonanca, duke bërë që fraza poetike të jetë më pak e kufizuar, më e lirë në lëvizje. Tani, të njëjtën skemë të rimave, autori përdor edhe në këngën e parë te *Lokja*, që është e parafundit e poemës e që fillon me vargun: *E n’balkue mbaruene lulet/ A mos është një rastësi kjo vendosje simetrikeë* Them se jo. Mjeshtri Mjedja synon ta ngarkojë artistikisht krejt masën e veprës, përmes kumbimit harmonik të mjeteve që ka në dorë, deri edhe përmes simetrisë së tyre. Ja pse poema tingllon për ne si një vepër e madhe muzikore!

12

Thashë që pjesa e katërt e Zogës, është një përjashtim befasues. Nuk kemi zhvillimin e pritur të gjërave si mund të qe, krijimi i familjes së re. Me sa duket, poeti nuk ka dëshirë të krijojë një dekor të ri për vendin ku Zoga është martuar, dhe as të shtojë një lëndë të re që do ta vështirësonte funksionin estetik të poemës. Si thamë, burrat “i ka flakur” nga poema. Përse vallë? Mjedja e humbi shpejt babain dhe u rrit nën kujdesin e nënës, dhimbja për të cilën nuk iu shua kurrë. Ai kujdeset për ta shmangur sa të jetë e mundur epizmin që në esencë nuk i përket poezisë, duke këmbëngulur në tonin lirik dhe dramatik të poemës. Madje, edhe dy fëmijtë e Lokes janë dy vajza, asnjëri nuk është djalë.

Molla t’kputuna nji deget

Dy qershia lidh’ n’nj rrfanë

Ku fillojnë kufijt e Geget

Rrijnë dy çika me nji nanë.

Ato janë “dy mollë” a “dy qershia”, nga frutat më të bukur që rrit toka, plot ngjyra dhe shije.

Kjo metaforë kaq e gjetur, kaq subtile me të cilën fillon poema, na krijon ne një sugjestion befasues, dhe na vendos në një marrdhënie të pafund besimi me lëndën e poemës, duke e ndjerë se ajo do të jetë e pasur dhe e vërtetë. Vetë poeti ka në dorë tashmë një lëndë të çmuar, të përshtatshme për realizimin e synimit të vet artistik: bërjen bashkë të zërave poetikë që ndjen brenda vetes, në një vepër të bukur, të thellë, realiste dhe harmonike. Si në një piramidë të ngritur me shufra diamanti, ata zëra mbajnë dhe mbështesin njëri-tjetrin.

Siç është kredoja e poetit, krejt poema përshkohet nga ndjenja e së bukurës, e së lartës dhe e fisnikes. Edhe bylbylat këndojnë *valle darsmet e fisnike*”. Idetë janë të thella por edhe të kthjellta dhe nuk hyjnë nëpër labirinte. Lëndës së poemës i jep formë një imagjinatë e pasur e cila prodhon pa pushim figura letrare, të perceptueshme përmes shqisave apo koncepteve.

13

Kënga që fillon me vargun e paharrueshëm për kumbimin shqip: *E kandshme asht hana*, e cila në mënyrë të pabesueshme me sa di, nuk është vënë në muzikë nga asnjë kompozitor, gjë që tregon për lidhjet problematike mes arteve në Shqipëri, pra kjo këngë, ka njëzetekatër vargje të kombinuar, pesërrokësh dhe shtatërrokësh. Ritmi kërcen si gishtat mbi tastjerë. Rimat janë sipas skemës AABCCB. E gjithë pjesa zhvillohet në kërkim të një metafore, të kërkuarit e së cilës na çon në një varg analogjishë sugjestionuese për buzëqeshjen e foshnjës, *kur nana mbi të përkulet*/.

Poeti ndodhet në një gjendje kërkimi dhe meditimi. Pothuaj është shkëputur nga realiteti dhe është sublimuar për t’iu kthyer këtij realiteti me një dhuratë superiore. Gjithçka që ka të bukur toka jonë, i vijnë nëpër mend. Problemi është se duhet të zgjedhë, dhe jo vetëm kaq, duhet edhe t’i shprehë me gjuhën e harmonisë, pasi zgjedhja e idesë dhe ajo e përkujdesjes poetike, duhet t’i përkasin të njëjtës shtresë të lartë të origjinës. Ndërsa lexojmë vargjet:

E kandshme asht hana

kur del me zana

e n’tokë me dritë përndaret/



pra, kur lexojmë këto vargje, ne nuk na vjen ndërmend ndonjë gjë mitologjike a mistike, por imagjinata jonë vihet në punë për të kujtuar bukuritë e pashprehshme, ndonëse tokësore, me të cilat ne çojmë jetën tonë, por për të cilat jo aq shpesh kujtohemi. Më tej:

Kur del agimi

e rruzullimi

me j’drit’ kuqloshe mbëlohet

shkruan autori. Ne ndihemi të rrethuar nga drita e agimit. A nuk kemi këtu një perceptim të çuditshëm impresionistë Ndërsa era e lehtë, flladi, na vjen si një vashë:

E k’naqshme ajo lule

kur iu përkule

o fllad i lehtë me e lmue.

Dhe, vërtetë, sa e kënaqur, duhet të jetë ajo lule nën përkëdheljen e flladit, që vetë ndërkaq *me erna veshet*, si një vashë, me ernat e lules! Pra, poeti u referohet bukurive të qiellit të natës, të dritës së agimit dhe të ditës së pranverës. Por më bëhet se, të shkruarit e kësaj kënge nuk ka filluar me asnjërën nga këto, por me vargjet e fundit: *foshnjës që i qeshet / nanës, kur mbi të përkulet*. Madje, edhe ideja e vetë poemës ka ardhur mbasi është shkruar kjo këngë. Dhe, ka ardhur pikërisht për ta mbështjellë këtë margaritar, për t’i krijuar idesë metafizike të vijimit të jetës njerëzore, një botë ngjyrash të vërteta jete dhe arti. *Eureka!* po krijohej mundsia për të bërë diçka që s’e ka bërë, për të shprehur ato që ka akumuluar si poet, në gjithë këto vite leximi, vëzhgimi dhe kërkimi, duke shmangur shkumën dhe mbetjet, dhe duke lënë veç *lëndën e kulluet* që rezulton në fund të rafinimit, ku përftohet poezia e pastër! Një energji krijuese e vërtetë që vënë në lëvizje, dhe po rrihte muret e ndjeshmërisë, të intelektit e të imagjinatës.

14

Këto i kam menduar prej shumë vitesh. Por nuk kam as fakte as argumenta, përveç diçkaje shumë subjektive të përjetuar në jetën time. Ka qenë viti 1972, qershor. Pak kohë më parë kisha filluar punë si agronom në Koplik. Atë ditë, ndërsa po dilja nga qyteza për në fusha, më ra udha të kaloj pranë çerdhës së fëmijëve. Siç ndodhin në jetë gjëra të rastit që befas bëhen të rëndësishme, ktheva kokën nga porta e madhe e hapur, dhe më mbetën sytë te një gjë shumë e zakonshme, por edhe e pazakonshme atë çast për mua: një nënë po i jepte gjì foshnjës së vet, në dritën e kaltër të asaj paradite vere. E njihja: ishte një grua e bashme dhe e hijshme. Gjiri i saj i zbuluar ishte i plotë dhe i trëndafiltë, ndërsa nën të një foshnje, gjithashtu e shëndetshme pinte *tamblin*, kushtin e jetës, esencën e këtij planeti.

Ika si i dalldisur nga ndijimet. Verë. Ngjyrat e fushave, diku të blerta diku të arta. Isha plot tallazitje poetike në atë fillim të viteve ’70, koha e shkurtër e liberalizmit dhe e shpresave. Nuk e di, atë ditë apo pak ditë më pas, shkrova poezinë *Foshnja në gjì*, të cilën më erdhi radha ta botoj për herë të parë, pas dymbëdhjetë vjetësh, në librin tim *Vise me diell*. Më pëlqen kjo poezi, dhe e kam shumë të dashur, si gjënë e vërtetë tek e cila kemi mbërritur në një moment të jetës.

Qysh atëherë koha ka rrjedhur si ujët nën urë, jeta po ashtu, dhe kam menduar shumë gjëra. Kam menduar se Mjedja, ka pasur një përvojë të ngjashme lidhur me *Buzëqeshjen e foshnjës*, si nxitje, si fillim. Ka pasur një takim, një shkëndijë që ka rezultuar me një produkt të përcaktuar për të qenë jashtë skeme. Si çdo poezi e vërtetë, ajo na pëlqen jo duke na entuziazmuar, por duke na bindur, duke na sugjestionuar, duke na lënë në shpirt pa e kuptuar, një pasuri që nuk njeh bjerrje.

15

Unë në bibliotekën time kam tre botime të veprës poetike të Mjedjes (një botim vërtet i mire nuk ekziston), por nuk kam gërmuar ndonjëherë në arkivat e poetëve pasi jeta më pati çuar në disa arkiva tjera. Diku nga mesi i viteve ’90 më ra në dorë një botim i Prishtinës i veprës së Mjedjes, Juvenilia. Aty u befasova nga një shënim që na u gjendka mbi kopjen e daktilografiuar të poemës *Andrra e jetës*, në Fondin Ndre Mjedja: *shkasin e muer Auktori prej nji nane që mbet e vejë me një vajzë të vogël e kje lanë me banue në jerevi të Dom Ndreut në Kukël’*. Ende kjo nuk e vërteton idenë time, por sidoqoftë, ajo nuk qenkesh hamendje në erë! Vallë, kush e bëri këtë shënim dhe, si e dinte ai këtë gjë?

2022

RRATHË TË BRENDASHKRUAR

Cikël poetik nga Rudolf Marku

FATI ËSHTË VDEKATAR

Fati është vdekatar,
Më thotë Ovidi,
Nuk e ka jetën e gjatë.

Kemi mësuar artin e madh të humbjeve,
Mjeshtërinë e durimit – jo të shërimit – të plagëve,
Për të qenë të përgatitur për çdo çast.

Trishtimi zbret nga malet antike të kujtesës,
Trazon lumenjtë, shkapërcen kontinentet,
Trishtimi me krahë mistikë, që u bie kambanave
Për puthjet, për aktin hyjnor të seksit.

Fati është vdekatar,
Më thotë Ovidi,
Nuk e ka jetën e gjatë.

Nga malet mistike të kujtesës zbret trishtimi!
Askush nuk shkon gjekundi, nuk ka asnjë cak.

Tani që kemi harruar edhe të vdesim,
Na duhet ta nisim dashurinë tonë
Prapë nga fillimi!

2019

ISHUJT

Kemi mësuar artin e ikjes nëpër ishuj. Të rrethuar
nga ujërat
Ndihe mi me të sigurt. Bëjmë dashuri më
shkujdesur
Në ishujt britanikë, në Sicili, në Islandë, në
Sardenjë.
Nuk erdhëm në Korsikë të joshur nga lavdia e
Napoleonit;
Lavdia e aktit të dashurisë është e mjaftueshme. Të
mbrojtur nga ujërat
Lakuriqësia jonë është më e shkujdesur, më pak e
kompromentuar.

O tokë ishullore, sa e ngjashme që je me dashurinë!
Brenda një harku të ngushtë rrethor ti krijon
pafundësisë tënde;
Të kushtëzuar nga mbërritja e trageteve, shëtisim
planetët;
Natën lexojmë në qiellin e errët konstelacionet,
Ndërsa prej ishullit më të vogël i shohim më qartë
kontinentet.

Kemi mësuar artin e ikjes nëpër ishuj. Si Uliksi në
fundin e jetës së vet,
Pas betejës së Trojës, e dinim se ishulli i Itakës na
pret.

Korsikë, Ajaccio, 2019

JAM BRENDA NË GURË

Në male u ngjita një ditë, në malet e thepisura,
Në lartësi marramendëse ku s'kisha qenë kurrë.
Skulptor, kur të gdhendësh tash me daltën tënde,
Mos godit me forcë, se jam brenda në gurë!



JEMI NE, JO STATUJAT

Nuk janë statujat që thyhen në copëza.
Jemi ne, të gjallët, që jetojmë njëherësh në
fragmentet e jetës sonë,
Jemi pranë Oqeanit Paqësor po në atë çastin kur
prekim ujërat e Adriatikut,
Jemi ne që thyhemi në thërrmija të vogla, në
fragmente gurësh mozaiku,
Hedhur shkujdesur një këtu, një atje, në kufij
kontinentesh,
Brenda trajektoreve të paparashikuara të fatit.
Statujat nuk thyhen – e njoh natyrën e tyre
kokëfortë,
Pagjumësinë e tyre të përjetshme, mbështjellë
brenda lëkurës së gurëve që nuk thyhet kurrë.

Fragmentet tona mund t'i gjeshtë në Avenjunë e
Pestë, në Times Square, në Athinë,
Në ishullin e Korsikës, në Zaragozë, në një hotel
pranë katedrales së Strasburgut
A ngjitur me shtëpinë e Albert Durerit; në Prague,
duke kërkuar gjurmët e Franc Kafkës,
Në malin oshënar të Shën Mishelit a në një mal të
thatë pa emër të Kroacisë,
Me lëkura gjarpërinjsh të lënë pranë gurëve të
hedhur të fatit, si ditët tona.

Nuk janë statujat që thyhen në copëza. Jemi ne.
Në fragmente ëndrrash, dashurish, luftërash,
urrejtjesh,
Hedhur në cepa kontinentesh, duke pritur prapë
kthimin e argonautëve;
Me këmbët në lumin Drin dhe me torson e zhytur
në thellësitë e Paqësorit,
Shohim sirenat e detit pa arritur kurrë të dëgjojmë
këngën e tyre,
Shohim nekrologjitë në mure pa i parë kurrë të
vdekurit.

2019

NJË SHKËMB NË DET

Një shkëmb në det ku shkoja me not,
Për të mbërritur një cak. Vetëm të arrija një cak.
Nga larg njerëzit dukeshin të vegjël,
Por ja, në breg, ngjasonin më të vegjël.
Liria për të qenë i vetëm,
Por dhe ankthi i vetmisë.
Ndonjëherë klithmat e pulëbardhave në det
Më dukeshin si shpirtrat e njerëzve të mbytur,
Por prapë notoja drejt shkëmbit, në det,
Që të arrija një cak, vetëm të arrija një cak.

Doja të shihja floçkat që niseshin gjithnjë para meje
Duke lënë mbi shkëmb jehonën e shurdhët të
braktisjes.
Ndiheja si ajo anija fatale, e kobshme,
Me të gjithë marinarët e vet të vdekur,
Për të cilën flet Edgar Allan Poe.

Ajo anija që vorbullat e ujërave e marrin me vete
Dhe e shpien ku të duan, sepse kapiteni ka vdekur,
Edhe bocmani, edhe vetë busullat kanë vdekur.

2018

BEFASI

tregim nga Mira Meksi

Me vështirësi e mbaja kokën palëvizur sipër ujit. Trupin e kisha lëshuar si të pajetë dhe, për të shpëlarë lodhjen dhe mendimet e liga, gjasmoja vdekjen. Shpejt zhurmëzat e paemërta përreth meje më bënë ta braktis idenë e paqes së trupit të lëshuar si në pajetë dhe nisa të valëzoja lëkurën time si gjethe mbi ujë, si algëzë e braktisur, si gjysmëguackë arre. Mendoja për plakjen tënde të përnjëhertë përpara syve të mi, të cilën ti po e vuaje shumë në heshtje. Ndërsa unë atë ndjesi po e përtypja pak e nga pak çdo ditë dhe e përdorja që të imunizohesha për të mos e ndier të thekshme vuajtjen kur të vinte koha ime. Nuk do ta lija plakjen të më kapte në befasi, do të përpiqesha t’i përgjoja çapin, apo ndoshta do të ishte më e udhës ta lija të bridhte revan, të më avitej kur të donte, të më kaplonte të gjithën që të arratisesha pastaj bashkë me të, e sigurtë se nuk do të kisha më dhembje kohe...

Zgjata dorën dhe nga shishja qelqtrashë drejt këndshe derdha ca guriçka drejt e mbi lëkurën e kraharorit tim: në ujin e vaskës guriçkat “White castle”, duke u shkrirë, nisën të lëshonin rrëke në ngjyrë manushaqe me xixa të bardha dhe ca minerale të panjohura, të cilat, porsa arritën të bashkoheshin me avujt, shpërthyen në aromë e magji dhe iu vërsulën kokës sime...

*

M’u shfaqën të trija brenda një çasti kohe të fëmijërisë së largët, ulur në shkallët e gurma të oborrit të shtëpisë së gjyshërve të mi në qytetin e detit: Moza me flokët dybishtaleca me kordele të vogla të verdha, që fërkonte një më dy hundën dhe nuk e lëshonte nga dora kukullën kineze, e cila kishte një aromë të mrekullueshme kauçuku të parfumuar, ishte ulur në krye të shkallëve. Lana hollake, e thërrisnim edhe bisht fshese, me një fund verëfi të kuq, – vërtet, tani që e vështroja me vëmendje, kur fliste, ajo e rrotullonte kokën si fugë dhe ngjante pikërisht me një bisht fshese, – dhe me një qese të vogël ku mbante përherë gurët e pendalleve, apo guraçokët, ndodhej një shkallë poshtë Mozës; në faqen e majtë kishte një të gërvishur të gjatë, që m’u kujtua se ia kishin bërë degët kur pat rënë nga kumbulla një javë më parë. Ngjitur me të ishte ulur Teuta me qerpikë të gjatë e cila kur fliste, ngjante sikur pëshpëriste.

Fjaloseshim tamam si atëherë përpara lojës, madje pashë me bisht të syrit se si, Lana mosbesuese, u nxori majën e llapës Mozës dhe Mirës, kur unë u rrëfeva se babi im do të na dhuronte pendalle prej briri. Që të trija duheshim dhe e quanim njëra tjetrën si shoqe të ngushta, andaj edhe vendosa që pas lojës t’ia thosha nja dy fjalë Lanës për atë llapën e kuqe që e nxirrte vend e pa vend. Por diçka nuk shkonte, nuk po gjeja dot se në ç’pikë të hapësirës gjendesha unë vetë. Sigurisht që isha aty, duke biseduar dhe duke luajtur me shoqet e mia të shkallët e gurma të oborrit të shtëpisë së gjyshërve të mi në qytetin e detit. Po ku tamam, ku ishte vendi im, te shkallët? Çfarë kisha veshur? Si dukesha? Asgje nga këto nuk gjendej në kujtesën time. Shiko, tani po pikasja që Moza, kur fliste, përplaste dendur qepallat përmbi mollëzat e faqeve që i kishte të kuqe dimër-verë. Ku ndodhesha unë?

Kur mendja lodhet, kur shqisat zënë e turbullohen, kur gjer edhe dëshira për të jetuar kthehet në dyshim, e vetmja strehë shpëtimtare është fëmijëria, koha që ka rrjedhur, një pikë e saj e qëruar dhe lëmuar prej gjithë të ligave, lënda e së cilës është e ngjizur me paqe dhe ku futemi vrik duke kalëruar kujtesën. Nuk është e lehtë: harresa shpesh ia del të mbulojë gjithçka me mjegullina dhe kujtesa e lodhur dhe e bjerrur, me vetëm pak copëza të mbetura të kohës së dëshiruar, nuk na shpie dot në strehën shpëtimtare. Na braktis në mes të udhës. Porse nuk heqim dorë kursesi nga përpjekja për të gjetur shtegun e strehës.

*

Organizova çdo gjë me shumë kujdes. Ishte festë e çuditshme. Në shtëpinë e madhe të gjyshërve të mi, në lagjen e qytetit të detit që mban emrin ogurzi *Karabash* dhe që në otomançe përkthehet “tokë e zezë”, kisha ftuar të tria shoqet e mia të ngushta të fëmijërisë, të cilat vazhdonin të jetonin në qytetin e detit. Nuk i kisha takuar që prej njëzet e pesë vjetëve që jetoja në kryeqytet.

Moza dhe Lana qëndronin të ulura përballë meje përreth tryezës së ulët ovale njëkëmbëshe në verandën e shtëpisë, ndërsa Mira ende nuk kishte mbërritur. Përmbi tryezë ndodhej një pjatancë plot me ëmbëlsira bufka me mjalte, nga ato që ime gjyshe i bënte sa hap e mbyll sytë për të na ëmbëlsuar kur ishim të vogla. Sillesha e shpenguar dhe i pyesja për familjen, fëmijët. Vura re që Lana ishte veshur me të errëta. E pyeta me vështrim. I shoqi i kishte vdekur përpara dy vjetësh: “E gëlltiti Otranto si shumë djem e burra të Vlorës!” tha me pikëllim dhe mllef, “fati i ne shqiptarëve që na duhet të endemi botës për të patur një jetë që të quhet jetë...” E ngushëllova si munda. Pastaj, ngadalë, bisedat tona u përqendruan të qyteti ynë i fëmijërisë, i shkatërruar krejt gjatë vitit të mbrapshtë 97 kur shteti ra dhe shqiptarët luftuan kundër shqiptarëve. Nisa t’i pyesja për fqinjët, të njohurit, shokë të lagjes. Shpesh ato të dyja thoshin: “Filani ka përfunduar në Otranto, edhe fisteku, po në Otranto”, e thoshin me një natyrshmëri dhe lirshmëri të atillë sa dukej sikur thoshin: në Picorrugë, rrugicë e lagjes, apo në Skelë a në Ujin e Ftohtë të Vlorës. Ne flisnim e flisnim dhe zemra më rrihte fort, sepse asnjë element i atyre çasteve nuk po nxiste ndonjë kujtim të veçantë tek unë që do të më ndihmonte për të gjetur shtegun e strehës. Nuk po dija se nga t’ia nisja. Të isha gabuar vallë? Mos ishte i kotë ai takim?

Ndonëse ftesa ime i kish çuditur jo pak, nuk dukej të kishin pikasur gjë nga qëllimi im i vërtetë, dhe pak të ngjarë kishte të ndodhte. Më merrnin për një nostalgjike të pashërueshme. Në të vërtetë dëshiroja ta përdorja takimin me mikeshëzat e mia të dikurshme për të ringjallur të plotë dhe për ta përjetuar kujtimin e një kohe të fëmijërisë që ma kishin sjellë të gjymtuar mineralet e panjohura të guriçkave “white castle” në vaskën time. Dëshiroja të gjeja shtegun e strehës shpëtimtare.

U shpjegova se kisha ardhur të pushoja disa ditë në shtëpinë e gjyshërve të mi, ku nuk banonte njeri prej kohësh dhe se ato, shoqet e mia të dikurshme, ishin të vetmit njerëz që dëshiroja vërtet të takoja në atë qytet.

Duke mbllaçitur një copëz ëmbëlsirë, Moza nisi të fërkonte hundën.

-Ua! Po fërkon hundën tamam si në vogëli! - thirra unë me një gazmim të beftë.

-E mbake mend! - u çudit Moza që nuk e lëshonte hundën. Filluam të qeshnim të tria. Vendosa të bëj përpara.

-Posi nuk e mbaj mend! Më kujtohet edhe kukulla jote kineze me aromë të mrekullueshme, më kujtohen edhe bishtalecat e tu me kordele të verdha.

- Të blerta, Moza gjithmonë i vinte kordelkat të blerta, e mbaj mend mirë, - u hodh Lana.

-Të verdha, mua më kujtohen të verdha. Hë Moza, si i kishe kordelet?

-Nuk e mbaj mend. Më kujtohet vetëm një rreth i kuq plastik që vija në flokë.

-Rrethi i kuq është shumë vite më vonë, kur nuk i mbaje flokët me bishtaleca dhe kur ndërrove shkollën, - ia pati Lana.

-Ndërsa mua më kujtohen si sot këto ëmbëlsira që na



bënte gjithmonë gjyshja jote, - tha Moza. - Më kujtohet mirë edhe gjyshja, jeton?

-Jooo, ka disa vjet që ka vdekur. Ej vajza, - u thirra unë si dikur me çapkënllek, a ndërtojmë një kujtim fëmijërie? Një lojë?

Pa i lënë të hapnin gojën, i zura të dyja për dore, i tërhoqa gjer te shkallët e gurma të oborrit dhe vijova:

-Eshtë pasdite vere dhe jemi mbledhur të luajmë me pendalle. Moza, ti je ulur në krye të shkallëve, flokët i ke mbledhur dy bishtaleca me kordele...

-Të blerta, - tha shpejtazi Lana.

-Të blerta, mirë, mban në dorën e djathtë kukullën kineze, ndërsa me të majtën fërkon një më dy hundën. Ndërkohë, si pa dashje, Moza kishte zënë sërish të fërkonte hundën. Përtej shkallëve kish nisur të lulëzonte një bimë e madhe zambaku.

-Lana, ti qëndron ulur një shkallë poshtë Mozës; **në dorë mban qesen me gurët e pendalleve, - flisja unë.**

-Si gjithmonë, - ia pati Moza.

-Ke veshur fundin e kuq verëfi. Kur flet, rrotullon kokën si fugë dhe ngjan tamam...

-Me një bisht fshese? - qeshi Moza.

-Unë bisht fshese? Unë që peshoj shtatëdhjetë e ca kile?

- gjegji Lana e ngazëllyer.

-Ndërsa Mira është ulur... ku është Mira, pse u vonua kaq shumë? - u kujtova une

-Mira?!!! - britën shoqet me një gojë.

-Ia dërgova letrën në adresën e shtëpisë së **prindërve**. Mendova të mblidheshim të katërta; të mos e ketë marrë vallë ftesën time? A keni ndonjë numër telefoni?

Nuk pata përgjigje. Heshtje e gjatë.

-Mira ka vdekur, Teuta, - e mori veten e para Lana. U bënë pothuaj dy vjet. Aksident me makinë në Greqi.

Ndjeva një të therur të fortë në ijen e majtë, por u mundova të mos e jepja veten, sepse përndryshe gjithçka do të prishej sa hap e mbyll sytë. Magjia e lojës do të shkrihej përgjithmonë dhe nuk do të mund ta ringjallja dot të plotë kujtimin tim. Kishte arritur në një pikë të mirë...

-Vajza, ta kemi dhe ta kujtojmë Mirën tonë me këtë lojë.

Pra, Mira është ulur ngjitur me ty Lana, - vijova unë ngulmazi me zërin që më dridhej paksa.

- Flet sikur pëshpërin dhe pulit sytë me qerpikët e gjatë.

Lana, çfarë e ke këtë shenjën në faqe, je vrarë?

Lana heshti një hop dhe u dëgjua zëri i Mozës sikur të vinte nga një tjetër kohë:

-U çor kur ra nga kumbulla përpara një jave.

Moza kishte lidhur gishtin tregues me atë të mesit dhe së bashku me gishtin e madh, kishte **formuar** një si urë e po mundohej të fuste brenda një pendalle, duke hedhur dhe duke pritur një tjetër gur me dorën e lirë.

Gjithçka po funksiononte mrekullisht.

-Babi më premtoi se do të na dhurojë pendalle prej briri,

- thashë unë dhe ngrita një pendallë që i ra Mozës nga dora.

Njëllorj siç e mbaja atë çast të vendosur në kujtesë, bishti i syrit më rrëfeu se si Lana mosbesuese nxori majën e llapës. M’u ngritën ashtu kot nervat dhe bëra t’ia përplasja.. porse u përmbajta.

Kishte ardhur çasti i duhur. Do të bashkohej e shkuara e kujtimit dhe e tashmja e gjasmimit të kohës së fëmijërisë – do të mund të gjeja udhën e strehës sime. Shoqet e mia ishin zhytur gjer në majat e flokëve në fëmijëri, ndërsa ajri ish tejmbushur me aromë vere. E tashmja pothuaj nuk ekzistonte.

-Ku ndodhem unë? - iu drejtova të dyjave ëmbëlsisht.

Heshtje. Moza çliroi gishtërinjtë dhe uli përtokë gurin e pendalleve. Lana po më vështronte e çmeritur:

-Si ku ndodhesh ti? Nuk të kuptoj.

-Më tregoni, në ç’vend jam ulur unë këtu te shkallët, ç’kam veshur, ç’po bëj tamam, po flokët, flokët, si i kam? - flisja dhe më merrej goja nga nguti, Seç m’u krijua një parandjenjë e keqe. Ato të dyja më vështronin pa folur. Ngritën supet. Panë njëra-tjetrën në sy. Ngadalë ulën kokën. Unë prisja dhe vazhdoja të prisja duke u lutur në heshtje që të kujtonin diçka, nuk ishte e mundur që unë të isha zhdukur ashtu pa nam e pa nishan nga kujtesa e tyre. U rrokullisën prej kohës minuta të rënda si kokrra të mëdha breshëri, përpara se Moza të fliste:

-Nuk të mbajmë mend, Teuta, ndjesë.

-Mira ka vdekur, u bënë pothuaj dy vjet, - **përsëriti** Lana dhe unë, më në fund, kuptova. Kuptova se kujtimi im kish vdekur bashke me të se, për fat të keq, ajo, pikërisht ajo dhe askush tjetër, paskësh qenë ruajtësja e kujtimit tim. Nuk e ndala dot përfytyrimin që po më punonte etshshëm: pashë si zhdukeshin copat e imazhit tim të fëmijërisë në agoninë e saj prej emigranteje shqiptare përmbi asfaltin e pakuptimtë të një qyteti të largët të Greqisë; pashë si zhdukeshin pa kthim një e nga një, fustani im me nusepashke të kuqe, apo topa të kaltër, kordelja rozë apo e kaltër, sandalet e bardha, flokët me onde ... dhe unë nuk mund t’i ngulisja dot në kujtesën time prej të gjalli. Dhe në kujtesën e askujt.

E brishtë, verdhacuke, e mardhur prej një të ftohti të beftë, e tashmja mbretëronte.

STINËT E HUMBURA

poezi nga Pavle Goranoviq

Përktheu nga origjinali Dimitrov Popoviq

SI ËSHTË KRIJUAR POEZIA

Një nga një
peshoj çdo shkronjë,
çdo rrokje e mas me ditë,
me muaj,
në yjësitë e mjegullta
të stinëve të humbura të vitit.

Ruhen fjalët
ngadalë,
si shishet e verës së mirë në bodrum.
Deri sa ende s'kanë dalë në dritë,
bie mbi to me zori një pluhur i dukshëm, bojëhiri.
Herë pas here zbres deri tek to,
i shikoj dhe butësisht fshij pluhurin.
Zbres tek to si tek gjerat antike me vlerë,
të cilat ruhen në mënyrë egoiste
dhe gjithnjë zgjedhin me kujdes se kujt do t'i
tregohen.

O, fjalët e mia,
që vetëm nganjëherë ju nxjerr në dritë
dhe dhimbjen e të cilave e njoh vetëm unë,
a do të më vijë keq pse nuk ju bëra pjesë të harrimit,
nga që plotësisht e zhvesha botën time.
Ngadalë mblidhen kokrrat,
është akoma larg sa të bëhen shumë,
ndonjëherë duket si e pa arritshme.
Derisa jam në gëzimin e vetëm të krijimit
në të vërtetë dhe duke gjetur vargjet e drejta,
kurrë nuk i besova vetes:
vetëm kam dashur të bëhem poet.

Prej një kohe të lashtë për mua,
udhëtoj atyre vendeve
me manastire të rrënuara.
Nëpër tokën pa shpresë,
sipas një nostalgjie të dikujt udhëtoj.
Kaloj përmes kthesave të shenjave
duke u kapur për qimet e flokëve
të asaj gjuhe të çuditshme të poetit.

Dhe pastaj i vetëm
si një skulptor para figurës së pakryer:
largoj gjithë çfarë është e tepërt.

Ngadalë mblidhen kokrrat,
një botë bashkohet.

Përsëri, pikë nga një pikë,
bien në bardhësinë e thjeshtë
ato shenja që ndoshta diçka duhet të shënojnë:
të gjitha qëmtimet tona.
Hedh poshtë fjalët që dikush,
kush e di se kur dhe me çarsye i trilloi.
Por, si ato ta kenë jetën në poezi,
si t'ua arrij kuptimin,
kur edhe gjërat nuk dinë për emrat e tyre.
Kur secilit prej nesh i është caktuar
vetëm një orë zalli
për jetën e vet, të zakonshme ose poetike.
Qëkur u jam afruar poetëve
dhe jam betuar,
me një bori të hollë të shpallur,
- atë manifest të kotë,
asnjëherë nuk thashë:
ja ku jam, më në fund, mes të vetëve.

A do të më vijë keq ndonjëherë
pse pa libra e kam shpenzuar kohën?

A thua në çdo gjë,
kur të ikë bukuria,
kur të fillojë rënia,
kur të shihet turbull arena...
A do t'i mbetem edhe vetes diçka borxh?

A do ta qortoj veten ndonjëherë:
sa pak paskam shkruar.

GJËRA TË VOGLA TË VDEKSHME

Muzika që nga tarraca e afërt
mbërrin deri tek ne, përmes një nate të thjeshtë
nate vjeshte, të themi
sepse kjo që kujtoj ndodh në atë pjesë të vitit.
Muzika, mjaft e thjeshtë, muzikë e njohur,
e cila më kujton në një natë të kahershme,
në disa darka të kahershme,
në disa heshtje të mrekullueshme dhe në asnjë fjalë.
Gjithë momentet në të cilat nuk përmendesh e
vdekshme.

Muzika që dëshiroj të dëgjoj në automobil
kur nga tuneli futem në qytetin tim.

Loja, loja e ngathët, dhe meloditë për të cilat di
se do ta plotësojnë denjësisht atë ngjarje.
Udhëtimi mes peizazheve të bukura,
vendeve të Istrës me emra të bukur.
Emrat e grave të bukura, emra të poezive të harruara.
Ati ynë në qetësi, kur këtë askush nuk e pret,
era e ngrohtë që papritur fshin fytyrën tënde,
në fytyrën që e ke të dashur, disa sish.
Kudo vetëm emrat që nuk nënkuptojnë vdekje.
Loja me topin, loja me fjalët, lojërat më të bukura.
Ajo kohë kur ëndërrojnë dhe gjërat dhe njerëzit.

Ajo që ke qenë dikur, ai njeriu i pa shpjegueshëm.
Diçka që nuk lëshon të ketë emër
ose emrin që më nuk i ka hije.



Miqtë e atij njeriu, të asaj kohe,
janë veç një çift, ata gjithmonë janë vetëm aq.
Dikush që e njeh se është i turpshëm, si ti,
Se ka shprehitë që ke edhe ti vetë.
Ose, thjesht, askush, askush i yti.
Gjithë vetëm njerëzit për të cilët mendon se do të
jetojnë gjithmonë.

Njeriu, kjo përbërje fatkeqe, kjo fjalë e fortë.
Dita e tij për të cilën mendon se nuk ka fund.

Të vogla janë ato gjëra, të gjitha ato kanë rëndësi,
se nuk dinë për vdekshmërinë tonë.
Të mëdha janë vetëm ato momente
në të cilat nuk kujtohesh për vdekshmërinë.

Përndryshe, si do të mund të jetoje në përgjithësi,
mendon në fund të poezisë.


PYETJE NË ANKTH, MES RUTINAVE

E çfarë nëse njëherë do të na pyesin për vdekjen
jashtë kohe, atëherë kur të përgatiteshim
për shëtitje, ose duke pritur një takim pune.
Çfarë nëse do na pyesin për vdekjen-
kësaj të afërme relative që akoma nuk e shohim,
ndërsa presim një vizitë tjetër gjithsesi.
Çfarë, nëse mes dy rutinave,
na pyesin për vdekjen,
për pjesën e panjohur dhe të gjykuar të qenies sonë
të ndrydhur
që banon diku aty rreth nesh që kur jemi krijuar.
Çfarë nëse na pyesin atëherë kur
ndjehemi të pa shqetësuar.
Ashtu si ti, ashtu me sa duket të gjithë këta njerëz.
Siç duket edhe unë, ndërsa çoj në shtëpi revistën e së
dielës
dhe fjalorin e gjuhës frënge
të cilën nuk do ta mësoj.
(Por kam dëshiruar të di
si tingëllojnë disa fjalë nga vjershat e mia në
frëngjisht.)
Çfarë nëse mund të na pyesin për vdekjen,
ndërsa ne fjalët tona të pafuqishme na tradhtojnë.
Çfarë nëse do të pyesin
kur neve në një pasdite të ngathët
do na duket se shohim sesi në qytet enden shpirtrat e
të vdekurve.
Çfarë nëse do të na pyesin për vdekjen,
ndërsa ne të mos kemi kohë as t'i përshëndesim.

PAVLE GORANOVIQ

Stinët e humbura

poezi

Përktheu në shqip
Dimitrov Popoviq

Onufri

E KREHURA

tregim nga Ismail Kadare

I

Në muzgun e dhjetorit, në orën kur kupolat e pallateve dhe të katedraleve rishpërndanin ndriçimin e fundit të ditës që po shuhej, ajo nisi të krihej përpara pasqyrës. E krehura e saj vazhdoi gjatë. Jashtë kullat e qytetit të madh dhanë orën pesë e gjysmë, pastaj gjashtë dhe pastaj gjashtë e gjysmë, por ende nuk e kishte mbaruar krehjen. Duart e saj delikate e të zbehta nisën të lëviznin me njëfarë nervozizmi, ngaqë, me sa dukej, nuk po e gjente dot modelin e duhur. Një karficë e praruar, rrëzëllimin e zbehtë të së cilës ajo e zhvendosi disa herë sipër flokëve (veç një vetëtimë e parë në ëndërr mund të ishte aq e zbehtë) e lodhi edhe më tepër.

Ndihej menjëherë se atë e lodhi shumë kjo e krehur tepër e gjatë, ngaqë nuk kishte ende përvojë për një gjë të tillë. Ajo ishte dymbëdhjetë vjeçe dhe ishte hera e parë në jetën e saj që po krihej kaq gjatë dhe kaq me kujdes. Veç kësaj, ajo ishte e shtruar prej kohësh në spital, ku porsa kishte mbaruar fazën e parë të kurimit nga leuçemia.

Flokët, që kohë më parë i ishin rralluar e rënë prej sëmundjes, i qenë rritur përsëri, të bukur e të mëndafshhtë, siç i kishte pasur edhe më parë, por nuk ishte ky ngazëllim i rikthimit të tyre shkak për atë krehje aq të kujdesshme në atë buzëmbërme dhjetori. Nuk ishte as ndonjë arsye vajzërore: një pëlqim a pasion për dikë, që sëmundja e gjatë, sidomos prania e afërt e vdekjes, mund t'ia kishin afruar para kohe moshës së saj. Jo, arsyeja ishte tjetër gjë dhe, në dukjen e parë, ngjante e thjeshtë: profesori, që e kuronte prej kohësh, e kishte ftuar atë mbrëmje në shtëpinë e tij.

Qysh se kishte mbërritur në atë kryeqytet të huaj për kurim, ishte herë e parë që një vendës e ftonte në familjen e tij. Dhe ky vendës nuk ishte i zakonshëm, por një nga mjekët më të shquar për kurimin e leuçemisë, jo vetëm në atë vend, por në krejt Europën. Vajza ishte e gëzuar dhe krenare për ftesën, aq më tepër që profesori i kishte thënë se për hir të saj, për hir të pacientes së tij të vogël nga Shqipëria, ai kishte ftuar gjithashtu një numër miqsh të tij.

Bashkë me gëzimin, vajza kishte ndier një lloj ankthi: si do t'u dukej vallë ajo atyre burrave dhe grave kryeqytetase, që qysh tani i përfytyronte të ulur në poltronat e sallonit të madh, duke folur shkujdesshëm si në filma?

Vajza quhej Eglja, por ajo e dinte se për të gjithë ata nuk do të ishte veçse “shqiptarja e vogël”, “die kleine albanerin”. Pikërisht këto fjalë, “kleine albanerin”, i përsëriste me vete, me intonacionet më të ndryshme, ashtu siç i kishte dëgjuar prej profesorit të saj, prej ndihmësve të tij, prej infermiereve e sanitarëve, në të gjitha rastet kur binte fjala për të, gjatë vizitave ose konsultave mjekësore.

Vajza kishte vënë re se këto dy fjalë shkaktonin në sytë e njerëzve njëfarë kureshtjeje. Ata e vështronin një copë herë dhe diçka thoshin për të. Vajza kishte filluar të kuptonte gjermanishten, por edhe sikur të mos e kuptonte, do ta ndiente me intuitë se e folura e tyre s'kishte lidhje me sëmundjen e saj. Prej kohësh ajo e dallonte të folurën për sëmundjen, nga ajo tjetra, e zakonshmja.

- Ajo kupton gjermanisht, - u kujtonin të tjerëve mjeku ose infermierja e saj gjatë konsultave. Pas këtij paralajmërimi ata frenonin të folurën ose e vazhdonin atë me fjalë të tjera nga ato që, kudo në botë, përdoren

zakonisht nga vendësit kur nuk duan të kuptohen prej të huajve. Por edhe kështu, ndonëse ajo nuk e merrte vesh kuptimin e fjalëve, e ndiente fare mirë çqëndronte prapa tyre. Ajo e kuptonte fare mirë se ata thoshin diçka për vendin e saj dhe ajo diçka, sado që të mbulohej me fjalë të rralla ose rajonale, arrinte e qartë në ndërgjegjen e saj.

Prej kohësh vajza e kishte kuptuar se emri i vendit të saj zgjonte te të huajt një kureshtje, e cila ishte e mirë, neutrale ose disa herë e keqe. Pas shqiptimit të fjalëve “kleine albanerin” vinte një çast ngrirjeje, një grimë kohe më e shkurtër ndoshta se sekonda,



kur vajza kthehej e gjitha në vëmendje për të kapur aksionin e përbashkët të blusë së syve, të vijës së buzëve apo një lëvizje të mollëzave të tjetrit, prej të cilit dilte një nga ato tri llojet e kureshtjes, pas së cilës vajza ndihej e gëzuar, boshe ose tejet e pikëlluar.

Ajo e ndiente se ishte tepër e re për të kuptuar thellë arsyet përse mund të duhej, të mos përfilllej ose të mos duhej një vend. Para se ta nisnin për herë të parë jashtë shtetit, një dajë i saj i kishte thënë se vendin e saj e respektonin të gjithë “atje”, ngaqë ishte një vend socialist. Por një ditë tjetër, po ai i kishte thënë se pikërisht ngaqë ishte socialist, vendin e saj nuk mund ta donin atje.

Prej kohësh vajza ishte lodhur nga pyetja “përse”. Por, në qoftë se ajo e kishte vështirë të kapte arsyet e vërteta të dashjes ose të mosdashjes së vendit të saj, çdo ditë e më tepër po bindej se njëfarë roli për këtë, njëfarë shtytjeje të parë për të përcaktuar qëndrimin (një shtytje e lehtë, vendimtare në çastin e shkurtër të ngrirjes, kur ndjenja e mirë dhe e keqe, mirëkuptimi dhe keqkuptimi ishin në mëdyshje) luante ajo vetë, domethënë pamja e saj. Vajza ishte e bindur se, për të mbërritur te vendi i saj, detyrimisht njerëzit do të kalonin nëpërmjet gjymtyrëve të saj, nëpërmjet syve, flokëve dhe karficës që rrëzëllente sipër tyre.

Qysh se e kishte ndier këtë, vajza përpiquej të dukej sa më e bukur. Ajo filloi të qëndronte përpara pasqyrës, të zgjidhte me kujdes veshjen dhe të pyeste infermierën se cili model i flokëve i shkonte më tepër.

Në qoftë se muajt e fundit ajo e kishte bërë këtë çdo ditë (çdo ditë në atë zinxhir ditësh të trishtueshme, monotone spitali), merrej me mend se sa me përkushtim vajza nisi të krihej në atë pasdite dhjetori aq me përkushtim, saqë kur profesori erdhi më në fund për ta marrë, ajo ishte po aq e zbehtë sa karfica e saj.

Ajo e ndjeu shqetësimin e profesorit dhe, e mënjeluar pak, dëgjoi shpjegimet që po i jepte atij infermierja. Ajo kuptoi fjalët “u kreh shumë gjatë”, “deshi të bëhej sa më e bukur”, pas të cilave profesori për ta qetësuar e puthi në ballë në mënyrë të lehtë, fare të lehtë, që asaj i kujtoi, kushedi pse, një pikturë që e kishte parë në një kishë ose në një muze dhe që quhej “puthja e vdekjes”.

II

Varri i vajzës ndodhet në varrezën perëndimore të Tiranës. Afër tij, krahas varreve me mbishkrime të thjeshta, ka mjaft të tjera mbishkrime prej bronzi ose mermeri, të cilat i sjellin ndër mend vizitorit meritat e ndryshme ose shërbimet që i kanë sjellë shtetit, ata që tani pushojnë nën tokë. Personalitete të shkencës e të kulturës, heronj të punës, zyrtarë që kanë shërbyer në sektorë të ndryshëm: ekonomi, ushtri, diplomaci etj., aviatorë të vrarë në detyrë, ministra që kanë përfaqësuar shtetin në forume ndërkombëtare etj., etj.

Kuptohet që mbi mermerin e varrit të vajzës nuk ka asgjë të tillë. Megjithatë, ndonëse kjo mund të duket në kundërshtim me arsyen, njeriu që shkon përmbri atij varri dhe që rastësisht e di historinë e saj (historinë e saj të thjeshtë, të lëmuar, delikate, si syprina e mermerit), padashur, në analogji me varret e tjera, mund të kërkojë me vete diçka të ngjashme. Dhe mbishkrimi i kërkuar nuk mund të ishte tjetër veçse një tekst i tillë, një tekst i shkurtër, ku të thuhej se në këtë varr pushon një vajzë dymbëdhjetëvjeçare, e cila, ndryshe nga të tjerët, nuk arriti të bënte gjë tjetër për vendin e saj, që nuk arriti vërtet të bënte diçka tjetër për vendin e saj, veçse të krihej një pasdite shumë bukur, të krihej bukur dhe gjatë, pafundësisht, një pasdite të zymtë dhjetori, në kohën që kullat e pallateve e të katedraleve të qytetit të madh paralajmëronin afrimin e muzgut.

19 qershor 1988

UBLA E PRINCESHËS

Fragment romani nga Mehmet Kraja

I

Para se të binte mbrëmja, tej Qafës së Ljares qielli u duk i kthjellët dhe i largët, edhe mbi liqen ishte po ai qiell, vetëm se atje ngjante disi i ngrirë dhe i ftohtë, si i veshur me akull, teksa pak më vonë, se nga dolën ca re të holla dhe e mbuluan me vransim lindjen dhe perëndimin, u duk sikur stinët u ndërruan përnjëherësh dhe papritmas u bë vjeshtë, disa çaste më vonë retë u dendësuan, u bënë të turbullta dhe më të errëta dhe po nga ajo anë doli një natë e ngrysur, e cila nga dita e shkuar mori vetëm përzierjen e reve dhe ca hije të tejdukshme, qielli mbi liqen së pari u zhduk dhe në vend të tij, nga fundi i errët, doli një turbullirë vjeshtore, u ngjit përpjetë dhe u përzije me natën, liqenin e përpiu errësira dhe befaz u zhduk. Nata dhe qielli morën ujanën e turbullt dhe filluan të hidhnin rrëke e shtrëngatë mbi male dhe shkëmbinj, mbi rrugina dhe monopate, mbi shkurre dhe lisa.

Përnjëherësh u bë vjeshtë dhe nata e parë e asaj stine solli mbi katundet e Krajës së Epërme shi e fërtymë.

Kur dolën në një qafë mali dhe prapa lanë një pjesë të asaj nate vjeshtore, të pesë vetat, që kishin shaluar pesë mushka të zeza, u ndalën dhe u mblodhën kokë më kokë dhe seç i thanë njëri-tjetrit, nëpër atë fishkëllimë ere dhe nëpër atë shtrëngatë nuk mund të dëgjohej se çfarë thoshin dhe dukej se as ata nuk merreshin vesh mes veti, dikur nisën të thërrasin me zëra të fortë, përsëri nuk u dëgjua asgjë, përveç shtrëngatës dhe erës, njëri syresh tregoi me dorë një monopate të ngushtë, që zhdukej në natë dy-tre hapa më tej. Nga ajo anë u nis kalorësi i parë dhe u zhduk në errësirë, edhe katër të tjerët u zhdukën pas tij dhe, kur vetëtimat ndriti qiell e tokë, të pesë vetat që kishin shaluar pesë mushka të zeza u dukën edhe një herë. Pastaj humbën. Nuk u dukën, as u dëgjuan më.

II

Ishte po ajo natë dhe po ajo vjeshtë, e cila e mbuloi katundin tonë me erë dhe shtrëngatë, me vetëtimat që shqyenin qiellin në një mijë vende dhe që andej rridhnin rrëke të panumërta. Tre veta atëbotë ishin struktur nën strehën e Kishës së Shna Ndout dhe me sy të ngrirë shikonin natën e përzier me shi dhe vetëtimat.

A po ndini ju çka ndiej ù, tha njëri prej tyre, ai ra përmbys mbi ujë e mbi baltë dhe ia vuri veshin tokës.

Asnjëri nuk iu përgjigj. E ju, a po shihni çka po shoh ù?

I treti, që rrinte midis të dyve, po ashtu i struktur nën strehën e kishës, tha, as po shoh, as po ndiej gja, sytë m'i verbuan këto vetëtimat dhe veshët m'u shurdhuon prej shungullimave e rr'feve.

I pari dëgjonte tri ditë rrugë larg edhe përtej fishkëllimës së erës dhe fërtymës; i dyti shihte tri ditë rrugë larg edhe përtej natës dhe errësirës; ndërsa i treti as shihte e as dëgjonte aq larg, por nga ato që i thoshin dy të tjerët mernte vesh se ç'gjëra bluanin në kokë ata që bënë rrugë aq të largët, për të arritur aty.

Era m'i sjell do zana, tha i pari, që thërrasin nëpër natë, megjithëqë nuk e dinë se kujt i thërrasin, kurse unë, tha i dyti, as vetë nuk e di se çka po shoh, por po shoh një njeri që ka shaluo një mushkë të zezë dhe ecë nëpër natë, pa e dritë se ku po shkon, katër tjerë, që aq shumë duken si ai, i shkojnë mbrapa pa thanë asgja.

Ti ndigjo ma mirë se çka thonë, tha ai që as shihte e as dëgjonte, kurse ti më kallëzo se si duken këta kalorës të panjohun që e paskan humbë rrugën, i pari përsëri u shtri mbi ujë e baltë dhe ia vuri veshin tokës, nuk ndigjoj asgja, tha, vetëm thirrjet e tyne vijnë deri këtu janë aq afër por nuk e di çka thonë, herë m'duken si hije e herë m'duken si njerëz, tha i dyti, janë afër i shoh por nuk e di kush janë.

Eeeh, tha i treti me ankim, çka me ba unë që nuk shoh e as ndigjoj as aq sa shihni e ndigjoni ju por ti që ndijen aq larg m'kallëzo a fryn erë dhe a ban shtrëngatë edhe atje njisoj

si këtu, po, tha ai, thirrjet e tyne përzihen me erën, e ti që sheh aq larg, më thuaj, a bën natë edhe atje njësoj si këtu dhe vetëtimat edhe atje a e çajnë qiellin, po, atëherë ikim, tha ai që as dëgjonte e as shihte sa dy të tjerët, por nga ato që i rrëfenin ata, mernte vesh se çfarë ndodhte në të katër anët e botës, ata e paskan humbë rrugën dhe kërkojnë ndihmë që të shpëtojnë nga kjo natë dhe ne do të jemi të parët me të cilët do të takohen.

Pak çaste më vonë ata nuk ishin më nën strehën e kishës, nuk u panë se nga shkuan dhe ku u futën.

III

Shtrëngata ulëriti tërë natën, ajo ngjante me një të lajthitur, i cili në çastin e marrëzisë zë e çirret dhe bërtet dhe me gishtërinj e me thonj gërvisht fytyrën e vet, fyt e kraharor; e herë tjetër ajo ngjante me egërsirën që hakërrohej dhe donte ta shqyente edhe errësirën, bashkë me të edhe katundin e vogël të struktur në luginë.

Ata që fjetën atë natë, panë ëndërr gjëra të frikshme, e ata që nuk fjetën, panë dhe dëgjuan gjëra edhe më të frikshme, se nga kishte dalë atë natë një si kuçedër dhe hidhte nga mali dhë e gurë dhe donte t'i bënte rrafsh kodra e lugina, ndërsa një drangua, i cili prej kohësh kishte qenë i fjetur aty në rrëzë, qe zgjuar nga ajo batërdisi dhe tani i qe ngjitur shpatit përpjetë dhe atje lart mbi kreshta kishte filluar ajo mundja e tmerrshme, e cila paskësh zgjatur deri kishte rënë mbi dhë drita e parë e mëngjesit. Këtë ëndërr u duk se e panë të gjithë ata që fjetën atë natë, kurse ata që e kishin bërë natën pa asnjë pikë gjumë, thoshin se me sytë e tyre e kishin parë atë mundje dhe krejt qartë i kishin dëgjuar gjëmë e britma.

Më afër rrugës, e cila kalonte pranë katundit, e kishte shtëpinë Mark Junku, e ai as fjeti atë natë dhe as u ndal të dëgjonte zërat e frikshëm të shtrëngatës. Atij iu duk se për një çast, përmes asaj ulërimë, dëgjoji ca thirrje të largëta, që

përsëriteshin kohë më kohë. Ç'zë e ç'njeri mund të ishte ai që thërriste nëpër një natë të këtyllë? Mbajti vesh dhe dëgjoji për një kohë të gjatë, thirrjet nuk u shpeshtuan, por nuk u bënë as më të rralla; nuk u afruan, por nuk u bënë as më të largëta.

Mark Junku u mbështoll me një rrogos dhe bëri të dilte jashtë, por nata e mbushur erë, shi e vetëtimat iu përplas në fytyrë dhe e bëri të mërdhinte, Zot i madh, tha me vete, çfarë nate, u kthye brenda, u shtri dhe po me atë rrogos u mbulua përsëri. Për herë të parë i erdh keq që shtëpinë e kishte afër rrugës, se, nuk thoshin kot, një e tillë shtëpi sy e veshë i ka gjithmonë andej.

Pak më vonë shtrëngata u bë më e fortë dhe zërat nuk u dëgjuan më, Mark Junku përsëri mbajti vesh t'i dëgjonte rrapëllimat e njohura të kalimtarëve, të cilëve u rastiste që këtë rrugë ta bënë edhe natën, por përveç zhurmës së shtrëngatës, nuk dëgjoji gjë tjetër, atëherë u vesh me të shpejtë dhe doli, nuk diti nga t'ia mbante, sepse mund të ndodhte që furtuna ta përplaste diku dhe ai të mos ngrihej më, sepse Mark Junku nuk ishte as i fortë dhe as i ri, siç kishte qenë dikur, vetëm se ai kishte dëgjuar nëpër natë ca zëra, ca si thirrje dhe, meqë ato thirrje edhe nëpër një natë si kjo arrinte t'i dëgjonte, ata që thërritnin nuk mund të ishin aq larg. Eh, sikur Kisha e Shna Ndout të kishte kambanë! Sa e sa herë kishte thënë Mark Junku se kisha pa kambanë ishte si njeriu pa gojë.

Nga këto mendime e ndau po ajo thirrje, që disa çaste më parë i dukej se vinte nga larg, kurse tashti e dëgjoji qartë, në vete disi i erdh mirë që nuk doli i gënjyer në këtë punë, dhe menjëherë, aty në oborr të kishës, iu shfaqën para sysh ca si kalorës a hije kalorësish, që u dukën dhe u zhdukën përsëri, priti që vetëtimat ta ndriste sërish oborrin e kishës, ajo e çau qiellin dhe hodhi mbi dhë një dritë të kaltërreme, po, kalorësit ishin aty, rrinin si të ngrirë dhe Mark Junkut iu duk sikur ata papandehur i mbuloi një flakë e blertë, pastaj u zhdukën sërish. Njëri prej tyre, ai që dukej se kishte zë më të fortë, thirri: O-eee! Asgjë tjetër nuk dëgjoji Mark Junku. Kush jeni ju dhe çka kërkon këtu? Mark Junku thirri me zë të fortë dhe me të folmen e tij të Ljares e Shestanit.

Asnjëri nuk iu përgjigj, tani Mark Junku foli me vete, ç'është kështu, Zot i madh, mos më bëjnë veshët dhe sytë më mashtrojnë, por ai e dinte se kalorësit ishin aty, vetëm se nata për një çast i kishte fshehur nga sytë e tij.

Edhe kur u afrua pranë tyre, edhe kur e zuri për kapistre njëren nga mushkat, dhe e tërhoqi nga oborri i vet, edhe kur u futën në shtëpi dhe kur i pa nga afër fytyrat e tyre dhe i pyeti për të dytën dhe për të tretën herë se kush ishin, ata nuk i thanë asgjë, madje asnjëri prej tyre nuk e hapi gojën të thoshte diçka, njëri seç kishte një plagë në këmbë dhe herë pas here rënkonte mbyturazi, por këtë e bënte disi fshehtas, duke shtrënguar dhëmbët, që t'i dilte zëri sa më i dobët, ndërsa Mark Junku pa se në sytë e të gjithëve ende bënte natë, një natë e frikshme, e mbushur vetëtimat dhe shtrëngatë.

Kur u futën në oborrin e tij, Mark Junku pa se ishin pesë, se që të pestët mbanin pelerina të zeza, e edhe mushkat e tyre ishin gjithashtu të zeza.



IV

Dita e nesërme u duk se erdh më vonë se rëndom, toka ngjante e lodhur, tani shtrihej si e alivanosur dhe merrte frymë me zor, mbi kreshtat e maleve retë ende rrinin pezull, e shikonin me mëri katundin e strukur përposh shpateve të zhveshur, gjurmët e asaj mundjes së frikshme, e cila kishte zgjatur tërë natën midis kuçedrës dhe dragoit dukeshin gjithkund, përrrenjtë dhe rrëketë kishin prerë kryq e tërthor çdo rrugicë e çdo shteg dhe ngjanin me ca gërvishtje të thella, që ende e bënin tokën të rënkonte. Vetëm ca gjurmë mushkash, të cilat kishin kaluar nga oborri i kishës dhe ishin futur te konaku i Mark Junkut, nuk kishin arritur t’i fshinin plotësisht rrëketë e fundit të shtrëngatës.

Meqë mua më pëlqenin siç tregoheshin rrëfimet në anët tona, atëherë një rrëfim i tillë do të sajohet afërsisht kështu: Kalorësit që u futën në konakun e Mark Junkut nuk i pa askush, por hijet e tyre së pari i panë zogjtë e malit, të cilët se ku e kishin kaluar mbrëmë natën dhe tani gjithandej degëve të pyllit aty afër shpupurisinin pendlat e tyre të ngjyrshme, zogjtë e malit cicëronin dhe cicërimën e tyre e dëgjo i era e lehtë e mëngjesit, e cila ende frynte pas shtrëngatës së mbrëmshme, dhe ajo erë e lehtë e mëngjesit pëshpëriti dhe pëshpëritja e saj iku tejanës (kështu do të rrëfehej në anët tona), dhe kur u duk se nuk do të kthehej më, u dëgjua sërish të fëshfërinte dhe po me atë fëshfëritje të erës u dha lajmi se në shtëpinë e Mark Junkut mbrëmë natën, nëpër shtrëngatë e nëpër fërtymë, ishin futur pesë veta, se ata njerëz nuk ishin futur fshehurazi, por as nuk dolën që t’i shihte dikush, ndërkohë që pëshpëritja e erës arriti deri te veshët e Dardhojmelit, i cili, posa dëgjo i sa thuhej për ndodhinë e mbrëmshme, u vesh e u ngjesh, mbërtheu shpatën dhe vuri parzmoren dhe u nis rrugës që çonte në lindje të katundit, atje ku ishte Kisha e Shna Ndout dhe afër saj konaku i Mark Junkut.

Tani dihet se rrugës Dardhojmeli trokiti edhe në dy shtëpi të tjera dhe, kur u bë vetë i tretë, u afrua te oborri i kullës së Junkajve dhe që andej thirri me zë të fortë e të rëndë: (Dardhojmeli foli me Mark Junkun ashtu siç këndohet në këngët për të, me një ‘u’ të rëndë e të thellë, si gropë që shkon deri në fund të tokës, ashtu siç flitet edhe sot në Brisk, Ljare e Shestan, ndërsa unë e kam parë të arsyeshme që këtë të folme ta ndryshoj pak, ta zbres nga malet, ta çoj deri afër Shkodrës, për aq sa rrëfimi të mos mbetet matanë mjegullës së dendur të kohëve të shkuara.)

Pra, Dardhojmeli thirri me një zë të fortë e të rëndë, o Mark Junku, dil o burrë se e kemi një fjalë me ty!

Por Mark Junku nuk doli dhe nga konaku nuk u dëgjua ndonjë zë, edhe kulla heshte, dhe dukej si e braktisur, sikur nuk kishte brenda asnjë frymë njeriu.

Atëherë Dardhojmeli thirri për herë të dytë dhe po ato fjalë i tha me zë të fortë dhe të rëndë, dhe atëherë, pikërisht atëherë, iu duk se dera që nxirrte në hajat u hap për një çast, se atje pa një shtat të hedhur vajze, po, po, kështu pëlqehet të rrëfeket te ne, asaj vajzës Dardhojmeli ia pa edhe balluket si krah dallëndysheje dhe një “tring!” i kërciti në kraharor!

Duan të thonë se Dardhojmeli, edhe pas asaj që pa, nuk e bëri veten, por thirri për të tretën herë, dhe tha: A isht dikush i gjallë kët vend e, nëse nuk isht, a gjindet dikush që na thotë se ç’mordje ishte ajo që paska ra dhe të gjithë i paska farue deri në një!

Fjalë të randa po thua more djalë, ia bëri Mark Junku me të dalë nën strehë.

Dardhojmeli e ndjeu veten ngushtë, sepse nuk priti as kësaj here të dilte njeri dhe t’i përgjigjej thirrjes së tij, dhe, pasi u përmbi me zor, i foli Mark Junkut, se ç’ma kapi veshi, o Mark Junku, se në konak mbajte njerëz të panjohur dhe se ua hape zemrën njësoj siç ua hape derën, Mark Junku iu përgjigj, do fjalë i ke ndigjuo mirë, o djalë, por do nuk t’i paska kapë veshi si duhet! Kush ishin ata, pyeti Dardhojmeli, ti e di mirë, o Mark Junku, se Prijësi mua më ka ngarkuo këtë detyrë të randë, që me dijtë e me mësuo se kush vjen e kush del nga tokat tona.

Mark Junku tani u bë i rëndë nga çehrja dhe nga fjalët, i thuaj Prijësit kur të piqesh me të, tha ai, se Mark Junku nuk tradhtoi dhe nuk i shkeli rregullat e tij.

Dardhojmeli përsëri e ndjeu veten ngushtë dhe e pa se që në fillim ishte ngutur, pastaj, seç ishte ajo figurë vajze që iu shfaq përsëri dhe sërish bëri që t’i sëmbohte në kraharor, mirë, mirë, tha Dardhojmeli me zë më të butë, po cilët janë këta që mbramë kërkuan konak dhe e gjetën konakun në kullën tande?

Mark Junku nuk u zbut as nga zëri as nga fjalët e Dardhojmelit, e kush pra, tha, nuk i njoh dhe nuk ua di emnat, nata i gjeti në rrugë dhe shtrëngata bani ta humbin atë, si të pushojnë pak dhe ta marrin veten prapë, kam me i nxjerrë në rrugë dhe me iu thanë udha e mbarë.

Dardhojmeli uli kokën dhe, duke murmuritur diçka me vete, doli nga oborri i konakut të Mark Junkut, prapa i shkonin të heshtur dy shokët e tij, të veshur e të mbathur njësoj si ai, vetëm që ata, në vend të shpatave, në brez mbanin nga një këllëç të shkurtër.

Fragment nga romani "Sëmundja e ëndrrave", 2020

KUR NUK DO TË JEM

poezi nga Zuvdija Hoxhiq

Përktheu nga origjinali Dimitrov Popoviq

FEDERIKO GARSIA LORKES

Në këtë kohë pa shpresë veshur në të zeza
Edhe unë zemrën në vend t’qiririt ndeza.

Dhe si ty të mirit në pyllin e Granadës
më sillen rreth kokës gjatë kësaj nate.

Plot shqetësim dhe me klithje do të më tretin
Mjerë për ty, o botë, çdo të bësh pa poetin.

MERMERI

Ja këtu pushoj unë
Që në tri beteja kam shkuar
Por nuk kam nxënë
Në emër të kujt kam luftuar
Në emër të kujt kam rënë.

KUR NUK DO TË JEM

Kur nuk do të jem
Atë fotografinë time të rinisë
Në të cilën ngajmë si të ishim binjakë
Djali do ta rrisë, do e futë në kornizë dhe do ta vendosë
Në vendin ku do ta shikojnë të gjithë.
Do ta lëvizin kur të lyejnë shtëpinë
Dhe të ndërrojnë vendin e fotografive.
Një natë do t’i thotë gruas:
Mendo, e vogla ka pyetur se ku është fotografia e gjyshit.
Është mirë që e kemi hequr
A e di se sa ka qarë ajo atëherë
E ka dashur shumë.
Nesër do t’i blejë një plejër
Me të do të dëfrehet.

Kur nuk do të jem
Në fjalën përsëritëse në takimet letrare të Plavës
Kryetari i Këshillit do të përmendë dhe emrin tim
Poezitë do t’i kem
Në përmbledhjen e poetëve të vendlindjes
Të botuar me rastin e jubileut.
Në emisionin “Ka ndodhur në ditën e sotme”,
Në prag të lajmeve në TV
Do të shkruhet se në atë ditë, para dhjetë vitesh
Ndërroi jetë Zuvdija Hoxhiq,
Poet, publicist, shkrimtar.

Kur nuk do të jem
Ndonjë nxënës nga Shkolla fillore “Xhafer Nikoçeviq”
Në Leximin letrar të klasës së gjashtë
Poshtë fragmentit nga libri “Dikush thërret”
Do të lexojë shënimin për shkrimtarin
I çuditur se është lindur në Guci
Do ta lexojë përsëri
I kënaqur ashtu si unë
Kur në librin e gjeografisë të tim vëllai
Kam lexuar se Vruja është lumi më i ftohtë në Jugosllavi.

VDEKJA E SIZIFIT

Me ngulm duke kënduar gurin shtyn
Turpshëm duke rënë nën atë peshë
Si të mbante fjalë. N’sa shtërgata shfryn
Stoliset me pikëllim si me lule veshë.

Mbeti ai gur në majë i shtrirë
Dhe Sizifi s’di ç’të bëjë më
I vetëm, ndërsa liria rjep si egërsirë
Kobi shkruhet, kur egërsira të zë.

Koka e vet punon për veten e tij
Mendimi që u thur - habiti poezinë
Si komandant i bindur në vendimin e drejtë

Se është më mirë të humbësh betejën
Vetë e shtyu gurin teposhtë në pjerrtësi
Duke e rrokullisë në vjershë më vështir’ se n’lartësi.

BIJA IME

Bija ime
Anëtare e klubit të hipizmit “Perjanik”
Si luftëtar hun, si ullan polak
Si korier tartar, si kusar hungarez
Si Apash, si beduin
Si ledi angleze
Si mbesë e Sheqos
Kalëron mbi kuaj me qime të verdha, allatë, doratë
Laramanë, të zinj, izabelë, të hirtë,
Ahaltekinë, anglezë, hungarezë,
Arabë, boshnjako-malorë
Më bindin se ata më shumë duan
Kur ajo është hipur mbi ta
Ajo me çdonjërin në gjuhën e tyre bisedon
Bija ime nuk thotë: Do të të lind një nip
Bija ime thotë: Do ta kesh Pegazin me krahë
Që kur të vijnë ato mizat e tua
Të mundesh të fluturosh në Guci
Dhe të kthehesh në gjendje normale.

BALADË PËR NE

*Kemi gjetur atë lëkurën e dashit të artë
dhe që pafatsia të ish më e madhe: ishte e bukur.*

Nga bashka e artë asgjë - ky fat na ka përcjellur
Nga vargmalet tek sirenat koha na ka hedhur,
Pagjumësia e bardhë nëpër fytyrë na ka kulluar,
Atëherë zogu nga kënga, si nga kafazi është larguar,
Dhe shenj i keq: në mesditë ra muzgu i murrmë,
Ja ku bashkës së dashit t’ artë i ramë në gjurmë.

Rojat të ndryshkur nga vetmia shkuan në kërkim
Duke udhëtuar rrugën harrojnë. Me ne në takim
Qartë duke shënuar rrugën që çon te bashka e artë
Kështu të gënjyer u humbëm si në një shtërgatë
Duke e kërkuar humbëm qetësinë dhe të dashurën Itakë,
U endëm kudo nëpër botë, ndërsa e kishim në prag.

NISJA

Çdo ditë ne jemi gjithnjë e më pak
Na ha Dielli, gurishtja dhe besimi.
Lëvizin nga rëra eshtra dhe kafkë
Në rrugën tonë drejt qytetit dhe qëllimit.

Ngjitemi kodrave, horizontet ngushtohen
Ndonëse të fortë nuk di a do të durojmë?
Mos vallë është qyteti sa më larg që ecim
A thua do ta gjejmë dhe a do ta dallojmë?

Vendqëndrimi ynë u shfaq më në fund
Në pejzazhin e imët. Po gjë nuk po shohim:
Tek porta jemi, ndërsa roja kurkund
S’na lejon ne, dhe pse kodin ja njohim.

JASHTË MASE

Tregim nga Hiromi Kawakami

Përktheu nga anglishtja Aristidh Shqevi

Unë isha 'i dashuri' i Mjau-t. Nishino ishte 'miku i mirë' i saj.

Nishino dhe unë grindeshim shpesh por edhe vinim buzën në gaz për fjalët e ndryshme që përdornim. Çdo gjë ama kishte kuptim. Mjau është një mace me një mozaik ngjyrash, e zezë, kafe, ngjyrë portokalli dhe e bardhë. Ajo është e imët, me trup elastik, dhe e qetë.

Një ditë vere ajo u shfaq në verandën time.

Isha duke i bërë fresk vetes me një freskore ndërkohë që veshin e mbaja tek radio. Me volumin e ulur po dëgjoja radiostacionin ushtarak amerikan FEN. Luhej një këngë që para njëzetë vitesh kishte pasur një sukses të madh – kur unë kisha qenë në moshën njëzetë vjeçare. Dëgjoja dhe këndoja njëkohësisht tek freskoja veten nën ritmin e muzikës.

Për një çast m'u bë sikur pashë diçka me bishtin e syrit. Pa lëvizur nga vendi, hodha vështrimin përmes rrjetës që kisha vendosur për t'u mbrojtur nga mizat dhe vura re se aty ndodhej një mace. Ajo vinte rrotull në verandë pa u nxituar dhe më pas pushoi mbi makinën larëse të rrobave. Unë vështrova macen, por edhe ajo m'i nguli sytë.

E lashë freskoren dhe thërrita, 'Mjau.' Macja nuk mjaulliti. E provova edhe një herë tjetër. Këtë radhë u dëgjua një mjaullimë. Ajo tingëlloi më shumë si një 'Mjau'.

Lëvizja perden e rrjetës nga dera. Menjëherë macja ngriti sytë në drejtimin tim, por nuk u largua. 'Ke uri?' e pyeta unë. Macja mjaulliu përsëri. U futa në hyrjen time dhe u ktheva me bërthamën e një pjeshke të vendosur në një pjatë, të cilën e ula përtokë. Macja u hodh me elegancë nga makina larëse, dhe nisi ta lëpijë tulin e frutës që kishte mbetur rreth bërthamës. Mënyra se si ajo e lëvizte gjuhëzën përreth bërthamës së pjeshkës ishte zbavitëse. Bërthama mbi pjatë u duk fillimisht e vogël, por tani, duke e krahasuar me fytyrën e maces mbi pjatë, ajo të linte përshtypjen se ishte shumë më e madhe.

Pas njëfarë kohe, macja kërceu sërish mbi makinën larëse dhe që andej u hodh me hov mbi parmakun e verandës. Më pas përfundoi në dysheme. Në çastin që putrat e saj prekën dyshtemenë u dëgjua një tingull i mbytur, a thua se një pikë ujë kishte rënë në tokë.

'Mjau,' thirra unë. Macja ktheu kokën.

Pjata që ende kishte mbetur në verandë kishte filluar të mbushej me milingona. Mora një letër fshirëse dhe mbështolla me të bërthamën e pjeshkës. U futa sërish në apartament dhe hodha në koshin e plehrave bërthamën dhe letrën fshirëse me të cilën e kisha mbështjellë.

'Që këtej e tutje do të thërras Mjau, në rregull?' i thashë me zë të ulët maces, e cila tashmë ishte larguar. Lajmet në radio po lexoheshin me një ritëm të shpejtë. Zukatja e gjinkallave jehonte nëpër pemët e parkut që shtrihej para syve të mi.

'Mjau,' u përpoqa të bëja sërish me tonin e zërit lehtëzi më të lartë. Kështu tingëllonte më bukur.

'Mjau,' thirra edhe njëherë tjetër. Pa vonesë mora drejtimin drejt banjës për të bërë një dush.

*

Shfaqjet e Maju-t në apartamentin tim ndodhën përafërsisht në të njëjtën periudhë që zhvillova bisedat e mia të para me Nishino-n. Ai jetonte në apartamentin ngjitur me atë ku banoja unë. Që të dy ishim futur në apartamentet e reja menjëherë sapo blloku kishte përfunduar së ndërtuari, ndaj dhe kishim pesë vite që ishim komshinj. E vërteta është se bisedat tona u bënë më të shpeshta vetëm pasi Mjau kishte filluar të më bënte vizita. Deri në atë periudhë, edhe në rastet kur e hasnim njeri tjetrin në korridor, ne thjesht përshëndeteshim



me kokë dhe përpiqeshim t'i shmangeshim kontaktit me sy.

Dëgjova zërin e Nishino-s të më thërrasë pikërisht në momentin kur po përgatitesha t'i nxirrja Mjau-t pak mish kalë deti në verandë.

Kisha vendosur që ushqimin ta vendosja në një pjatë të rëndë ngjyrë kafe. E kisha blerë atë para pak kohësh, në një moment trilli të beftë, në një dyqan të vjetër antikash që ndodhej në segmentin rrugor midis apartamentit tim dhe stacionit të trenit. Dyqani ishte i mbushur me tase, filxhanë çaji si edhe filxhanë për të pirë *saké*. Pjata kishte për zbukurim dy a tre krapa që vinin rrotull buzës së një lumi. Ai ishte vërtet një dyqan antikash, por meqenëse pjata kishte një ciflosje, ajo nuk kishte kushtuar dhe aq shumë. Pjatën e kisha larë mirë (brenda në dyqan kishte pak pluhur) dhe disa herë e kisha nxjerrë në verandë me sardele të tymosura.

'Është vërtet një pjatë që ta bën me sy,' tha Nishino duke ngritur shikim lart drejt meje që qëndroja ulur në verandë pak më sipër se niveli i tokës.

'Po,' u përgjigja unë. Shikimi im në atë çast duhet të ketë qenë skeptik.

'E gjitha kjo është për macen?' vazhdoi Nishino, i cili me sa dukej, nuk e kishte vënë re shikimin tim.

'Po,' vendosa të them. 'Është për Mjau-n, jo për çdo lloj mace.' Sidoqoftë, dëshira për mos ta treguar menjëherë emrin e Mjau-t, kishte mbizotëruar.

Nishino nuk luajti nga vendi; ai thjesht qëndroi aty duke mbajtur shikimin lart. Pjatën që mbaja në dorë e ula përtokë në dyshtemenë e verandës. Fytyra e Nishino-s, e ngritur lart, kishte ngjashmëri me atë të Mjau-t. Shprehja e fytyrës së tij kishte diçka të egër, por edhe delikate. Nishino me siguri duhej t'i kishte kaluar të tridhjetat, megjithatë tek ai shihje diçka rinore.

Mjau mbërriti aty pa vonesë duke lëshuar një mjaullimë të denjë për emrin e saj. Me shumë kënaqësi, ajo e konsumoi të gjithë mishin e kalit të detit. Tek vështroja Mjau-n, Nishino-n e harrova krejtësisht. Me ta lëpirë të gjithë pjatën, Mjau u hodh mbi parmakët dhe më pas u lëshua plluk në rrugë.

'Mjau,' thirri Nishino; ajo u mblodh kruspull pranë tij. Duke i mbyllur sytë jo plotësisht dhe duke nxjerrë kerrmëza, ajo e la veten të lirë që ai ta ledhatonte.

'Është mace miqësore,' tha Nishino tek e përkëdheli atë.

'Është me të vërtetë e tillë,' u përgjigja unë duke u shtirë si e qetë pavarësisht se në brendësi isha e nevrësuar. Përse duhet ajo të nxjerrë kerrmëza për një tip si ai?

'Mbase dhe unë duhet të përpiqem që ta ushqej atë,' tha Nishino me të njëjtën ngrohtësi që karakterizonte vetë Mjau-n.

Unë buzëqesha disi, por përgjigje nuk dhashë. Menjëherë mora pjatën dhe nxitova drejt apartamentit tim. Nishino kishte ngritur kokën lart sikur të donte të thoshte diçka, ndërkohë që unë mbylla me forcë derën e xhamtë.

'Pata përshtypjen se deri diku u trembe,' ma rikujtoi ndodhinë më vonë Nishino. Në atë periudhë unë përjetoja një farë ndjenje frike. Gjithsesi nuk mund ta dija se, dy muaj më vonë, në një farë mënyre do të bëhesha e dashura e tij.

*

Nishino u fut pa zhurmë në apartamentin tim të njëjtën ditë që Mjau u shfaq në verandë.

Ai ndofta nuk klithi me të madhe 'Mjau,' por zemrën ma rrëmbeu po me aq ëmbëlsi sa edhe ajo. M'u desh që derën ta lë vetëm gjysmë të hapur dhe t'i bëj shenjë atij të futej brenda – në fillim me kikirikë dhe biskota të thata në vend të bërthamës së pjeshkës – dhe pa kaluar gjatë, e mirëprita

atë vetë me një pjatë dhe tas në dorë.

‘Çdo ditë vjen macja këtu?’ më pyeti Nishino.

‘Ajo nuk është “Macja”, ajo është Mjau,’ e korrigjova unë, gjë që e bëri atë të qeshë.

‘Ka kohë që e thërras Princ Mjau.’

‘Më dëgjo, është femër, dhe emri Mjau i përshtatet më shumë se çdo gjë tjetër.’

Ndërkohë që unë thashë këtë, Nishino më dhuroi një puthje të lehtë. Menjëherë pas kësaj, ai mori pjatën e rëndë të Mjau-t, e cila ndodhej poshtë tavolinës së vogël.

‘Pjatën e kam blerë shumë lirë.’

‘Për mua, t’i ofrosh një pjatë të tillë Mjau-t, është një shpenzim i tepërt.’

‘Mbi të gjitha, Mjau është e dashura ime.’

‘Vërtet? Mjau është e dashura jote?’ Nishino ia dha një të qeshure. ‘Atëherë, po unë kush jam, Eriko?’

‘Ma do mendja, një mik i mirë.’

Nishino qeshi, më puthi sërish, por këtë herë më fort se radhën e parë.

‘Kështu veprojnë shokët e mirë?’ pyeti Nishino me një zë të butë.

‘Natyrisht,’ u përgjigja unë duke zbardhur dhëmbët.

‘Mjau është me të vërtetë numri një për ty,’ tha Nishino duke shprehur kështu njëfarë pakënaqësie, edhe pse sytë i shndritën.

‘Mjau është ajo çka është më e mira për mua, siç jam edhe unë për të.’

‘Po mirë, atëherë kjo do të thotë se unë jam thjesht një shok i mirë për ty – dhe jo vetëm për ty, Eriko, por dhe për Mjau-n gjithashtu.’

Nishino lëshoi një psherëtimë të thellë. Në vijim, ai mbuloi fytyrën me të dyja duart dhe bëri sikur filloi të qante me gulçimë.

‘Oh, mos u dëshpëro kaq shumë,’ thashë unë. Nishino po më shikonte përmes gishtërinjve të dorës, dhe një çast më pas, ai shpërtheu në një të qeshur të madhe. Unë qesha së bashku me të.

‘Je me të vërtetë fantastike, Eriko,’ tha Nishino me tonin e zërit të ngritur shumë lart duke më përqafuar. Pastaj ai lëshoi trupin e tij të lirë mbi trupin tim në qilim dhe më puthi me shumë ndjenjë.

Pjata ngjyrë kafe e Mjau-t ishte sipër kokës sime, ndaj sa herë që shtrija dorën, tek e prekja atë, dëgjohej një trokëllimë. Kisha filluar të bija në dashuri me Nishino-n. Në çdo çast isha e gatshme të bija në dashuri me të. Gjithsesi nuk kishte sesi ta doja Nishino-n. Në mënyrë absolute refuzoja ta dashuroja atë. Vendimin për këtë e kisha marrë.

Me martesën kisha dështuar një herë. Im shoq dhe unë duheshim shumë me njeri tjetrin. Për fat të keq gjithçka u shemb. Faji nuk ishte i tim shoqi; por as i imi nuk ishte. Ne thjesht arritëm ta kuptonim se nuk shtyhej më. Një ditë. Fare papritur.

Nuk është se e kam humbur besimin, por që atëherë, ndoshta, jam më e kujdesshme, në mendime kridhem më shumë. Kur fjala është për dashurinë, vigjilenca dhe zhytja në mendime të çojnë gjithmonë drejt ngurrimit.

‘Eriko, përse nuk mund të jem unë i dashuri yt? Nishino më pyeste vazhdimisht. Si një fëmijë i llastuar. Një djalë i prapë tridhjetë e pesë vjeçar. Veç të tjerave ishte dhe pesë vite më i ri se unë.

‘Sepse nuk mund ta marr përgjegjësinë për ty,’ u përgjigja duke ia ledhatuar fytyrën Nishino-s.

‘Nuk e kuptoj përse sillesh kaq arrogante me mua,’ tha Nishino me indinjatë.

‘Arrogante?’

‘Ta mendosh se mund ta marrësh përgjegjësinë për një person tjetër është sjellje arrogante. Pra, do të thotë, ta mbash tjetrin nën tutelë.

‘Të kuptoj mirë.’ Pohova me kokë. Ndërkohë që unë vazhdoja të pohoja me kokë, ai indinjohej gjithnjë e më shumë.

‘Nuk kërkoj të më adhurosh – unë dua që ti të jesh e dashura ime!’ Kishte një zemëratë në tonin e zërit të Nishino-s, dhe megjithatë, atij ende i shndritnin sytë.

Nëse Nishino ndjente njëfarë afërsie ndaj meje, kjo ndofta vinte ngaqë unë e trajtoja atë me gjakftohtësi. Nuk kisha as më të voglin dyshim se në momentin që nuk do ta trajtoja më në atë mënyrë, ai do të ikte me vrap. Gjithsesi qëndrimin tim nuk do ta ndryshoja. Nishino dhe unë ishim njerëz të gatuar nga i njëjti brumë. Ky ishte përfundimi im pasi i shqyrtova rrethanat me shumë kujdes.

‘Shikoj diçka tepër të sinqertë tek Mjau,’ thashë unë; Nishino uli kokën i zhgënjyer.

‘Mos do të thuash se ke më shumë besim te një mace e rastit sesa te unë?’

‘Deri diku, mund ta interpretosh edhe kështu.’

‘Me të vërtetë më nënvleftëson kaq shumë?’

Nishino ta linte përshtypjen se ishte mishërimi i njeriut mendjelehtë. Mbas orës dhjetë të natës, zilja e telefonit binte disa herë. Gjithmonë do e thërriste një grua. Me secilën prej

tyre ai tregohej i dashur dhe i sjellshëm. Kur Nishino filloi të vinte në shtëpinë time, i kërkova që celularin ta mbante të fikur. Përgjigja e tij nuk ndryshonte kurrë.

‘Celularin do ta mbaj të fikur në çastin që do të ma lejosh të bëhem i dashuri yt.’

‘Ka diçka që nuk shkon tek ty Nishino,’ thashë unë.

Nishino pohoi me kokë, ndërsa fytyra i mori një pamje të rëndë. ‘Unë e di këtë më mirë se kushdo tjetër. Po, ka diçka që nuk shkon tek unë.’

Tek tha këtë Nishino u duk tepër serioz, ndonëse gjithmonë tek ai vije re diçka përqeshëse.

‘Në rregull atëherë, që këtej e tutje ti duhet të bësh një jetë të ndershme, pa dredhi,’ thashë unë.

Nishino ngriti kokën në drejtimin tim dhe psherëtiu.

‘Druhem ta ndërmarr hapin e parë.’

‘Çfarë të tremb vallë?’

‘E di çfarë, kam frikë se do të përfundoj me një jetë të drejtë e të moralshme.’

‘Po më thua se do ta urreje një jetë të tillë?’

‘Nuk është se do ta urreja – problemi është se do të kisha frikë prej saj.’

‘Fjalët nga goja e tij dolën me shpejtësi. Më pas ai mbështeti kokën mbi gjoksin tim dhe për disa çaste vazhdoi të qëndrojë i heshtur.

‘Gjoksi i femrave më tërheq,’ thoshte shpesh Nishino.

Zilja e celularit të tij ra përsëri, por ai nuk u përgjigj.

‘Mos duhet të përgjigjesh?’ pyeta unë.

‘Jo, nuk kam dëshirë,’ tha ai. ‘E kam seriozisht, ti më kupton.’

Më pas ai shtoi, ‘Po tregohesh e keqe, Eriko,’ Koka e tij vazhdonte të mbështetej mbi gjoksin tim. Po vështroja plogët pjatën e Mjau-t. Isha në prag të të rënit në dashuri me Nishino-n, por vetes i thashë se atë nuk mund ta doja. Për një çast mendova se fjala ‘dashuri’ ishte shumë e çuditshme. Ajo ishte njësoj si pjesa e brendshme e dyqanit të anitikave ku kisha blerë pjatën e Mjau-t. Tejet i heshtur dhe mbuluar nga pluhuri. Kujtime të dikurshme që mblidhen në një lëmsh. Disi nostalgjike dhe të trishtueshme.

Me kokën që ende i pushonte në gjoksin tim, Nishino qëndronte i heshtur dhe me sy të mbyllur.

‘Po shpërngulem,’ tha Nishino.’

‘Vërtet?’ pyeta unë. Zëri im ishte i qetë.

‘Eriko, përse nuk martohesh me mua?’ Tek bëri këtë pyetje, ai pozicionoi trupin shtrembër me qëllim që ta shmangte vështtrimin tim.

Unë qesha nën hundë, por veç kësaj nuk dhashë asnjë përgjigje tjetër.

Nishino më hodhi një vështrim me ngulm, por ama nuk guxoi të më shikonte në bebe të syrit. Mjau kishte lënë copëza sardelesh të pjekura në skarë mbi pjatë. Në vend që të më shikonte mua, ai ia nguli sytë sardeleve.

‘Do t’i provosh pak sardelet?’ pyeta unë.

‘Po,’ u përgjigj Nishino me zë të ulët. ‘Sa mirë do të ishte sikur të kisha qenë Mjau. Ti do të më ushqeje me sardele dhe skumbri çdo ditë.

Toni i zërit të tij ishte hokatar, ndaj dhe unë qesha. Një çast më vonë ndala së qeshuri ngaqë vura re se sytë e tij, këtë radhë, nuk po shkëlqenin.

‘Seriozisht e ke?’ pyeta unë.

Nishino uli sytë. ‘Nuk jam fare i sigurt,’ u përgjigj ai.

‘Ka kohë që po tregohem i kujdesshëm për të mos përfunduar kështu.’

‘Desha s’desha më erdhi për të qeshur kur ai përdori fjalën ‘i kujdesshëm’. Ai vuri buzën në gaz bashkë me mua. Momenti i shkëputjes nga Nishino do të vinte së shpejti. Instinkti im më paralajmëroi që mos ta afroja shumë tek vetja. Përndryshe do të filloja të ushqeja ndjenja romantike për të; ndërsa ai, mund të binte në dashuri me mua.

Me qetësi vendosa pjatën e Mjau-t në lavaman. Pastrova copëzat e sardeles në kullore dhe fillova të merrem me larjen e pjatës. Ndjeja shikimin e tij që binte mbi mua. Pothuajse dhimbshëm ndjeva vështtrimin e tij që kishte pushuar mbi shpatullat e mia tek qëndroja para lavamanit.

Tek hapa çezmën përsërita fjalët, *I dashuri im i vetëm është Mjau, vetëm Mjau*, a thua se këto ishin fjalë të shenjta.

‘Eriko,’ Nishino thirri emrin tim.

‘Çfarë?’ pyeta pa u menduar gjatë me kurrizin ende të kthyer nga ai.

‘Eriko,’ përsëriti Nishino. Unë sërish nuk u ktheva. Pjata e Mjau-t shkëlqente nga pastërtia, megjithatë unë vazhdova shpëlarjen me ujë.

‘Do të marr në telefon,’ tha Nishino. ‘Do të telefonoj çdo natë.’

‘Mirë,’ u përgjigja unë me kurrizin vazhdimisht të kthyer nga ai.

Më pas, Nishino u largua menjëherë.

Edhe pas largimit të tij unë vazhdova ta shpëla pjatën e Mjau-t. Ajo shkëlqente. Zakonisht dukej si një mall i vjetër dhe i çngjyrosur, por tani tek shpëlahej me ujë ajo vërtet lëshonte xixa.

‘*Ia dola mbanë*,’ mendova me vete. Situatën e përballova mjaft mirë. Madje pa rënë në dashuri asnjë çast. Për më tepër, duke mos rënë në dashuri, atë nuk e lëndova në ndjenja dhe vetes nuk i bëra dëm.

Më pas bëra një banjë për qejfin tim, vura një maskë fytyre dhe u mora me përkujdesjen e thonjve. Vazhdimisht e kisha mendjen tek vetja, kontrolloja se mos provoja ndonjë ndjenjë pikëllimi, por valët që ndjeja nuk ishin më shumë se një llokoçitje e vogël.

Rashë në shtrat, mbylla sytë dhe u përpoqa që të më marrë gjumi. Për fat të keq, gjumi më bënte dredha. Kujtova Mjau-n. Të nesërmen do ta trajtoja me peshk ton *sashimi*.

Në momentin që vendosa të veproja kështu, dallgët filluan të më vërviten. Ishin dallgë gjigante që rrokulliseshin. Nishino më mungonte. Nuk është se e doja, u mundova t’ia mbush mendjen vetes tek shtrëngova dhëmbët. Ajo nuk ishte dashuri. Unë thjesht – nuk duhej ta kisha lejuar që të më afrohej kaq shumë. Këtë ia thashë vetes disa herë.

Pak nga pak gjumi filloi të m’i kapiti sytë. Në atë çast më ra ndërmend se celulari i Nishino-s nuk kishte rënë atë natë. Vajzat që e merrnin vazhdimisht në telefon nuk e kishin shqetësuar për as edhe një moment të vetëm.

Në çastin kur po më rëndoheshin kapakët e syve e kuptova se Nishino duhet ta kishte mbyllur telefonin. Sapo e kuptova këtë, gjumi më mori menjëherë. Një pjesë e imja druhej se ato që Nishino m’i kishte thënë, i kishte seriozisht.

U mundova të sjell ndërmend momentin kur Mjau ishte larguar.

Hera e fundit që e pashë Mjau-n ishte në prag të vitit të ri – për këtë jam e sigurt. Ajo e kishte mbaruar shpejt e shpejt salmonin që kishte mbetur nga simitet *kombu-maki* që i kisha pjekur vetë. Kur e thërrita në emër, ‘Mjau’ ajo më ishte përgjigjur ‘Mjau’. Si zakonisht.

Që nga dita e nesërme, Mjau nuk u pa më. Qesha me gjithë zemër, gjithmonë me mendimin se ajo duhet të ishte larguar me rastin e pushimeve të vitit të ri, por kaloi një javë, pastaj një muaj, dhe megjithatë ajo nuk dha shenja jete.

Kishin rrjedhur tre muaj që nga koha e largimit të Nishino-s, thirrjet e tij telefonike po bëheshin gjithnjë e më të rralla.

‘Më kanë braktisur si e dashura ashtu dhe miku im i mirë.’ I murmurisja këto fjalë sa herë që dilja në verandë nën rrezet e diellit dimëror. Mjau më mungonte. Provova ta them këtë fjali me zë të lartë. ‘Mjau, ti më mungon.’ Në lidhje me mallin për Nishino-n nuk thashë asnjë fjalë. Natyrisht.

Pjatën e Mjau-t e lava mirë dhe e vendosa në raftin e ulët të dollapit. Mace të tjera, por jo Mjau, shfaqeshin në verandën time; nuk ushqeva asnjërrën prej tyre. Herë pas here, më kujtohej qartë zëri i Nishino-s dhe shprehja e fytyrës së tij, mënyra sesi ai mbante distancë, por edhe sesi tregohej i ndjeshëm në të njëjtën kohë.

Çfarë ishte ajo që e trembte Nishino-n? Po unë – përse kisha pasur frikë ta dashuroja atë? Atëherë, gjithçka kishte qenë e qartë për mua, por tani, tek hidhja shikimin prapa në kohë, çdo gjë ishte e paqartë. Lëvizjet e zhdërvjellëta të Mjau-t ishin bërë të turbullta në kujtesën time.

Pyeta veten mos vallë, madje edhe tani, diku në një vend të largët, Nishino po tregohej i kujdesshëm për të mos rënë në dashuri me askënd. A thua të vazhdonte ai t’i ndalonte vajzat në rrugë – dhe t’i joshte ato me zërin e tij të ëmbël?

Unë duhej t’i kisha dhënë sardele dhe skumbri Nishino-s çdo ditë. Dua të them, Nishino-s. Vetëm ashtu do të kishim mundur të jetonim së bashku të lumtur përgjithmonë. Ka momente që ndjehem kësisoj. Më pas ndjej mall për Mjau-n. Ajo më mungon jashtë mase. ‘Mjau,’ thërras unë me zë të lartë emrin e saj. Në vijim, me një zë të qetë, thërras po me zë të lartë edhe emrin e tij.

‘Nishino.’

Dielli dimëror vazhdon ta ndriçojë verandën.

HIROMI KAWAKAMI

Lindur në vitin 1958 në Tokyo, HIROMI KAWAKAMI është një romancieret më të famshme japoneze. Ajo është fituesja e *Pascal Short Story Prize for New Writers* dhe *Akutagawa Prize*. Romani i saj *Drowning* fitoj dhe Ito Sei Literature Award dhe Joryu Bungaku Sho (Çmim për Shkrimtaret Femra) në vitin 2000. Romani i saj *Manazuru* fitoi *Japan-U.S. Friendship Commission Prize* në 2011. *Strange Weather in Tokyo (Sensei no kaban)* fitoi çmimin Tanizaki në 2001 dhe ishte finalist për *Man Asian Literary Prize* dhe *Independent Foreign Fiction Prize* në 2014.



ISAIAH BERLIN

TAKIMI I PARË ME ANA AHMATOVËN NË LENINGRAD

Përktheu Bujar Hudhri

Nuk kisha qenë në Leningrad prej vitit 1919, kur familja ime mori lejen që të kthehej në Rigë, kryeqytetin e pavarur atëherë të republikës. Kujtimet m'u gjallëruan aq qartësisht: isha i tronditur befaz nga pamja e rrugëve, shtëpive, përmendoreve, shesheve në bregdet apo tregjeve. Një përshtypje të pashlyeshme më bëri vizita në shtëpinë ku kisha banuar dikur me familjen. E pashë përsëri rrethimin gjysmë të rrënuar, magazja ku më parë pastronim samovarët dhe oborri i brendshëm, po ashtu i pistë dhe i braktisur, si në vitet e para pas revolucionit. Raste të veçanta dhe episode të viteve fëmijërore befaz më ndezën kujtesën aq qartë, thua se ishin një realitet i sotëm. Po ecja nëpër qytetin legjendar dhe veten e ndieja si pjesë e legjendës së ngjallur dhe njëkohësisht si vëzhgues i jashtëm.

Pavarësisht nga shkatërrimet e egra të kohës së luftës, qyteti të linte një përshtypje të mrekullueshme (pasi e vizitova Leningradin njëmbëdhjetë vjet më vonë, pothuaj ishte rindërtuar plotësisht). Isha drejtuar te qëllimi kryesor i udhëtimit tim - "Libraria e shkrimtarëve" në shëtitoren e Nevskit. Kjo librari ishte atëherë (mendoj, edhe sot) e ndarë në dy seksione. Në të parin librat gjendeshin pas banakut, kurse në tjetrin ishin në raftë të hapura. Seksioni i dytë ishte i lejuar vetëm për shkrimtarët e njohur, gazetarët dhe persona të tjerë të privilegjuar. Unë dhe miss Tripp, duke qenë të huaj, kishim të drejtë ta vizitonim këtë vend të shenjtë. Duke i shqyrtuar librat, zura të bisedoj me një vizitor, i cili po shfletonte përmbledhje poetike. Na doli që ai qenkësh një kritik tepër i njohur dhe historian i letërsisë. Nisëm të flasim për ngjarjet e fundit. Bashkëbiseduesi im më përshkroi vitet e tmerrshme të bllokadës, që u kushtuan leningradasve kaq vuajtje. Ai më tha se shumë vdiqën urie dhe prej të ftohtit, por më të rinjtë dhe më të fortët mbijetuan, kurse një pjesë e banorëve u evakuuan. E pyeta për fatin e shkrimtarëve leningradas. M'u përgjigj po me pyetje:

- E keni fjalën për Zoshçenkon dhe Ahmatovën?

Kjo frazë më habiti së tepërmi: Ahmatova më dukej si një figurë e një të shkuare të largët. Moris Baura, që përktente vargjet e saj, nuk kishte dëgjuar asgjë për të që nga kohët e Luftës së Parë Botërore.

- Vërtet Ahmatova është gjallë?

- Ahmatova Anna Andrejevna? Po, natyrisht! Ajo banon këtu afër, në Shtëpinë Fontan. Doni të njiheni me të?

Për mua ishte sikur të shikoja mis Kristina Rossetin, ndaj nga emocioni mezi mund të hapja gojë.

- Po, sigurisht, - shqiptova, - dua shumë!

I njohuri im i ri, sapo më tha "që tani po i telefonoj", m'u fsheh befaz. Si u kthye, ramë në një mendje që të takoheshim nga ora tre pasdite te libraria, që të shkonim së bashku tek Ahmatova. Kur u ktheva në hotel, e pyeta miss Tripp nëse dëshironte të vinte me ne, por ajo kishte një takim tjetër.

Në orën e caktuar shkova përsëri te dyqani dhe së bashku me kritikun ecim përmes urës Aniçkov, kthejmë majtas dhe shkojë më tej te Fontanka bregdetit. Fontanij Dom, ish-pallati i Sheremetievit, një ndërtim madhështor në stilin barok me porta me punime hekuri me shije të hollë artistike, për të cilat është aq i famshëm Leningradi, qëndronte në mes të një oborri të gjerë, që disi më sillnin ndër mend oborrin katërkëndor të Universitetit të Kembrixhit apo Oksfordit. U ngjitëm nëpër shkallët e pandriçuara në katin e sipërm dhe u gjendëm në dhomën e Ahmatovës. Mobilim ishte shumë i varfër, me sa dukej, shumë orendi i kishte shitur gjatë kohës së bllokadës. Nga mobiliet kishin mbetur vetëm një tavolinë jo e madhe, tre ose katër kolltukë, një senduk druri dhe një divan. Mbi oxhak varej një vizatim i Modiglianit.

Një damë madhështore e thinjur, me një shall të bardhë hedhur supeve, u ngrit ngadalë dhe na përshëndeti. Kjo madhështi e Anna Ahmatovës shfaqej në gjestet e pangutura, në uljen fisnike të kokës, në tiparet e bukura e paksa të rrepta dhe gjithashtu në shprehjen e një pikëllimi të madh. U përkula para saj, që përligjej nga situata. Më dukej sikur po falënderoja mbretëreshën për nderin që po më pranonte.

- Lexuesit perëndimorë, - thashë, - pa dyshim që do të gëzohen që Ahmatova është mirë me shëndet, sepse asgjë nuk dihej prej shumë vjetësh për të.

- Si kështu, - m'u përgjigj, - s'ka shumë kohë që në "Dublin Review" doli një artikull për mua, kurse për vjershat e mia, siç më kanë thënë, bëhen disertacione në Bolonja.

Në takimin tonë ishte e pranishme edhe një shoqe e Ahmatovës, një damë elegante me një pamje prej aristokrateje. Disa minuta bëmë një bisedë mondanë. Anna Andrejevna më pyeti se si ishin zmbarsur bombardimet e luftës në Londër. U përpoka t'i përgjigjesha sa më thelbësisht, duke u munduar më kot të shmangia hutimin që po më shkaktonte me atë sjellje mbretërore. Papritur, dëgjoj zërin e dikujt, që nga rruga thërriste emrin tim. Nuk u përgjigja, i bindur se mbase më bënë veshët, por ndërkohë thirrja vazhonte dhe fjala "Isaih" tingëlloi edhe më e qartë. Shkova te dritarja, kur shoh dikë, që e njoha në çast, Randolph Churchill-in, djalin e

Winston Churchill-it. I ngjashëm më tepër me një student paksa të dehur, qëndronte në mes të oborrit të madh dhe thërriste zëshëm emrin tim. Ngriva, thua se më kishin gozhdur në dyshe me dhe pa e pasur idenë se ç'duhej të bëja në këtë situatë. Më në fund, erdha në vete, kërkoja ndjesë duke murmuritur dhe u sula të zbrisja shkallët, me një mendim të fiksuar në kokë që ta ndaloja të sapoardhurin të ngjitej në dhomën e Ahmatovës. Bashkudhëtari im i shqetësuar, kritiku, më ndoqi nga pas. Kur dolëm në oborr, Randolph-i, duke na përshëndetur gëzueshëm, po afrohej me hapa të shpejtë drejt nesh.

- Ma merr mendja, ju ende nuk njiheni me mister Randolph Churchill-in, - iu drejtova automatikisht kritikut.

Ai ngriu në vend, hutimi në fytyrën e tij u shndërrua në tmerr dhe befaz ia mbathi. Nuk e kam parë që nga ai çast, por kam dëgjuar se punët e tij vazhdojnë të botohen në Bashkimin Sovjetik, ndaj si përfundim ky takim nuk i ka sjellë asnjë dëm. Nuk pata vërejtur kurrë se mua më ndiqnin, por që Randolph Churchill-in e kishin ndjekur s'kishte pikë dyshimi. Pikërisht, pas kësaj ndodhie filluan të përhapeshin fjalët se në Leningrad kishte mbërritur një delegacion i huaj me qëllim t'i mbushte mendjen Ahmatovës të linte Rusinë dhe se Winston Churchill-i, adhuresi prej shumë vjetësh i Ahmatovës, kishte dërguar një avion të posaçëm që ta shpërngulte në Angli dhe gjeputa të tjera.

Nuk e kisha parë Randolph-in që nga ditët tona studentore në Oksford. Si e largova me nxitim nga Shtëpia Fontan, e pyeta se ç'donte të thoshte e gjitha kjo. Më tregoi se për momentin ishte si bashkëpunëtor i një gazete amerikane. Sot kishte ardhur për vizitë pune në Leningrad dhe telashi i tij i parë ishte vendosja në frigorifer i kutisë së sapoblerë me havjar. Randolph-i nuk fliste asnjë fjalë rusisht, kurse përkthyesi s'dihej se nga ishte zhdukur. Duke kërkuar ndihmë pa asnjë sukses, rastësisht ishte ndeshur në rrugë me Brenda Tripp-in. Kur i kishte thënë ajo se unë isha në Leningrad, ai kishte brofur nga gëzimi, kur mendonte se unë mund ta zëvendësoja përkthyesin. Për fat të keq, mis Brenda pa pikë kujdesi i kishte bërë me dije që unë për momentin ndodhesha në pallatin Sheremetiev. Randolph-i ishte nisur drejt e te pallati, pa e ditur me saktësi në cilin apartament, përdori metodën aq popullore në Oksford, duke thërritur me zë të lartë emrin tim para shtëpisë sime. "Dhe kjo funksionoi", - tha ai triumfalisht. U ndava prej tij me ngut dhe pasi mësova te libraria numrin e telefonit të Ahmatovës, nxitova t'i telefonoj dhe e pyeta nëse mund të shkoja përsëri tek ajo.

M'u përgjigj:

- Sonte në mbrëmje, në orën nëntë.

Kur në orën e përcaktuar kapërceva përsëri pragun e dhomës së Ahmatovës, gjeta atje një nga nxënësot e burrit të saj të dytë, asirologut Shilejko, - një damë e arsimuar, e cila më mbuloi me pyetje mbi universitetet angleze dhe sistemin arsimor perëndimor. Dukej qartë që Ahmatovës nuk i interesonte aspak dhe pjesën më të madhe heshte. Më në fund, pak para mesnate mysafirja u largua dhe Ahmatova filloi të pyeste për miqtë e saj, që kishin emigruar në Perëndim, me shpresë se unë i njihja personalisht. (Më vonë më tha se me intuitë e kishte ndier që në të vërtetë isha i njohur me ta, kurse intuita kurrë nuk e tradhtonte atë). Dhe nuk u gabua. Ne folëm për kompozitorin Artur Lurie, me të cilin isha takuar në Amerikë në kohën e luftës, ai ishte një mik i ngushtë i Ahmatovës dhe ka shkruar muzikën për disa vjersha të Mandelshtamit, për poetin Georgi Adamoviç, piktorin e mozaikëve Boris Anrep, me të cilin nuk njihesha, por vetëm kisha dëgjuar se në dyshtemënë e Galerisë Kombëtare ai realizoi portretet e njerëzve të shquar Bertran Rasell, Virxhinia Vulf, Greta Garbo, Klajva Bella, Lidia Llopuhova etj. (Njëzet vjet më vonë munda t'i tregoj Ahmatovës që Anrep kishte shtuar te këta mozaikë edhe figurën e saj, duke e quajtur "Dhembshuri")

Anna Andrejevna dëgjonte me vëmendje të madhe: fatet i ish-miqve dhe të njohurve të saj e preknin fort dhe i interesonin asaj. Më ka treguar një unazë me gur të zi që Anrep ia kishte dhuruar më 1917. Më pyeti edhe për Salomee Halpern, e lindur Andronikova, me të cilën ishte njohur që në Shën Peterburg para Luftës së Parë Botërore. Kjo bukuroshe e famshme, që shkëlqente në shoqërinë mondanë me mendjemprehtësinë dhe joshjen, kishte marrëdhënie miqësore me shumë piktorë dhe poetë të kohës. Kam dëgjuar nga Ahmatova (vetë e dija më parë) që Mandelshtami, i dashuruar me Salomee Nikollajevnën, i kushtoi asaj një nga poezitë e tij më të bukura. E njihja

nga afër Salomeenë dhe burrin e saj Aleksandër Jakovleviç Halpern dhe i tregova mbi disa fakte të jetës së tyre, të rrethit të tyre dhe pikëpamjeve të tyre. Ahmatova gjithashtu u interesua për Vera Stravinskajan, gruan e kompozitorit, të cilën atëherë ende nuk e njihja personalisht, kështu që munda t'i komunikoj diçka Ana Andrejevnes për të vetëm në takimin tonë më 1965 në Londër. Ahmatova nisi të flasë për udhëtimet e saj në Paris, para Luftës së Parë Botërore, për miqësinë me Amadeo Modiglianin, vizatimi i të cilit varej mbi oxhak (vizatimet e tjera të tij humbën gjatë bllokadës), për fëmijërinë e saj buzë detit, e thënë me fjalët e saj, në tokën pagane të papagëzuar, me një kulturë aspak ruse, ku ndihej afria me diçka antike, gjysmë greke, gjysmë e egër. Ahmatova më tregoi për burrin e saj të parë, poetin e njohur Gumiliev, që kishte luajtur një rol të madh në zhvillimin e dhuntisë së saj poetike. Gumilievi e konsideronte martesën e dy poetëve një absurditet dhe nuk i shpëtonte rast që të mos fliste për mospëlqimin e vjershave të gruas: në fakt, kurrë nuk e bëri publike. Njëherë, duke u kthyer nga Abisinia (që ishte bërë temë e shumë vjershave të tij madhështore ekzotike), ai që në stacionin hekurudhor, me një pamje krejt të zymtë, e pyeti:

- Ke shkruar?

- Po.

- Ma lexo.

Ajo i lexoi dhe atëherë shikimi i burrit u zbut.

- Mirë, shumë mirë, - kishte thënë ai dhe që atëherë e kishte pranuar si poet.

(Shumë vjet më vonë tekstualisht po me këto fjalë do të na e tregonte këtë histori mua dhe Dmitri Obolenskit në Oksford.) Ahmatova ishte e bindur që Gumilievi, i dënuar dhe i pushkatuar për pjesëmarrje në një komplot monarkist, vuajti pafajësisht. Ajo më tregoi se si grupi i shkrimtarëve iu drejtua atëherë Gorkit me kërkesën që të ndërhyte për Gumilievin, por ai kishte refuzuar. Vetë Ahmatova disa vjet para dënimit u divorcua nga Gumilievi dhe derisa ai vdiq nuk u pa më me të. Sytë e saj ishin gjithë lot, kur po rrëfente për rrethanat torturuese të vdekjes së poetit.

Pastaj më pyeti nëse doja të dëgjoja vjershat e saj të reja. Por fillimisht donte të më lexonte fragmente nga "Don Zhuani" i Bajronit, që kishte, siç e quante ajo, një lidhje të drejtpërdrejtë me veprat e saj të fundit. Megjithëse e njihja shumë këtë poemë, nuk po e kuptoja cilat vargje pikërisht po tingëllojnë: Ahmatova po lexonte anglisht dhe nga shqiptimi i saj munda të dalloja ca fjalë. Ajo mbylli sytë dhe e recitoi përmendsh, me një ndjenjë të thellë. Tashmë isha ngritur në këmbë dhe u afrova te dritarja për të parë, që të fshihja pështjellimin. Më vonë po mendoja, në këtë mënyrë, me sa dukej, lexojmë poemat klasike greke dhe latine, duke i shqiptar fjalët në mënyrë të tillë që autorët apo përfaqësues të tjerë të asaj kohe nuk do të kuptonin kurrëgjë. Zuri të fliste për përmbledhjet e saj "Anno domini", "Kopeja e bardhë", "Nga gjashtë libra".

-Vargje të tilla, por shumë më tepër të fuqishme, ka shkruar një poet i kohës sonë dhe ata u bënë shkak i vdekjes së tij. E dashuroja dhe më dashuronte, -tha ajo, por nuk e dija, se cilin kishte në mend, Gumilievin apo Mandelshtamin.

Veçse nuk mundi më të vazhdojë, sepse e mbytnë dënesat. Pastaj më lexoi ca nga "Poemë pa hero", të cilën ende nuk e kishte përfunduar. Nuk po e përshkruaj zërin dhe intonacionin e saj, sepse ka regjistruar të leximit të saj. Kuptova që këto ishin vargje gjeniale, që me dëgjimin e parë isha i mrekulluar nga magjia dhe thellësia e tyre. Ahmatova nuk e fshihte që e kishte menduar këtë poemë si një përmendore të krijimtarisë së saj, një përmendore të së kaluarës së Peterburgut, e cila kishte qenë pjesë e jetës së saj. Vargje mbi "Mysafirja nga e ardhmja" atëherë ende nuk ishin shkruar, si dhe dedikimi i tretë, "Poema pa hero" - një vepër misterioze dhe magjiplotë, debatet dhe diskutimet për të nuk shuden si më parë. Mali i komentareve shkencorë mbi poemën vazhdon e rritet deri në ditët tona dhe duket që do ta zërrë poshtë.

Pastaj Ahmatova filloi të lexojë dorëshkrimin "Requiem". Si e ndërpreu, nisi të tregojë për vitet 1937-1938 kur burri dhe djali i saj ishin arrestuar dhe syrgjynosur në kampe (më vonë kjo u përsërit), për radhët e gjata, ku ditë pas dite, javë pas jave, muaj pas muaji gratë prisnin njoftime për burrat, vëllezërit, etërit, bijtë, prisnin leje t'u dërgonin atyre pako apo letra. Por kurrë nuk erdhën njoftime, perdia e shurdhër e heshtjes mbulonte vuajtjet dhe vdekjet e njerëzve. Ajo m'i tregonte gjithë këto me një zë krejt të qetë, pa pasion, duke e ndërprerë veten kohë pas kohe me

vërejtje të tilla, si: “Jo, nuk mundem, kjo s’ka dobi. Ju keni ardhur nga një botë normale njerëzore, ndërkohë që bota jonë është ndarë në njerëz dhe në...”

U bë një heshtje e gjatë.

- Dhe madje tani...

E pyeta për Mandelshtamin, por nuk vijoi asnjë përgjigje. E pashë që sytë i kishte të mbushur me lot dhe m’u lut të mos e preknim këtë temë.

-Pasi i dha një shpullë Aleksej Tolstoit, tashmë gjithçka ishte paravendosur.

Iu deshën disa minuta që të vinte në vete. Pastaj filloi të fliste me një zë krejtësisht të ndryshuar:

-Aleksej Tolstoi më dashuronte. Kur ishim në Tashkent, ai mbante këmisha lejla të modelit rus dhe vazhdimisht më thoshte se sa mirë do të ishim bashkë, kur të ktheheshim nga evakuimi. Ka vdekur para ca kohësh. Ishte një shkrimtar shumë prodhimtar dhe interesant, horr, plot sharm dhe një njeri me temperament të furishëm. I aftë në të vërtetë për gjithçka, ka qenë një antisemit fanatik, një aventurier i regjur dhe një mik i keq. Ai donte vetëm të ritë, forcën dhe freskinë, prandaj nuk e përfundoi “Pjetrin e Parë”. Atij i interesonte vetëm Pjetri i ri, por çfarë mund të bënte ai me gjithë këta njerëz që plakeshin? Ishte një farë loj Dollohovi, mua më thërriste Annushka, çka gjithnjë më bënte të tutesha. Megjithatë, më tërhiqte, megjithëse konsiderohej si shkak i vdekjes së poetit më të mirë të kohës sonë, të cilin e doja dhe që më donte.”

Po afrohej ora tre e natës, por asnjë shenjë që Ahmatova është lodhur dhe pret që unë të largohem, kurse unë vetë, i mbingarkuar me mbresa, natyrisht, nuk ngutesha të ikja.

U hap dera dhe hyri biri i saj, Lev Gumilevi (tani është profesor historie në Leningrad). Dukej qartë, ëmë e bir ishin të lidhur shumë me njëri-tjetrin. Gumilevi më tregoi se ishte nxënës i historianit të shquar leningradas Eugjen Tarle. Sfera e studimeve të tij ishte Azia e Mesme (nuk ma përmendi se kishte qenë i burgosur dikur në ato krahina) dhe atë e interesonte historia e kazarëve, kazakëve dhe fiseve edhe më të lashtë. Ishte lutur vetë që të shkonte vullnetar në front, ku shërbeu në njësinë kundërajrore të përbërë nga ish-të burgosur. Sapo ishte kthyer nga Gjermania. Ishte i bindur se mund të jetonte e të punonte përsëri në Leningrad. Gumilevi më gostiti me një patate të zier; me sa dukej, ishte gjithçka që mund të më propozonte. Ahmatova kërkoi ndjesë për skamjen e saj. Iu luta të më nënshkruante “Poemën pa hero” dhe “Requiem”.

- Për këtë s’është nevoja, - m’u përgjigj, - në shkurt duhet të dalë përmbledhja e vjershave të mia të përzgjedhura: e gjitha është duke u korrektuar. Do t’ju dërgoj menjëherë një ekzemplar në Oksford.

Por rrethanat u kthyen ndryshe për shkak të revolucionit partiak, i drejtuar kundër Ahmatovës dhe Zoshçenkos, dhe që u bë pjesë e fushatës në luftën me “formalistët” dhe “dekadentët”. Pikërisht atëherë Zhdanovi doli me denoncime publike për Ahmatovën, duke e quajtur “gjysmëmurgeshë”, “gjysmëkuçqë”

Pasi u largua Levi, ajo më pyeti se çfarë lexoja dhe nuk arrita të përgjigjesha, kur filloi e akuzoi Çehovin për subjektet pa ngjyrë, pjesët melankolike, mungesën e heroizmit, vuajtjeve të vërteta, thellësinë dhe sublimen, për “paqen, ku nuk shndrisin shpatat”. (Më vonë po një ligjërim të tillë pasionant e formuloi kundër Pasternakut.) Ia përmenda se Çehovin e donte Tolstoi.

-Po përse ai vetë e dënoi me vdekje Ana Kareninën?” - pyeti Ahmatova. - Sapo ajo braktisi burrin, gjithçka përreth saj u kthye përmbys, u kthye në sytë e Tolstoit në një grua të rrëzuar, në një prostitutë. Natyrisht, në roman ndihet dora e gjeniut, por morali i tij i përgjithshëm është pa karakter. Kush e ndëshkoi Anën? Zoti? Jo, shoqëria, hipokrizinë e së cilës Tolstoi e ka demaskuar pa u lodhur. Në fund të romanit madje Vronski e përçmon Anën. Tolstoi është i pasinqertë. Morali i “Ana Kareninës” është morali i gruas së tij, i tezeve të tij moskovite. Vetë shkrimtari e di të vërtetën dhe aq më pak nuk turpërohet që nuk ngrihet deri në pikëpamje të një meskini. Morali i Tolstoit është pasqyrim i drejtpërdrejtë i përjetimeve të tij personale. Kur ishte i lumtur në martesë, shkroi “Lufta dhe paqja”, ku i thur lavde jetës bashkëshortore. Pastaj nisi ta urrejë Sofia Andrejevnnën, por nuk mundi të divorcohej prej saj, meqenëse morali i përgjithshëm e dënonte divorcin. Dhe atëherë shkroi “Ana Kareninën”, duke e ndëshkuar Anën, sepse ajo e la burrin. Por kur Tolstoi u plak dhe

vajzat fshatare nuk e ngacmonin më, ai shkroi “Sonata e Krojcerit”, ku përgjithësisht hidhte poshtë çdo jetë seksuale”.

Ka mundësi që gjithë ky ligjërim akuzues u tha me shaka. Por, sinqerisht, Ahmatova nuk pranonte mësimë dhe pikëpamje të Tolstoit: në sytë e saj ai ishte një egocentrik me një kaos në shpirt, armik i harmonisë dhe dashurisë. Ahmatova përulej para Dostojevskit (duke përbuzur, po si ai, Turgenievin) dhe nderonte shumë Kafkën: “Ai ka shkruar për mua dhe rreth meje.”

Në takimin tjetër në Oksford, më 1965, folëm për Xhojsin dhe Eliotin, shkrimtarët e mrekullueshëm, sipas saj, më të vërtetët nga të gjithë shkrimtarët bashkëkohorë, por pa dyshim që ishin më poshtë se Dostojevski dhe Kafka. Pushkinin e quante gjenial dhe të pakalueshëm, ai, sipas mendimit të saj, dinte gjithçka. “Dhe si ia doli ky djalosh me kaçurrela nga Carskoe Sello me vëllimin e Parni në dorë?” Pastaj më lexoi gjithë shënimet për “Netët egjiptiane” të Pushkinit, më tregoi për heroin e kësaj poeme – një i huaj misterioz .

Ahmatova nuk dyshonte që prototipi i këtij virtuoz i gjenial ishte poeti polak Adam Mickieviç. Marrëdhënia e Pushkinit me këtë të fundit ishte jo njëkuptimore; çështja polake i ndante ata, por Pushkini, pa dyshim, shihte te Mickieviçi gjeniun e bashkëkohësisë. Aleksandër Blloku, me ata sy të çmendur dhe talentin unikal gjithashtu zotëronte dhuntinë e improvizatorit. Ahmatova tha se Blloku e kishte lëvduar shumë herë për vjershat e saj, në fakt ai nuk e kishte dashur. Megjithatë, çdo nxënëse shkollë në Rusi ishte e bindur – dhe kjo bindje është edhe sot – që Ahmatova dhe Blloku kanë pasur një lidhje dashurie. Madje, edhe historianët dhe kritikët e besojnë. Bazë për këtë ka shërbyer, me sa duket, vjersha e Ahmatovës e vitit 1914 “Erdha mik te poeti”, kushtuar Bllokut, dhe vjersha me temën e vdekjes “Mbreti syhirtë”, e shkruar në fakt dhjetë vjet pas vdekjes së poetit, po ashtu edhe vjersha të tjera. Sipas Ahmatovës, Blloku nuk i pranonte poetët akmeistë, para së gjithash Mandelshtamin, Gumilievin, nuk e donte Pasternakun, por edhe atë vetë.

Nisëm të flisnim për Pasternakun, me të cilin ajo ishte shumë e lidhur. Më tha se poeti vinte shpesh tek ajo, si rregull, në kohë krizash shpirtërore, pafuqishmërie dhe zbrazëtie, por gruaja e tij shpejt ia behte pas tij dhe gjithë ngut e mernte me vete për në shtëpi. Të dy, Pasternaku dhe Ahmatova sikur dashuroheshin. Jo një herë Pasternaku i kishte propozuar, por ajo nuk e mernte seriozisht. Ishte, sipas saj, një dashuri jo e vërtetë, madje as që mund të quhej dashuri. Por ata kishin shumë kuptim për njëri-tjetrin, veçanërisht pas vdekjes së Mandelshtamit dhe Cvetajevës. Vetëm vetëdija se kolegu dhe miku yt është gjallë dhe shkruan, ishte një ngushëllim i pakufishëm për të dy. Ata mund ta kritikonin njëri-tjetrin herë pas here, por nuk ia lejonin këtë askujt tjetër. Ahmatova admironte Cvetaevën: “Marina si poete është ku e ku më e mirë se unë.” Pas vdekjes së Mandelshtamit dhe Cvetajevës, Pasternaku dhe Ahmatova e ndien vërtet vetminë e tyre: dukej, ishin si në një shkretëtirë, megjithëse nderimi i pakufishëm i bashkatdhetarëve, të cilët rishkruanin, kopjonin, përhapnin dhe mësonin përmendsh vargjet e tyre, ishte për ta një mbështetje e madhe dhe çështje krenarie. Patriotizmi i lartë i këtyre dy poetëve ishte jashtë çdo nacionalizmi, mendimi për emigrim ishte i huaj për ta. Pasternaku ëndërronte të shihte Perëndimin, por nuk donte të rrezikonte ta gjente rrugën e kthimit të mbyllur. Ahmatova më tha që nuk donte të shkonte askund, që donte të mbetej në atdhe deri sa të ishte gjallë, pavarësisht vështirësitë dhe përndjekjet që mund t’i ngjasnin. Të dy, Pasternaku dhe Ana Ahmatova e ngushëllonin veten me iluzione për pasurinë artistike, kulturën intelektuale perëndimore, botën krijuese ideale dhe synonin t’i bashkoheshin asaj.

Megjithëse ishte ende natë e thellë, Ahmatova po gjallërohej edhe më shumë. Nisi të më pyesë për jetën time private dhe iu përgjigja krejt dhe lirshëm, sikur ajo të kishte të drejtë ta bënte këtë. Nga ana e saj, më foli për fëmijërinë e kaluar në breg të Detit të Zi, për martesat me Gumilevin, Shilejkon dhe Puninin, për miqtë e rinisë, për Peterburgun para Luftës së Parë Botërore. Vetëm të kesh një përfytyrim për të gjitha këto, mund të kuptosh “Poemën pa Hero”; vijimësinë e tablove dhe simboleve, lojën e maskave, ballon përfundimtare të maskaradës, motivet nga “Don Zhuani”. Ahmatova filoi të flasë përsëri për Salomee Andronikovën,

bukurinë e saj, magjepsjen, mendjen e pashoqe, për mbrëmjet në kabarenë “Qeni rrugaç”, për shfaqjet në teatrin “Pasqyra e shtrembër”, për pakënaqësinë e saj për mistikët e rremë të simbolizmit, me përjashtim të vjershave të Bodlerit, Verlenit, Rembosë dhe Verharnit, shumë prej të cilëve i dinte përmendësh. Për Vjaçesllav Ivanovin fliste mirë si njeri i shquar, me një shije të paqortueshme, gjykime të holla forcën e mrekullueshme të përfytyrimit, por poezia e tij i dukej tepër e ftohtë dhe pajetë. Afërsisht i po këtij mendimi ishte edhe për Andrej Bjellin. Balmontin, sipas pikëpamjes së saj, e kishin përçmuar kot: megjithëse ishte shumë popoz dhe i vetësigurt, talenti i tij nuk ngjallte dyshime. Sollogubin e konsideronte poet jo të zakonshëm por shpesh interesant dhe original. Por më lart se gjithçka ajo vendoste drejtorin e rreptë dhe kërkues të liceut të Carskoe Sello, Inokenti Annenski, tek i cili mësuan shumë si Ahmatova dhe Gumilevi. Vdekja e Annskit kaloi pothuaj pa u vënë re për botuesit dhe kritikët, mjeshtrin e madh e harruan. Po të mos kishte qenë ai, s’do të kishin qenë as Gumilevi, Mandelshtami, Lozinski, Pasternaku dhe vetë Ahmatova.

Folëm edhe për muzikën. Ana Andrejevna admironte sublimen, bukurinë e tri sonatave të fundit për fortepiano të Beethovenit. Pasternaku i quante ato më të fuqishme se kuartetet e kompozitorit dhe ajo kishte të njëjtin mendim: në gjithë shpirtin e saj jehonte kjo muzikë. Paraleli që Pasternaku hiqte midis Bahut dhe Shopenit, i dukej asaj i çuditshëm por edhe interesant. Ajo thoshte se me Pasternakun më lirshëm mund të flisje për muzikën sesa për poezinë.

Ahmatova më foli për vetminë e saj dhe për izolimin si kulturor ashtu edhe vetjak. Leningradi i pasluftës i dukej si një varrezë e stërmadhe: i ngjante një pylli pasi i ka rënë zjarri, ku disa pemë që kishin mbetur veçse forconin dhimbjen e humbjes.

I kishin mbetur ende Ahmatovës ca miq besnikë - Lozinski, Zhirmunski, Hardzhiev, Olga Berffolc, Lidija Çukovskaja, Emma Gershtein (nuk ma përmendi Garshinin dhe Nadezhda

Mandelshtamin, për të cilët nuk dija asgjë). Por ajo nuk kërkonte mbështetje tek ata. Të mbijetonte moralisht atë e ndihmoi arti, figurat e së kaluarës: Peterburgu pushkinian, Don Zhuani i Bajronit, Moxarti, Molieri, panoram e madhe e Rilindjes italiane. Ajo e siguronte jetesën falë përkthimeve. Me shumë mund ia arriti të marrë leje që të përkthente letrat e Rubensit, dhe jo Romen Rolanit. Më pyeti, a kisha dijeni për këto letra. Folëm për Renesansën. Ishte me interes ta mësoja, a e konsideronte periudhë një të kaluar reale historike, të populluar me njerëz të gjallë, të papërkryer, apo një imazh të idealizuar të njëfarë bote të përfytyruar. Ahmatova m’u përgjigj, që, natyrisht, kjo e fundit. E gjithë poezia dhe arti ishin për të- këtu huazoi një shprehje të Mandelshtamit-diçka si mall për kulturën gjithëbotërore, gjithëpërfshirëse, sikundër na e paraqisnin atë Gëte dhe Shlegel. Kjo kulturë, që përjetësonte në art natyrën, dashurinë, vdekjen, zemërimin dhe vuajtjen, quhet një realitet i një lloji jashtëhistorik, përtej kufijve të të cilit s’ka kurrgjë. Përsëri dhe përsëri ajo më fliste për Peterburgun e pararevolucionit, qytetin ku u formua, dhe për natën pafundësisht të errët, në mbulesën e së cilës prej shumë vjetësh rrjedh jeta e saj.

Ahmatova, në asnjë mënyrë nuk u orvat të ngjallë mëshirë për veten, ajo dukej si një mbretëreshë në mërgim, krenare, dhe fatkeqe, e paarritshme dhe mahnitëse në oratorinë e saj.

Tregimi për tragjedinë e jetës së saj është e pakrahasueshme me askënd tjetër që kam dëgjuar gjer më sot dhe kujtimi për të është i gjallë ende dhe më dhëmb. E pyeta Ahmatovën, nëse ka ndërmend të shkruajë autobiografinë e saj, m’u përgjigj se biografia e saj është në vetë poezinë e saj, veçanërisht, në “Poemë pa hero”. Ma lexoi edhe një herë këtë poemë dhe unë sërish iu luta ta kopjoja dhe sërish mora refuzim. Biseda jonë, që kish kaluar nga lënda e letërsisë dhe artit tek anët thellësisht personale të jetës, përfundoi vetëm në mëngjesin e vonë të ditës së nesërme.



nën patronazhin e



organizatorë



në bashkëpunim me



PANAIRI i 20-të I LIBRIT në ULQIN

29^{KORRIK} – 02^{GUSHT}

📍 Në shëtitoren e plazhit të vogël

